

LIGJ
Nr. 1/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË FRANCËS, PËRFAQËSUAR NGA
RAJONI *PROVENCE-ALPES-CÔTE D'AZUR*, DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR
PROGRAMIN “(INTERREG VI-B) EURO MESDHE (EURO MED) 2021–2027”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës, përfaqësuar nga rajoni *Provence-Alpes-Côte D'Azur*, dhe Komisionit Evropian për programin “(Interreg VI-B) Euro Mesdhe (EURO MED) 2021–2027” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 25.1.2024.

Shpallur me dekretin nr. 45, datë 7.2.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

Ares(2023)3880642 – 5.6.2023

MARRËVESHJE FINANCIMI PËR PROGRAMIN INTERREG “EURO MED”

Hyrje

Komisioni Evropian, në vijim referuar si “Komisioni”, i cili vepron për llogari dhe në emër të Bashkimit Evropian, në vijim referuar si “BE”,

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i cili vepron në emër të Shqipërisë, në vijim referuar si “Shqipëria”,

dhe

Rajoni francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur”, i cili vepron në emër të Republikës së Francës, në vijim referuar si “Franca”,

në vijim referuar bashkërisht si “Palët”,

Duke theksuar objektivin e përbashkët dhe dakordësinë për ta realizuar me sukses programin “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO-MED)” dhe për të bashkëpunuar në mënyrë të palëkundur për të arritur këtë objektiv të përbashkët,

Duke rikujtuar angazhimet e tyre reciproke për të zbatuar programin “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO MED)” në përputhje me vlerat e përbashkëta, të tilla si respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, parimi demokratik i sundimit të ligjit dhe parimet horizontale për zbatimin e programeve të politikës së kohezionit, siç renditen në nenin 9 të rregullores (BE) 2021/1060.

Duke nënvizuar angazhimet e tyre të ndërsjella për të zbatuar programin “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO MED)” duke respektuar dispozitat që u mundësojnë Palëve menaxhimin e qëndrueshëm financiar të programit, trajtimin e drejtë të pjesëmarrësve, si dhe menaxhimin dhe konsultimin e duhur sipas natyrës së bashkëpunimit ndërmjet Palëve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Pjesa e parë **Dispozitat dhe parimet e përgjithshme**

Neni 1 **Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje**

Kjo Marrëveshje përcakton kushtet e financimit dhe zbatimit të “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO MED)” për periudhën 2021–2027 (“Programi”) në Shqipëri, me kontributin financiar të Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (“FEZHR”) dhe të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (“IPA III”), në vijim referuar bashkërisht si “Fondet Interreg”, dhe me kontributin kombëtar në program.

Autoritetet e shtetit anëtar angazhohen që ta zbatojnë këtë Marrëveshje si një instrument për zbatimin e buxhetit të Bashkimit Evropian, në përputhje me rregulloren (BE, Euratom) 2018/1046 (“rregullorja financiare”),¹ sipas kuptimit të nenit 59, paragrafi 6 të rregullores (BE) 2021/1059 dhe jo si një marrëveshje ndërkombëtare, siç përmendet në nenet 216 deri në 219 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

Neni 2 **Aktet bazë**

1. Programi “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO MED)” do të zbatohet nga Shqipëria dhe Franca, Bullgaria, Greqia, Spanja, Kroacia, Italia, Qiproja, Malta, Portugalia, Sllovenia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut, sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në shtojcën e saj, në përputhje me aktet bazë në vijim, duke përfshirë çdo korrigjim apo ndryshim përkatës në to, si dhe aktet përkatëse plotësuese të BE-së:

a) rregullorja (BE) 2021/1060² e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 qershor 2021, “Për përcaktimin e dispozitave të përbashkëta për Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal, Fondin Evropian Social Plus, Fondin e Kohezionit, Fondin e Tranzicionit të Drejtë, Fondin Evropian për Sektorin Detar, Peshkimin dhe Akuakulturën, si dhe rregullat financiare për këto fonde dhe për Fondin e Azilit, Migracionit dhe Integritit, Fondin e Sigurisë së Brendshme dhe Instrumentin për Mbështetje Financiare për Menaxhimin e Kufijve dhe Politikën e Vizave”;

b) rregullorja (BE) 2021/1058³ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 qershor 2021, “Për Fondin Evropian për Zhvillim Rajonal dhe për Fondin e Kohezionit”;

c) rregullorja (BE) 2021/1059⁴ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 qershor 2021, “Për dispozitat specifike për objektivin evropian të bashkëpunimit territorial (Interreg), të mbështetur nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal dhe instrumentet e financimit të jashtëm”;

¹ Gazeta Zyrtare L 193, 30.7.2018, f. 1.

² Gazeta Zyrtare L231, 30.6.2021, f. 159.

³ Gazeta Zyrtare L231, 30.6.2021, f. 60.

⁴ Gazeta Zyrtare L231, 30.6.2021, f. 94.

d) rregullorja (BE) 2021/1529⁵ e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 shtator 2021 “Për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)”;

e) vendimi (BE) 2021/1764⁶ “Për partneritetet e vendeve dhe territoreve jashtë Evropës me Bashkimin Evropian, duke përfshirë marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Grënländës dhe Mbretërisë së Danimarkës, nga ana tjetër” (vendimi për partneritetet me vendet jashtë Evropës, përfshirë Grënländën);

f) rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18 korrik 2018, “Për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, që ndryshon rregulloret (BE) nr. 1296/2013, (BE) nr. 1301/2013, (BE) nr. 1303/2013, (BE) nr. 1304/2013, (BE) nr. 1309/2013, (BE) nr. 1316/2013, (BE) nr. 223/2014, (BE) nr. 283/2014 dhe vendimin nr. 541/2014/BE dhe që shfuqizon rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012” (“rregullorja financiare”).

2. Për sa kohë që dispozitat e akteve bazë të përcaktuara në paragrafin 1, së bashku me aktet përkatëse që i plotësojnë ato, zbatohen për Shqipërinë si rrjedhojë e kësaj Marrëveshjeje, atëherë ato duhet të zbatohen sikur të ishin kushte të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 **Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje zbatohen përkufizimet dhe dispozitat e përcaktuara në nenin 2 të rregullores (BE) 2021/1059 dhe në nenin 2 të rregullores (BE) 2021/1060.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet shtesë në vijim:

1) “Programi” është “(Interreg VI-B) Euromediterranean (EURO MED)”, për periudhën 2021–2027, duke përfshirë dokumentet e lidhura me të, të korrigjuara ose ndryshuara, si për shembull:

- Dokumenti i programit (CCI 2021TC16FFTN001) i miratuar me vendimin e Komisionit C(2022) 3715, datë 31.5.2022;

- Dokumenti “Përshkrim i sistemeve të menaxhimit, financiare dhe të kontrollit”;

- “Manuali i programit”;

- “Rregullorja e brendshme për Komitetin e Monitorimit të Programit;

- “Strategjia e Komunikimit të programit”;

2) “Masat kufizuese të BE-së” janë masat kufizuese të miratuara në përputhje me Traktatin për Bashkimin Evropian (TBE) dhe Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).

Neni 4 **Buxheti total dhe kontributet financiare për Programin**

1. Plani i financimit është përcaktuar në shtojcën I.

2. Buxheti total i programit është 293 624 033 euro.

3. Totali i financimit të alokuar nga BE-ja për programin është 234 899 226 euro nga Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (“FEZHR”) dhe nga Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (“IPA III”), referuar bashkërisht si “Fondet Interreg”.

4. Vlera e alokuar nga BE-ja do të ndahet në angazhime vjetore, siç përcaktohet në tabelën 1 të shtojcës I.

5. Buxheti total i përmendur në paragrafin 2 përfshin gjithashtu kontributin kombëtar nga vendet pjesëmarrëse në shumën 58 724 807 euro.

Tabela 2 e shtojcës I paraqet ndarjen e kontributeve përkatëse financiare sipas prioritetit dhe tregon nëse kontributi financiar përbëhet nga bashkëfinancimi publik ose privat, apo nga të dyja.

⁵ Gazeta Zyrtare L330, 20.9.2021, f. 1.

⁶ Gazeta Zyrtare L 355, 7.10.2021, f. 6.

6. Norma e bashkëfinancimit e BE-së në nivel Programi do të jetë maksimumi 79,9999998638%. Norma e bashkëfinancimit për secilin prioritet është përcaktuar në tabelën 2 të shtojcës I.

7. Asgjë në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Bashkimit Evropian në lidhje me kreditë, të cilat nuk janë miratuar ende përmes miratimit të buxhetit të BE-së.

8. Sipas përqindjes së përcaktuar në nenin 27, paragrafi 3, germa “c” të rregullores (BE) 2021/1059, për buxhetin e asistencës teknike të programit do të përdoret një shumë maksimale prej 17 399 942 euro nga totali i kontributit financiar të fondeve “Interreg” në shumën 234 899 226 euro.

Shuma e fondeve të alokuara për asistencën teknike do të identifikohet si pjesë e alokimit financiar të çdo prioriteti të programit. Kjo shumë nuk do të marrë formën e një prioriteti të veçantë ose të një Programi specifik dhe është përcaktuar në kolonën “a2” të tabelës 2, shtojca I.

9. Palët garantojnë se gjatë zbatimit të programit, asnjë burim ekonomik nga kontributi financiar i përmendur në këtë nen nuk do të vihet në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhe as nuk do të përdoret për përfitimin e subjekteve, individëve ose grupeve të individëve që përfshihen në fushën e zbatimit të masave kufizuese të BE-së. Në rast se një Palë identifikon se një partner i projektit mund të përfshihet në fushën e zbatimit të masave kufizuese të BE-së, atëherë kjo Palë duhet të informojë menjëherë Komisionin.

Neni 5

Zona e programit

Zona e programit mbulon rajonet në vijim:

Shqipëri	Bullgari, Greqi, Spanjë, Francë, Kroaci, Itali, Qipro, Maltë, Portugali, Slloveni, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovinë, Maqedoni e Veriut
Rajonet e mbuluara nga programi sipas Nomenklaturës së Njërive Territoriale për Statistikat (NUTS) Shqipëria AL01 - Veri AL011 - Dibër AL012 - Durrës AL013 - Kukës AL014 - Lezhë AL015 - Shkodër AL02 - Qendër AL021 - Elbasan AL022 - Tiranë AL03 - Jug AL031 - Berat AL032 - Fier AL033 - Gjirokastrë AL034 - Korçë AL035 - Vlorë	Rajonet e mbuluara nga programi sipas Nomenklaturës së Njërive Territoriale për Statistikat (NUTS) EL41 - Βόρειο Αιγαίο EL411 - Λέσβος, Λήμνος EL412 - Ιακρία, Σάμος EL413 - Χίος EL42 - Νότιο Αιγαίο EL421 - Κάλυμνος, Κάρπαθος - Ηρωική Νήσος Κάσος, Κως, Ρόδος EL422 - Άνδρος, Θήρα, Κέα, Μήλος, Μύκονος, Νάξος, Πάρος, Σύρος, Τήνος EL43 - Κρήτη EL431 - Ηράκλειο EL432 - Λασιθί EL433 - Ρέθυμνο EL434 - Χανιά EL5 - Βόρεια Ελλάδα EL51 - Ανατολική Μακεδονία, Θράκη EL511-Έβρος EL512 - Ξάνθη EL513 - Ροδόπη EL514 - Δράμα EL515 - Θάσος, Καβάλα EL52 - Κεντρική Μακεδονία EL521 - Ημαθία EL522 - Θεσσαλονίκη EL523 - Κιλκίς EL524 - Πέλλα EL525 - Πιερία EL526 - Σέρρες EL527 - Χαλκιδική EN 2 EN EL53 - Δυτική Μακεδονία EL531 - Γρεβενά, Κοζάνη EL532 - Καστοριά EL533 - Φλώρινα EL54 - Ήπειρος EL541 - Αρτα, Πρέβεζα EL542 - Θεσπρωτία EL543 - Ιωάννινα EL6 - Κεντρική Ελλάδα EL61 - Θεσσαλία EL611 - Καρδίτσα, Τρίκαλα EL612 - Λάρισα EL613 - Μαγνησία, Σποράδες EL62 - Ιόνια Νησιά EL621 - Ζάκυνθος EL622 - Κέρκυρα EL623 - Ιθάκη, Κεφαλληνία EL624 - Λευκάδα EL63 - Δυτική Ελλάδα EL631 - Αιτωλοακαρνανία EL632 - Αχάια EL633 - Ηλεία EL64 - Στερεά Ελλάδα EL641 - Βοιωτία EL642 - Εύβοια EL643 - Ευρυτανία EL644 - Φθιώτιδα EL645 - Φωκίδα EL65 - Πελοπόννησος EL651 - Αργολίδα, Αρκαδία EL652 - Κορινθία EL653 - Λακωνία, Μεσσηνία ITC - Nord-Ovest ITC1 - Piemonte ITC11 - Torino ITC12 - Vercelli ITC13 - Biella ITC14 - Verbano-Cusio-Ossola ITC15 - Novara ITC16 - Cuneo ITC17 - Asti ITC18 - Alessandria ITC2 - Valle d'Aosta/Vallée d'Aoste ITC20 - Valle d'Aosta/Vallée d'Aoste ITC3 - Liguria ITC31 - Imperia ITC32 - Savona ITC33 - Genova ITC34 - La Spezia ITC4 - Lombardia ITC41 - Varese ITC42 - Como

ITC43 – Lecco ITC44 - Sondrio EN 3 EN ITC46 - Bergamo
 ITC47 - Brescia ITC48 - Pavia ITC49 - Lodi ITC4A -Cremona
 ITC4B - Mantova ITC4C – Milano ITC4D - Monza e della
 Brianza ITF - Sud ITF1 - Abruzzo ITF11 - L'Aquila ITF12 -
 Teramo ITF13 -Pescara ITF14 - Chieti ITF2 - Molise ITF21 -
 Isernia ITF22 - Campobasso ITF3 – Campania ITF31 - Caserta
 ITF32 - Benevento ITF33 - Napoli ITF34 - Avellino ITF35 -
 Salerno ITF4 -
 Puglia ITF43 - Taranto ITF44 - Brindisi ITF45 -
 Lecce ITF46 - Foggia ITF47 - Bari ITF48 -
 Barletta-Andria-Trani ITF5 - Basilicata ITF51 -
 Potenza ITF52 - Matera ITF6 - Calabria ITF61 -
 Cosenza ITF62 - Crotone ITF63 - Catanzaro
 ITF64 - Vibo Valentia ITF65 - Reggio di Calabria
 ITG - Isole ITG1 - Sicilia ITG11 - Trapani ITG12 -
 Palermo ITG13 - Messina ITG14 - Agrigento
 ITG15 - Caltanissetta ITG16 - Enna ITG17 -
 Catania ITG18 - Ragusa ITG19 - Siracusa ITG2 -
 Sardegna ITG2D - Sassari ITG2E - Nuoro ITG2F -
 Cagliari EN 4 EN ITG2G - Oristano ITG2H - Sud
 Sardegna ITH3 - Veneto ITH31 - Verona ITH32 -
 Vicenza ITH33 - Belluno ITH34 - Treviso ITH35 -
 Venezia ITH36 - Padova ITH37 - Rovigo ITH4 -
 Friuli-Venezia Giulia ITH41 - Pordenone ITH42 -
 Udine ITH43 - Gorizia ITH44 - Trieste ITH5 -
 Emilia-Romagna ITH51 - Piacenza ITH52 -
 Parma ITH53 - Reggio nell'Emilia ITH54 -
 Modena ITH55 - Bologna ITH56 - Ferrara ITH57
 - Ravenna ITH58 - Forlì-Cesena ITH59 - Rimini
 ITI - Centro (IT) ITI1 - Toscana ITI11 - Massa-
 Carrara ITI 12 - Lucca ITI13 - Pistoia ITI14 -
 Firenze ITI 15 - Prato ITI16 - Livorno ITI 17 - Pisa
 ITI 18 - Arezzo ITI19 - Siena ITI1A - Grosseto ITI2
 - Umbria ITI21 - Perugia ITI22 - Terni ITI3 -
 Marche ITI31 - Pesaro e Urbino ITI32 - Ancona
 ITI33 - Macerata ITI34 - Ascoli Piceno ITI35 -
 Fermo ITI4 - Lazio ITI41 - Viterbo ITI42 - Rieti
 ITI43 - Roma ITI44 - Latina ITI45 - Frosinone
 MTO - Malta MTOO - Malta EN 5 EN MT001 -
 Malta MT002 - Gozo and Comino/G'Tiawdex u Kemmuna -
 MKO - Северна Македонка MKOO
 - Северна Македонка MK001 - Вардарски
 MK002 - Источен MKOO3 -ЈуроЗанафлеH
 MK004 - ЈунонСТОHeH MK005 - Пелагониски
 MK006 - Полошки MK007 - Северонсточен
 MK008 - Скопски PT15 - Algarve PT150 -
 Algarve PT17 - Area Metropolitana de Lisboa
 PT170 - Area Metropolitana de Lisboa PT18 -
 Alentejo PT181 - Alentejo Litoral PT184 - Baixo
 Alentejo PT185 - Lezíria do Tejo PT186 - Alto
 Alentejo PT187 - Alentejo Central SIO -
 Slovenija SI03 - Vzhodna Slovenija SI031 -
 Pomurska SI032 - Podravska SI033 - Koroška
 SI034 - Savinjska SI035 - Zasavska SI036 -
 Posavska SI037 - Jugovzhodna Slovenija SI038 -
 Primorsko-notranjska SI04 - Zahodna Slovenija
 SI041 - Osrednjeslovenska SI042 - Gorenjska
 FRJ - Occitanie FRJ1 - Languedoc-Roussillon
 FRJ11 - Aude FRJ12 - Gard FRJ 13 - Hérault
 FRJ14 - Lozère FRJ15 - Pyrénées-Orientales
 FRJ2 - Midi-Pyrénées FRJ21 - Ariège FRJ22 -

Aveyron FRJ23 - Haute-Garonne FRJ24 - Gers
 FRJ25 - Lot FRJ26 - Hautes-Pyrénées FRJ27 -
 Tarn FRJ28 - Tarn-et-Garonne EN 6 EN FRK2 -
 Rhone-Alpes FRK21 - Ain FRK22 - Ardèche
 FRK23 - Drome FRK24 - Isere FRK25 - Loire
 FRK26 - Rhone FRK27 - Savoie FRK28 - Haute-
 Savoie FRL - Provence-Alpes-Côte d'Azur FRLO -
 Provence-Alpes-Cote d'Azur FRL01 - Alpes-de-
 Haute-Provence FRL02 - Hautes-Alpes FRL03 -
 Alpes-Maritimes FRL04 - Bouches-du-Rhône
 FRL05 - Var FRL06 - Vaucluse FRM - Corse
 FRMO - Corse FRM01 - Corse-du-Sud FRM02 -
 Haute-Corse SI043 - Goriška SI044 - Obalno-
 kraška ES24 - Aragon ES241 - Huesca ES242 -
 Teruel ES243 - Zaragoza ES3 - Comunidad de
 Madrid ES30 - Comunidad de Madrid ES300 -
 Madrid ES42 - Castilla-La Mancha ES421 -
 Albacete ES422 - Ciudad Real ES423 - Cuenca
 ES424 - Guadalajara ES425 - Toledo ES43 -
 Extremadura ES431 - Badajoz ES432 - Cáceres
 ES5 - Este ES51 - Cataluna ES511 - Barcelona
 ES512 - Girona ES513 - Lleida ES514 -
 Tarragona ES52 - Comunitat Valenciana ES521
 - Alicante/Alacant ES522 - Castellon/Castello
 ES523 - Valencia/València ES53 - Hies Balears
 ES531 - Eivissa y Formentera ES532 - Mallorca
 ES533 - Menorca ES6 - Sur EN 7 EN ES61 -
 Andalucía ES611 - Almeria ES612 - Cadiz ES613
 - Cordoba ES614 - Granada ES615 - Huelva
 ES616 - Jaén ES617 - Malaga ES618 - Sevilla
 ES62 - Region de Murcia ES620 - Murcia ES63 -
 Ciudad de Ceuta ES630 - Ceuta ES64 - Ciudad
 de Melilla ES640 - Melilla - Vlore BG3 -
 Северна и Югоизточна България BG31 -
 Северозападен BG311 - Видин BG312 -
 Монтана BG313 - Враца BG314 - Плевен
 BG315 - Ловеч BG32 - Северен централен
 BG321 - Велико Търново BG322 - Габрово
 BG323 - Русе BG324 - Разград BG325 -
 Силистра BG33 - Североизточен BG331 -
 Варна BG332 - Добрич BG333 - Шумен BG334
 - Търговище BG34 - Югоизточен BG341 -
 Бургас BG342 - Сливен BG343 - Ямбол BG344
 - Стара Загора EN 8 EN BG4 - Югозападна и
 Южна централна България BG41 -
 Югозападен BG411 - София (столица) BG412
 - София BG413 - Благоевград BG414 - Перник
 BG415 - Кюстендил BG42 - Южен централен
 BG421 - Пловдив BG422 - Хасково BG423 -
 Пазарджик BG424 - Смолян BG425 -
 Кърджали BA - Bosnia and Herzegovina BAOO1
 - Brčko District BA002 - Bashkitë HRO -
 Hrvatska HR02 - Panonska Hrvatska HR021 -
 Bjelovarsko-bilogorska županija HR022 -
 Virovitičko-podravska županija HR023 -
 Požeško-slavonska županija HR024 - Brodsko-
 posavska županija HR025 - Osječko-baranjska
 županija HR026 - Vukovarsko-srijemska
 županija HR027 - Karlovačka županija HR028 -
 Sisačko-moslavačka županija HR03 - Jadranska
 Hrvatska HR031 - Primorsko-goranska županija
 HR032 - Ličko-senjska županija HR033 -

Zadarska županija HR034 - Šibensko-kninska županija HR035 - Splitsko-dalmatinska županija HR036 - Istarska županija HR037 - Dubrovačko-neretvanska županija HR05 - Grad Zagreb HR050 - Grad Zagreb HR06 - Sjeverna Hrvatska HR061 - Međimurska županija HR062 - Varaždinska županija HR063 - Koprivničko-križevačka županija HR064 - Krapinsko-zagorska županija HR065 - Zagrebačka županija CY0 - Κύπρος CY00 - Κύπρος CY000 - Κύπρος EL3 - Αττική EL30 - Αττική EL301 - Βόρειος Τομέας Αθηνών EL302 - Δυτικός Τομέας Αθηνών EL303 - Κεντρικός Τομέας Αθηνών EL304 - Νότιος Τομέας Αθηνών EL305 - Ανατολική Αττική EL306 - Δυτική Αττική EL307 - Πειραιάς, Νήσοι EN 9 EN EL4 - Νησιά Αιγαίου, Κρήτη MEO - Црна Гора, MEOO - Црна Гора -ME000 - Црна Гора.
--

Neni 6

Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi

Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi fillon me hyrjen në fuqi ose me zbatimin e përkohshëm të saj, në përputhje me nenin 57 të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe përfundon 15 vite pas kësaj date.

Pjesa e dytë

Zbatimi i programit

Seksioni një

Rregullat e zbatueshme për të gjithë programin

Neni 7

Parimet e zbatimit

1. Programi zbatohet në menaxhim të përbashkët me shtetin anëtar përkatës, në përputhje me parimet e përmendura në nenin 63 të rregullores financiare dhe në përputhje me kushtet e përgjithshme të parashikuara në këtë Marrëveshje, legjislacionin në fuqi të Palëve, dokumentet e programit dhe konfirmimin me shkrim nga Shqipëria lidhur me pjesëmarrjen e saj në program për periudhën e financimit 2021–2027.

2. Vendet pjesëmarrëse bashkëpunojnë plotësisht me autoritetet e përbashkëta të programit (Autoriteti Menaxhues, duke përfshirë Sekretariatit e Përbashkët, organin përgjegjës për funksionet e kontabilitetit dhe Autoritetin e Auditimit), të renditura në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim zbatimin e programit, ndërkohë që mbështesin funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, të përmendura të “Përshkrimi i sistemeve të menaxhimit, financiare dhe të kontrollit”, siç përcaktohet në seksionin 5 të Marrëveshjes së Financimit.

3. Dispozitat zbatuese, të tilla si kërkesat formale në drejtim të përfituesve, rregullat për vlerësimin e projektit, miratimin, kontraktimin dhe legjitimitetin e shpenzimeve, si dhe procedurat e raportimit dhe pagesës, janë përcaktuar në dokumentet e renditura në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje Financimi. Këto dispozita zbatuese janë detyruese për zbatimin e programit.

Neni 8

Parimet horizontale

Palët garantojnë respektimin e parimeve dhe të të drejtave të përmendura në nenin 9 të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 9

Parimi i partneritetit

Në përputhje me nenin 8 të rregullores (BE) 2021/1060 dhe me Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetet, të krijuar nga rregullorja e deleguar e Komisionit (BE) nr. 240/2014, vendet pjesëmarrëse organizojnë dhe vënë në zbatim një partneritet gjithëpërfshirës në përputhje me kuadrin e tyre institucional dhe ligjor, duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të programit.

Neni 10

Zhvillimi i territorit

Programi mund të ofrojë mbështetje për zhvillimin e integruar të territorit në përputhje me nenet 20 dhe 21 të rregullores (BE) 2021/1059 dhe nenet 28 deri në 34 të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 11

Ndërprerja e programit

1. Në lidhje me këtë program, pjesëmarrja e një vendi partner ndërpritet:
 - a) nëse asnjë prej vendeve partnere të mbuluara nga programi nuk e ka nënshkruar marrëveshjen përkatëse të financimit brenda datës 31 dhjetor të vitit që pason vitin në të cilin është kryer angazhimi i parë buxhetor; ose
 - b) nëse Programi nuk mund të zbatohet siç është planifikuar për shkak të problemeve në marrëdhëniet ndërmjet vendeve pjesëmarrëse;
 - c) në çdo rast tjetër të justifikuar siç duhet.
2. Shtetet anëtare pjesëmarrëse dhe, sipas rastit, vendet e tjera partnere pjesëmarrëse kërkojnë:
 - a) ndërprerjen e programit Interreg, veçanërisht në rastet kur sfidat kryesore të përbashkëta të zhvillimit nuk mund të arrihen pa pjesëmarrjen e atij vendi partner;
 - b) reduktimin e alokimeve për atë program Interreg, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi;
 - c) vazhdimin e programit Interreg pa pjesëmarrjen e atij vendi partner.

Seksioni dy

Autoritetet dhe organet e programit

Neni 12.1

Lista e autoriteteve të programit

Programi menaxhohet dhe zbatohet në përputhje me rregullat për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të përmendura në rregulloren (BE) 2021/1060 dhe rregulloren (BE) 2021/1059, nga autoritetet e mëposhtme të programit: Autoriteti Menaxhues, i përmendur në nenin 12, paragrafi 3, i mbështetur nga Sekretariati i Përbashkët i përmendur në nenin 12, paragrafi 4, organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit, i përmendur në nenin 12, paragrafi 6 dhe Autoriteti i Auditimit i përmendur në nenin 12, paragrafi 7.

Autoriteti Kombëtar i përmendur në nenin 12, paragrafi 3 bashkëpunon me autoritetet e programit.

Neni 12.2

Komiteti i Monitorimit

1. Në bashkëpunim me Autoritetin Menaxhues, vendet pjesëmarrëse krijojnë një komitet për të monitoruar zbatimin e programit ("Komiteti i Monitorimit"), brenda tre muajve nga data e njoftimit të shteteve anëtare pjesëmarrëse mbi vendimin e Komisionit që miraton programin në përputhje me nenin 28, paragrafi 1 të rregullores (BE) 2021/1059.

2. Përbërja e Komitetit të Monitorimit të programit miratohet bashkërisht nga partnerët e programit dhe bazohet në numrin e shteteve anëtare pjesëmarrëse, si dhe të vendeve partnere në program.

3. Përbërja e komitetit garanton gjithashtu një përfaqësim të ekuilibruar të:

- a) autoriteteve përkatëse, duke përfshirë të organeve ndërmjetëse;
- b) organeve të krijuara bashkërisht në të gjithë zonën e programit ose që mbulojnë një pjesë të zonës së programit, ku përfshihet Grupimi Evropian i Bashkëpunimit Territorial (GEBT-të); dhe
- c) përfaqësuesve të partnerëve të programit të përmendur në nenin 9.

4. Funksionet e Komitetit të Monitorimit përcaktohen në nenin 30 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 12.3

Autoriteti Menaxhues dhe Autoriteti Kombëtar

1. Në përputhje me nenin 45, paragrafi 1 dhe 3 të rregullores (BE) 2021/1059, vendet pjesëmarrëse kanë përcaktuar rajonin "Provence-Alpes-Côte d'Azur", si Autoriteti i vetëm Menaxhues, për qëllimet e nenit 71 të rregullores (BE) 2021/1060.

2. Funksionet e Autoritetit Menaxhues përcaktohen në nenin 46 të rregullores (BE) 2021/1059.

3. Shqipëria ka përcaktuar Agjencinë Shtetërore të programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës të Shqipërisë, në varësi të Kryeministrit, si Autoritetin Kombëtar që ka përgjegjësinë absolute për zbatimin e programit në territorin e saj dhe që garanton bashkëpunimin me Autoritetin Menaxhues, autoritetet e tjera të programit, Komitetin e Monitorimit dhe Komisionin.

4. Autoriteti Kombëtar mbështet Autoritetin Menaxhues në të gjitha detyrat e tij rutinë, të tilla si menaxhimi i programit, verifikimet e lidhura me menaxhimin, menaxhimi financiar, monitorimi, raportimi, vlerësimi dhe komunikimi.

5. Përfaqësuesi i Komitetit të Monitorimit nga Shqipëria, i cili përfaqëson Autoritetin Kombëtar, si dhe zëvendësi i tij, janë personat kryesorë të kontaktit për autoritetet dhe organet drejtuese të programit lidhur me zbatimin e programit në Shqipëri.

Neni 12.4

Sekretariati i Përbashkët

1. Autoriteti Menaxhues, pas konsultimit me vendet pjesëmarrëse, krijon një Sekretariat të Përbashkët, stafi i të cilit pasqyron partneritetin e programit, në përputhje me nenin 46, paragrafi 2 të rregullores (BE) 2021/1059.

2. Sekretariati i Përbashkët asiston Autoritetin Menaxhues dhe Komitetin e Monitorimit në kryerjen e funksioneve të tyre përkatëse. Sekretariati i përbashkët jep gjithashtu informacione për përfituesit e mundshëm lidhur me mundësitë e financimit në kuadër të programit, si dhe asiston përfituesit dhe partnerët në zbatimin e operacioneve në përputhje me nenin 46, paragrafi 2 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 12.5

Kontrollori kombëtar

1. Duke deroguar nga germa "a" e nenit 74, paragrafi 1 të rregullores (BE) 2021/1060 dhe pa cenuar nenin 45, paragrafi 5 të kësaj rregulloreje, shtetet anëtare dhe sipas rastit, vendi i tretë, vendi

partner ose një vend dhe territor jashtë Evropës (OCT) që marrin pjesë në programin Interreg, mund të vendosin që verifikimet e lidhura me menaxhimin, të përmendura në germën “a” të nenit 74, paragrafi 1 të rregullores (BE) 2021/1060, të kryhen përmes organit ose personit kompetent të caktuar për këtë qëllim nga secili shtet anëtar në territorin e tij (“Kontrollori kombëtar”).

Shqipëria ka caktuar në funksionin e Kontrollorit Kombëtar një strukturë të kontraktuar nga Autoriteti Kombëtar, e cila do të mbështesë Autoritetin Menaxhues gjatë detyrave të tij të kontrollit, veçanërisht për kryerjen e verifikimeve të lidhura me menaxhimin në territorin e Shqipërisë.

2. Pas emërimit, Kontrollori Kombëtar kryen verifikimet e lidhura me menaxhimin në përputhje me paragrafët 3 deri në 5 të nenit 46 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 12.6

Funksioni i kontabilitetit

Ministria e Financave dhe e Administratës Publike (Spanjë) ngarkohet me realizimin e funksionit të kontabilitetit në përputhje me nenin 47 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 12.7

Autoriteti i Auditimit dhe Grupi i Audituesve

1. Vendet pjesëmarrëse kanë përcaktuar autoritetin publik “Commission Interministérielle de Coordination des Contrôles et Actions cofinancées par les Fonds européens” (CICC), me seli në Francë, si Autoriteti i vetëm i Auditimit.

2. Një grup audituesish asiston Autoritetin e Auditimit, i cili përbëhet nga përfaqësues nga Bullgaria, Greqia, Spanja, Franca, Kroacia, Italia, Qiproja, Malta, Portugalia, Sllovenia, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, të cilët do të jenë përgjegjës për auditimet e kryera në territorin e tyre përkatës.

3. Si përfaqësues të saj në Grupin e Audituesve, Shqipëria ka caktuar Agjencinë e Auditimit të programeve të Asistencës të Akredituar nga BE-ja.

4. Funksionet e Autoritetit të Auditimit dhe të Grupit të Audituesve përshkruhen në nenin 48 të rregullores (BE) 2021/1059.

Seksioni tre

Dispozitat e legjitimitetit

Neni 13

Hierarkia e rregullave të legjitimitetit

Legjitimiteti i operacioneve dhe shpenzimeve në kuadër të programit rregullohet nga nenet 63 deri në 68 të rregullores (BE) 2021/1060, nenet 5 dhe 7 të rregullores (BE) 2021/1058 dhe nenet 37 deri në 44 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 14

Partneriteti i projektit

Partneriteti në operacionet e zbatuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje garantohet në përputhje me nenin 23 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 15

Përzgjedhja e projektit

Operacionet për zgjidhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 22 të rregullores (BE) 2021/1059.

Komiteti i Monitorimit përcakton dhe zbaton kritere dhe procedura jodiskriminuese dhe transparente, garanton aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe barazinë gjinore, si dhe vepron në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16 të saj, si dhe me nenin 14 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së.

Neni 16

Rregullat e prokurimit të aplikuara nga subjektet që zbatojnë operacione në kuadër të programit

Në rastet kur zbatimi i një operacioni kërkon prokurimin e shërbimit, lidhjen e kontratave të furnizimit ose të punëve nga një përfitues nga Shqipëria, atëherë zbatohen procedurat e prokurimit të përcaktuara në shtojcën II.

Seksioni katër

Dispozitat financiare

Neni 17

Dispozita të përgjithshme

Në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, buxheti i programit zbatohet në një mënyrë të tillë që garanton ekzekutimin e duhur dhe efikas të masave të financuara nga buxheti, në përputhje me aktet bazë të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

Neni 18

Angazhimet buxhetore

Bazuar në vendimin zbatues të Komisionit C(2022) 3715 që miraton programin ("vendimi për miratimin e programit"), Komisioni realizon angazhime buxhetore të fondeve Interreg në këste vjetore për secilin fond, gjatë periudhës 1 janar 2022–31 dhjetor 2027.

Neni 19

Pagesat

1. Pagesat nga Komisioni do të marrin formën e financimit paraprak, pagesave të përkohshme dhe pagesave të bilancit të llogarive për vitin kontabël.

2. Në përputhje me nenin 51, paragrafi 2 të rregullores (BE) 2021/1059, financimi paraprak për secilin fond paguhet në këste vjetore, në varësi të disponueshmërisë së fondeve. Kësti i parë do të paguhet jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të vendimit dhe këstet e mëvonshme do të paguhet përpara datës 1 korrik të çdo viti, si më poshtë:

- a) 2022: 1% e totalit të alokimit nga BE-ja;
- b) 2023: 3% e totalit të alokimit nga BE-ja;
- c) 2024: 3% e totalit të alokimit nga BE-ja;
- d) 2025: 3% e totalit të alokimit nga BE-ja;
- e) 2026: 3% e totalit të alokimit nga BE-ja;

3. Kontributi nga fondet Interreg për programin paguhet në një llogari të vetme pa nënlllogari kombëtare, që menaxhohet nga Ministria e Financave dhe e Administratës Publike (Spanjë), i cili është organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit.

4. Interesat e gjeneruara nga financimi paraparak do të përdoren për programin në të njëjtën mënyrë si alokimi nga BE-ja dhe do të përfshihen në llogaritë e vitit kontabël përfundimtar.

5. Aplikimet për pagesa dorëzohen pranë Komisionit nga Ministria e Financave dhe e Administratës Publike (Spanjë), i cili është organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit.

6. Ministria e Financave dhe e Administratës Publike (Spanjë), që është organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit, si rregull i përgjithshëm, i paguan partnerit kryesor shumat e plota, jo më vonë se 80 ditë nga data e dorëzimit të pretendimit për pagesë nga përfituesi kryesor, përveçse kur Shqipëria është subjekt i masave kufizuese të BE-së.

Megjithatë, afati prej 80 ditësh mund të ndërpritet nëse informacioni i dorëzuar nga përfituesi kryesor nuk i krijon mundësinë Ministrisë së Financave dhe Administratës Publike (Spanjë), që është organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit, të përcaktojë nëse shuma duhet paguar.

Neni 20

Ndërprerja e afateve të pagesave

1. Komisioni mund të ndërpresë afatin e pagesës për një periudhë maksimale prej 6 muajsh nëse përmbushet një nga kushtet në vijim:

- a) ka prova që sugjerojnë një mangësi të rëndë për të cilën nuk janë marrë masa korrigjuese;
- b) Komisioni duhet të kryejë verifikime shtesë pas marrjes së informacionit se shpenzimi në një aplikim për pagesë mund të jetë i lidhur me një parregullsi.

2. Autoriteti Menaxhues mund të bjerë dakord që ta zgjasë me 3 muaj periudhën e ndërprerjes.

Neni 21

Pezullimi i pagesave

1. Komisioni mund të pezullojë të gjitha pagesat ose një pjesë të tyre pasi t'i ketë dhënë Autoritetit Menaxhues mundësinë për të paraqitur konstatimet e tij, nëse përmbushet një nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti Menaxhues nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të korrigjuar situatën që ka shkaktuar një ndërprerje sipas nenit 20;
- b) ekziston një mangësi e rëndë;
- c) shpenzimi në aplikimet për pagesa është i lidhur me një parregullsi që nuk është korrigjuar;
- d) Komisioni ka dhënë një opinion të arsyetuar lidhur me një procedurë shkeljeje (sipas nenit 258 të TFBE-së) për një çështje që vendos në rrezik ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimit.

2. Komisioni i jep fund pezullimit të të gjitha pagesave ose të një pjese prej tyre kur Autoriteti Menaxhues ka marrë masat për të korrigjuar elementet e përmendura në paragrafin 1.

Neni 22

Rimbursimi i asistencës teknike

1. Asistenca teknike në këtë program rimbursohet nga Komisioni për Autoritetin Menaxhues në formën e një norme të sheshtë duke aplikuar përqindjet e përcaktuara në paragrafin 2 për shpenzimet legjitime të përfshira në çdo aplikim për pagesë (sipas germave “a” ose “c” të nenit 91, paragrafi 3 të rregullores (BE) 2021/1060, sipas rastit).

2. Përqindja e kontributit të fondeve Interreg të BE-së, që do të rimbursohen për asistencë teknike është në vlerën 8%.

Neni 23

Dorëzimi dhe shqyrtimi i llogarive

Procedura e dorëzimit dhe shqyrtimit të llogarive është në përputhje me rregullat e përcaktuara në kapitullin II të titullit VII të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 24 Anulimet

Komisioni zbaton rregullat për procedurën e anulimeve dhe për përjashtimet nga rregullat për anulimin, siç përcaktohet në nenet 105 deri në 107 të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 25 Dispozitat e këmbimit valutor dhe transferimi i fondeve

1. Në përputhje me nenin 38, paragrafi 5 të rregullores (BE) 2021/1059, shpenzimet e paguara në një monedhë të ndryshme nga euro konvertohen në euro nga çdo partner duke përdorur normën e këmbimit mujor kontabël të Komisionit, të ditës kur shpenzimi në fjalë është dorëzuar për verifikim.

2. Shqipëria merr masa për t'u mundësuar përfituesve shqiptarë, sipas rastit:

a) që të marrin fondet e ofruara në kuadër të kontributit financiar të BE-së për qëllime të programit dhe të hapin llogari bankare specifike, duke përfshirë llogaritë në euro;

b) që të bëjnë pagesa në përputhje me kërkesat kontraktuale për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për zbatimin e operacionit, duke përfshirë mundësinë e përfituesit kryesor që të rishpërndajë shumën e grantit për përfituesit e tjerë.

Seksioni pesë Menaxhimi i qëndrueshëm financiar në lidhje me zbatimin e programit

Neni 26 Dispozita të përgjithshme

1. Palët respektojnë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, transparencës dhe mosdiskriminimit, si dhe garantojnë vizibilitetin e veprimeve të BE-së gjatë menaxhimit të fondeve të BE-së. Për këtë qëllim, Palët përmbushin detyrimet e tyre përkatëse të kontrollit dhe auditimit, si dhe marrin përsipër përgjegjësitë përkatëse të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Vendet pjesëmarrëse bien dakord për një sistem menaxhimi dhe kontrolli për programin, në përputhje me nenet 69 deri në 72, 74 deri në 76 dhe 78 deri në 82 të rregullores (BE) 2021/1060 dhe nenet 22, 30, paragrafi 2 dhe 46 deri në 49 të rregullores (BE) 2012/159 dhe me dokumentin "Përshkrim i sistemeve të menaxhimit, financiare dhe të kontrollit", si dhe garantojnë funksionimin e tij në përputhje me menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe kërkesat kryesore të renditura në shtojcën XI të rregullores 2021/1060.

3. Për qëllime të zbatimit të këtij seksioni, autoritetet dhe organet e programit bashkëpunojnë ngushtësisht me Palët në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tyre përkatëse.

4. Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre në territorin shqiptar, autoritetet e programit, agjentët e BE-së dhe organet hetimore të BE-së veprojnë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

5. Gjatë ekzekutimit të detyrave të lidhura me zbatimin e buxhetit, Palët marrin të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme, duke përfshirë masat ligjore, rregullatore dhe administrative, për të mbrojtur me efikasitet interesat financiare të BE-së.

Neni 27 Qëllimi i verifikimeve të lidhura me menaxhimin

Kontrollori Kombëtar shqiptar, me mbështetjen e Autoritetit Kombëtar, kryen verifikime të lidhura me menaxhimin në territorin e tij për të verifikuar nëse:

a) produktet dhe shërbimet e bashkëfinancuara janë ofruar;

b) operacionet janë në përputhje me nenin 74, paragrafi 1, germa “a” të rregullores (BE) 2021/1060, me programin dhe me kushtet për mbështetjen e operacionit.

Autoriteti Menaxhues sigurohet se shpenzimet e përfituesve që marrin pjesë në një operacion janë verifikuar nga Kontrollori Kombëtar.

Neni 28

Procedurat e auditimit dhe shqyrtimit

1. Bashkimi Evropian ka të drejtën të kryejë procedura të përshtatshme teknike, shkencore dhe financiare të lidhura me auditimin dhe shqyrtimin, duke përfshirë për të realizuar kontrole në terren në përputhje me nenet 48 dhe 49 të rregullores (BE) 2021/1059 dhe nenin 79 të rregullores (BE) 2021/1060, në ambientet e çdo personi fizik që banon në Shqipëri ose të çdo personi juridik të themeluar në Shqipëri dhe që merr fonde të BE-së, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit Evropian që banon në Shqipëri ose të themeluar në Shqipëri.

Këto shqyrtime dhe auditime mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (ZEKM), Gjykatës Evropiane të Audituesve, Zyrës së Prokurorit Publik Evropian (ZPPE), ose nga persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi të BE-së.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të BE-së, në veçanti agjentët e Komisionit, të ZEKM-së dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve, si dhe personat e tjerë të mandatuar nga Komisioni, kanë aksesin e duhur në ambiente, punime dhe dokumente (në versionet elektronike, versionet fizike, ose në të dyja), si dhe në të gjithë informacionin e nevojshëm për të realizuar këto auditime, shqyrtime dhe kontrole, siç përmendet në paragrafin 1, në përputhje me nenin 82 të rregullores (BE) 2021/1060 dhe nenin 40 të kësaj Marrëveshjeje. Ky akses përfshin të drejtën për të marrë kopje fizike ose elektronike dhe ekstrakte të çdo dokumenti ose përmbajtje nga çdo instrument i të dhënave që zotërohet nga personat fizikë ose juridikë të audituar ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk pengon ose nuk krijon pengesa të panevojshme lidhur me zbatimin e së drejtës për të hyrë në Shqipëri dhe për të aksesuar ambientet e personave të audituar, nga ana e agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2, të cilët janë të mandatuar për të realizuar kontrole në terren në kuadër të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2 u jepet akses në të gjitha informacionet dhe dokumentet e kërkuara, për qëllime të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen, me kusht që të mbrohen sekretet tregtare dhe të ruhet konfidencialiteti i hetimeve lidhur me palët e treta, në përputhje me nenin 72, paragrafi 1, germa “e” dhe shtojcën XII (seksioni 1.5), shtojcën XIV (seksionet 1.1 dhe 2.4), shtojcën XV (seksionet 2.4, germa “g” dhe 2.5) dhe shtojcën XVI (seksioni 4.1.6) të rregullores (BE) 2021/1060, që zbatohet për agjentët dhe personat e tjerë të përmendur në paragrafin 2. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të regjistruara në një mënyrë të tillë që lejon inspektimin e lehtë të tyre.

5. Shqipëria dhe, sipas rastit, autoritetet e programit, njoftohen mbi kontrollet në terren nga agjentët ose audituesit e jashtëm të caktuar ose të mandatuar nga Autoriteti Menaxhues, Autoriteti i Auditimit, Komisioni, ZEKM-ja ose Gjykata Evropiane e Audituesve.

6. Pavarësisht pezullimit ose zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje sipas neneve 55 dhe 56, shqyrtimet dhe auditimet e parashikuara në këtë nen mund të kryhen edhe për 5 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të pezullimit ose zgjidhjes së Marrëveshjes.

Neni 29

Auditimet nga Autoriteti i Auditimit dhe Grupi i Audituesve

Në përputhje me nenet 48 dhe 49 të rregullores (BE) 2021/1059, Autoriteti i Auditimit do të asistohet nga përfaqësuesi shqiptar në Grupin e Audituesve të programit dhe është përgjegjës për kryerjen e një numri të përshtatshëm auditimesh, duke përfshirë ato mbi operacionet dhe auditimet

e llogarive në territorin e tij, për t'i ofruar Komisionit garanci të pavarur se sistemet e menaxhimit dhe kontrollit funksionojnë me efikasitet dhe se shpenzimet e përfshira në llogaritë e dorëzuara pranë Komisionit janë të ligjshme dhe të rregullta.

Neni 30

Parandalimi dhe zbulimi i parregullsive, mashtrimit dhe veprave të tjera penale, që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian

1. Autoriteti Kombëtar dhe Kontrollori Kombëtar që mbështesin Autoritetin Menaxhues, garantojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të përfshira në llogaritë e dorëzuara pranë Komisionit dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe raportimin e parregullsive dhe veprimtarive mashtruese lidhur me Programin.

2. Autoriteti Kombëtar, Kontrollori Kombëtar dhe përfaqësuesi shqiptar i Grupit të Audituesve bashkëpunojnë me Komisionin, ZEKM-në, Gjykatën e Audituesve dhe autoritetet e programit për të gjitha çështjet lidhur me zbulimin dhe raportimin e parregullsive, duke përfshirë edhe ato që lidhen me çdo mashtrim të dyshuar apo të konstatuar dhe me rikuperimin e shumave të paguara në mënyrë të parregullt.

3. Korrigjimet financiare nga Autoriteti Menaxhues ose Komisioni bëhen në përputhje përkatësisht me nenin 33 ose 34.

4. Rikuperimi i shpenzimeve të parregullta, duke përfshirë përmes kompensimit, nga Komisioni, Autoriteti Menaxhues dhe partneri kryesor bëhet siç përcaktohet në nenin 32.

5. Autoritetet dhe organet e renditura në paragrafin 2 vendosin, rast pas rasti, nëse do t'i realizojnë bashkërisht inspektimet dhe kontrollet në terren, duke përfshirë edhe në rastet kur të dyja palët janë kompetente për të realizuar hetime.

6. Kur një përfitues shqiptar ose një tjetër palë e tretë e kundërshton inspektimin ose kontrollin në terren, atëherë Autoriteti Kombëtar ose përfaqësuesi në Grupin e Audituesve, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, asiston Komisionin ose ZEKM-në, GJEA-në, ose autoritetet e programit, me qëllim që t'u lejojë përmbushjen e detyrës së tyre në realizimin e të gjitha inspektimeve ose kontrolleve në terren. Kjo asistencë përfshin marrjen e masave të përkohshme të përshtatshme për të mbrojtur interesat financiare të Bashkimit Evropian, të cilat nuk duhet të jenë më pak efektive se masat e zbatueshme në përputhje me legjislacionin e brendshëm për të mbrojtur interesat financiare kombëtare, duke përfshirë masat e nevojshme për mbrojtjen e evidencave.

7. Komisioni ose ZEKM-ja, GJEA-ja apo autoritetet menaxhuese informojnë autoritetet shqiptare mbi rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni ose ZEKM-i i raporton Autoritetit Menaxhues dhe Autoritetit Kombëtar, sa më shpejt të jetë e mundur, çdo fakt ose dyshim në lidhje me ndonjë parregullsi të identifikuar gjatë inspektimit ose kontrollit në terren.

8. Neni 30, paragrafi 2 zbatohet gjithashtu për kontrollet dhe inspektimet e parashikuara në paragrafët 4 deri në 6 të këtij neni.

9. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni apo ZEKM, ose autoritetet e programit dhe Autoriteti Kombëtar, Kontrollori Kombëtar dhe përfaqësuesi shqiptar në Grupin e Audituesve shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njëres prej Palëve në këtë Marrëveshje, konsultohen me njëri-tjetrin, përveçse kur diçka e tillë është e ndaluar nga legjislacioni i BE-së ose nga ligjet dhe rregulloret shqiptare.

10. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Komisionit ose ZEKM-së, autoriteteve të programit dhe Autoritetit Kombëtar trajtohet në përputhje me nenet 40 dhe 41.

Neni 31

Raportimi i parregullsive

Autoriteti Kombëtar dhe Kontrollori Kombëtar i raportojnë Autoritetit Menaxhues dhe Autoritetit të Auditimit parregullsitë, duke përfshirë mashtrimin, në përputhje me kriteret për

përcaktimin e rasteve të parregullsive që duhen raportuar, të dhënat që duhen siguruar dhe formatin e raportimit të përcaktuar në pikën 1.3 të seksionit 1 të shtojcës III të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 32

Rikuperimi

Autoriteti Menaxhues dhe autoritetet e vendeve pjesëmarrëse respektojnë detyrimet e tyre të rikuperimit siç përcaktohet në nenin 52 të rregullores (BE) 2021/1059.

Neni 33

Korrigjimet financiare nga Autoriteti Menaxhues

Në përputhje me nenin 103 të rregullores (BE) 2021/1060, vendet pjesëmarrëse mbrojnë buxhetin e Bashkimit Evropian dhe aplikojnë korrigjime financiare duke anuluar të gjithë ose një pjesë të mbështetjes nga fondet për një operacion ose program në rastet kur konstatohen shpenzime të parregullta. Ata duhet të informojnë Komisionin rreth çdo shpenzimi të identifikuar dhe/ose të raportuar si të parregullt nga autoritetet kompetente kombëtare, duke përfshirë edhe rastet e shpenzimeve që thjesht dyshohen si të parregullta.

Neni 34

Korrigjimet financiare nga Komisioni

Në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 104 të rregullores (BE) 2021/1060, Komisioni realizon korrigjime financiare duke reduktuar mbështetjen nga fondet për një Program, në rastet kur del në përfundimin, se:

- a) ekziston një mangësi e rëndë që ka vënë në rrezik fondet që janë paguar për programin;
- b) shpenzimet në llogaritë e pranura janë të parregullta dhe nuk janë zbuluar dhe raportuar nga Autoriteti Menaxhues;
- c) Autoriteti Menaxhues nuk ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij sipas nenit 33 për të zbuluar dhe raportuar shpenzimet e konstatuara apo të dyshuara si të parregullta nga autoritetet kompetente kombëtare, përpara hapjes së procedurës së korrigjimit financiar nga Komisioni.

Seksioni gjashtë

Dispozita të ndryshme ligjore

Neni 35

Lehtësimi i lëshimit të vizave

1. Shqipëria lehtëson lëshimin e vizave për personelin e autoriteteve dhe organeve drejtuese të programit, të renditura në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe për përfituesit e parashikuar në nenin 2, paragrafi 9 të rregullores (BE) 2021/1060, për udhëtimet e lidhura me zbatimin dhe menaxhimin e programit dhe të kësaj Marrëveshjeje. Vizat jepen sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Paragrafi 1 zbatohet, sipas rastit, për personat e tjerë fizikë dhe për personat që përfaqësojnë personat juridikë të cilët marrin pjesë në zbatimin e operacioneve.

3. Komisioni inkurajon shtetet anëtare pjesëmarrëse që të lehtësojnë, në kushte të barabarta, lëshimin e vizave për të gjithë aktorët e përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nga Shqipëria për udhëtimet e lidhura me zbatimin e programit dhe të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 36

TVSH-ja, detyrimet e akcizës, detyrimet doganore dhe tatimet e tjera indirekte

Tatimi mbi vlerën e shtuar (“TVSH”), detyrimet e akcizës, detyrimet doganore dhe tatimet e tjera indirekte nuk përfshihen në mbështetjen e Bashkimit Evropian, me përjashtim të fondeve për operacionet, investimet dhe për projektet e vogla të renditura në nenin 64, paragrafi 1, germa “c” të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 37

Lejet dhe autorizimet

1. Autoriteti kompetent shqiptar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, siguron në kohën e duhur të gjitha lejet e nevojshme ose autorizimet e kërkuara për zbatimin e operacioneve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje në Shqipëri.

2. Për sa kohë që është nën kontrollin e autoriteteve shqiptare, Shqipëria garanton se kushtet për personat e përmendur në nenin 35, paragrafi 1, të lidhura me aksesin në ato shërbime në Shqipëri që janë të lidhura drejtpërdrejt me zbatimin e programeve ose të aktiviteteve, janë të njëjta me kushtet për shtetasit shqiptarë, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me tarifën.

Neni 38

Të drejtat e pronësisë intelektuale (ku përfshihet “Përdorimi i studimeve”)

1. Për sa u përket materialeve të komunikimit dhe vizibilitetit, vendet pjesëmarrëse garantojnë se Autoriteti Menaxhues do të përfshijë në çdo Marrëveshje për Grante, kushtet dhe klauzolat e nevojshme në përputhje me nenin 49, paragrafi 6, të rregullores (BE) 2021/1060.

2. Për sa i përket përfuturimit të të gjitha të drejtave të nevojshme të pronësisë intelektuale për teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin, patentat dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime të lehtësimit të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, vendet pjesëmarrëse garantojnë se Autoriteti Menaxhues do të përfshijë në çdo Marrëveshje për Grante, kushtet dhe klauzolat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendeve pjesëmarrëse.

3. Shqipëria garanton se Komisioni, Qeveria e Shqipërisë ose rajoni francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur” apo agjentët përkatës, kanë akses dhe të drejtën për t’i përdorur ose për t’i publikuar këto materiale. Komisioni do t’i përdorë këto materiale vetëm për qëllimet e veta, siç përcaktohet në pikat 2.1 deri në 2.6 të shtojcës IX të rregullores (BE) 2021/1060.

Neni 39

Disponueshmëria e dokumenteve

Shqipëria garanton se përfituesit në Shqipëri, të financuar në kuadër të programit, i mbajnë të gjitha dokumentet mbështetëse, të lidhura me një operacion, në përputhje me nenin 82 të rregullores (BE) 2020/1060.

Neni 40

Përpunimi, mbrojtja dhe transferimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale të personave fizikë që marrin pjesë në program mblidhen, regjistrohen, ruhen dhe transferohen në bazat e të dhënave të autoriteteve dhe organeve drejtuese të programit, në përputhje me ligjin përkatës për përpunimin e të dhënave personale të vendeve pjesëmarrëse.

2. Vendet pjesëmarrëse dhe autoritetet e programit i përpunojnë të dhënat personale vetëm kur diçka e tillë është e nevojshme për qëllime të realizimit të detyrimeve të tyre përkatëse në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe të akteve bazë të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1, në veçanti për qëllime të publikimit, vlerësimit, menaxhimit financiar, verifikimeve dhe auditimeve dhe, sipas rastit, për të përcaktuar përshtatshmërinë e pjesëmarrësve.

3. Vendet pjesëmarrëse, si dhe autoritetet dhe organet drejtuese të programit garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të vendeve pjesëmarrëse.

4. Këto të dhëna transferohen tek organet e kontrollit të BE-së, të renditura në nenin 12 për qëllime të aktiviteteve të tyre.

Neni 41

Publikimi i informacionit

Me përjashtim të informacionit të mbuluar nga detyrimet për komunikimin dhe vizibilitetin, të përmendura në nenet 44 dhe 45, si dhe pa cenuar nenin 28, paragrafi 4 dhe nenin 40, Palët konsultohen me njëra-tjetrën përpara se të publikojnë dokumente, informacione ose materiale të tjera që janë drejtpërdrejt të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni shtatë

Monitorimi, vlerësimi, komunikimi dhe vizibiliteti

Neni 42

Krijimi, funksionimi dhe funksionet e Komitetit të Monitorimit

Krijimi, funksionimi dhe funksionet e Komitetit të Monitorimit respektojnë nenet 28, 29 dhe 30 të rregullores (BE) 2021/1059 dhe jepen në mënyrë të detajuar në dokumentin e programit “Rregullorja e brendshme për Komitetin e Monitorimit të programit”.

Neni 43

Vlerësimi

1. Autoriteti Kombëtar mbështet rajonin francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur” në kryerjen e detyrave të tij të lidhura me vlerësimet gjatë periudhës së realizimit të programit.

2. Në përputhje me nenin 35 të rregullores (BE) 2021/1059, vlerësimet janë të lidhura me një ose disa prej kritereve në vijim: efikasiteti, eficienta, rëndësia, koherenca dhe vlera e shtuar e Bashkimit Evropian dhe kanë si qëllim përmirësimin e cilësisë së hartimit dhe zbatimit të programeve.

Vlerësimet mund të mbulojnë edhe kritere të tjera të rëndësishme, të tilla si përfshirja, mosdiskriminimi dhe vizibiliteti, si dhe mund të mbulojnë më tepër se një program.

Neni 44

Komunikimi

1. Autoriteti Menaxhues ka përcaktuar një oficer komunikimi për programin.

2. Autoriteti Kombëtar i Shqipërisë mbështet Autoritetin Menaxhues dhe partnerët në Shqipëri, siç përmendet në nenin 8, paragrafi 1 të rregullores (BE) 2021/1060, lidhur me detyrat e parashikuara në këtë nen.

Oficeri i komunikimit i programit mbështet gjithashtu koordinatorin e komunikimit në Francë, ku ndodhet Autoriteti Menaxhues, për sa u përket detyrave të tij të lidhura me aktivitetet e vizibilitetit, transparencës dhe komunikimit.

3. Shqipëria mbështet Autoritetin Menaxhues në kryerjen e detyrave të tij për të garantuar se materialet e komunikimit dhe vizibilitetit, duke përfshirë ato në nivel përfituesish, vihen në dispozicion të institucioneve, organeve, zyrave apo agjencive të Bashkimit Evropian, Autoritetit Menaxhues dhe përfituesve, me kërkesë dhe pa kosto shtesë ose pa një barrë të konsiderueshme administrative, dhe se Bashkimit Evropian i jepet një licencë falas, joekskluzive dhe e parevokueshme për përdorimin e këtyre materialeve dhe të të drejtave paraekzistuese të lidhura me to.

Neni 45
Vizibiliteti

1. Autoritetet e programit dhe Shqipëria garantojnë:
 - a) vizibilitetin e mbështetjes në të gjitha aktivitetet e lidhura me operacionet e mbështetura nga fondet Interreg, duke i kushtuar rëndësi të veçantë operacioneve me rëndësi strategjike;
 - b) se qytetarëve të vendeve pjesëmarrëse u komunikohet roli dhe arritjet e Fondit përmes një portali të vetëm në internet që ofron akses në të gjitha programet që përfshijnë shtetin anëtar.
- Ata mbështesin Autoritetin Menaxhues në përmbushjen e përgjegjësisë së tij të përmendura në nenin 49, paragrafi 2 deri në 6 të rregullores (BE) 2021/1060.
2. Autoritetet e programit, Shqipëria dhe përfituesit duhet të përdorin termin “Interreg”, në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me nenin 36 të rregullores (BE) 2021/1059, krahas emblemës së Bashkimit Evropian kur realizojnë aktivitete vizibiliteti, transparence dhe komunikimi.
3. Për sa u përket fondeve për projektet e vogla, përfituesi, përmes kushteve kontraktuale, garanton se marrësit fundorë zbatojnë kërkesat për komunikimin publik të operacioneve Interreg.

Pjesa e tretë
Dispozitat përfundimtare

Neni 46
Adresat dhe komunikimi ndërmjet palëve

- Gjuhët e punës në këtë program janë gjuha angleze dhe frënge.
- Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim, do t'i referohen shprehimisht programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:
- Për BE-në:**
Komisioni Evropian
Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Rajonale dhe Urbane
1049 Bruksel
Belgjikë
- Për rajonin francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur”:**
Region Provence-Alpes-Cote d’Azur Hotel de Region 27, place Jules-Guesde 13481 Marseille Cedex 20
- Për Shqipërinë:**
Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri

Neni 47
Interpretimi i kësaj Marrëveshjeje

1. Në zbatim të çdo dispozite të qartë që parashikon ndryshe, termat e përdorur në këtë Marrëveshje dhe shtojcat e saj kanë të njëjtin kuptim si ai që iu është dhënë në aktet bazë të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.
2. Në rastet kur ka mospërputhje ndërmjet dispozitave në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, mbizotërojnë dispozitat e përfshira në këtë Marrëveshje.
3. Në rastet kur ka mospërputhje ndërmjet dispozitave në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj, nga njëra anë, dhe në aktet bazë, nga ana tjetër, mbizotërojnë dispozitat e përfshira në aktet bazë.
4. Në zbatim të çdo dispozite të qartë ku parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, referencat ndaj kësaj Marrëveshjeje janë referenca për këtë Marrëveshje të ndryshuar, të plotësuar ose të zëvendësuar herë pas here.

5. Çdo referencë e bërë në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj për aktet bazë, është referencë ndaj këtyre instrumenteve të ndryshuara, të plotësuara ose të zëvendësuara herë pas here.

6. Titujt në këtë Marrëveshje dhe në shtojcat e saj nuk kanë rëndësi ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

7. Palët konsultohen me njëra-tjetrën për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 48

Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimshme

1. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose nëse Marrëveshja përmban mangësi të paqëllimshme, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj.

2. Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të plotësojnë çdo dispozitë të pavlefshme apo mangësi të paqëllimshme me një dispozitë që i përshtatet më së miri qëllimit dhe synimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me aktet bazë dhe me nenin 52.

Neni 49

Konsultimet ndërmjet Palëve

1. Pa cenuar nenin 41, çdo paqartësi lidhur me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të jetë objekt konsultimi ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje, duke rezultuar, sipas rastit, në një ndryshim të kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët konsultohen edhe me njëra-tjetrën në rast se Komiteti i Monitorimit nuk është në gjendje të marrë një vendim në përputhje me nenin 11.

3. Çdo Palë informon Palët e tjera në rast se ka korrigjime, ndryshime, plotësime ose zëvendësime të legjislacionit të zbatueshëm, që mund të cenojë zbatimin e programit ose të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rast se njëra nga Palët merr dijeni për problemet në lidhje me zbatimin e programit ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, ajo vendos të gjitha kontaktet e nevojshme me Palët e tjera dhe Autoritetin Menaxhues për korrigjimin e situatës dhe ndërmarrjen e hapave të nevojshëm.

5. Konsultimet mund të rezultojnë në ndryshime (neni 52), pezullime (neni 53) ose zgjidhje (neni 54) të kësaj Marrëveshjeje ose në një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (neni 50).

6. Paragrafi 1 nuk zbatohet në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo çështjeve të tjera ndërmjet rajonit francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur” dhe Komisionit.

Neni 50

Masat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje për Marrëveshjen e Financimit, që përfshin Shqipërinë dhe rajonin francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur” [ose] Komisionin [ose të dyja], e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe 6-mujore përmes konsultimeve ndërmjet Palëve, siç parashikohet në nenin 49, ajo mund të zgjidhet me anë të arbitrazhit, me kërkesë të njëres prej palëve.

Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë ka kompetencën ekskluzive lidhur me interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së.

2. Secila Palë cakton një arbitër brenda 30 ditëve nga kërkesa për arbitrazh. Në pamundësi të kësaj gjëje, secila Palë mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) që të caktojë një arbitër të dytë. Dy arbitrat, nga ana e tyre, caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Në pamundësi të kësaj gjëje, secila Palë mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit që të caktojë një arbitër të tretë.

Kur mosmarrëveshja përfshin Komisionin dhe rajonin francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur”, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër, dhe kur Komisioni dhe rajoni francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur” veprojnë bashkërisht, këta të fundit caktojnë një arbitër të përbashkët.

3. Me përjashtim të rasteve kur arbitrat vendosin ndryshe, zbatohet procedura e përcaktuar në Rregullat e Arbitrazhit, të vitit 1996, të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për Organizatat Ndërkombëtare dhe Shtetet.

Vendimi i arbitrave merret me shumicë të anëtarëve brenda një periudhe 3-mujore.

Kur gjatë procedurave të arbitrazhit ngrihet një çështje lidhur me interpretimin e legjislacionit të BE-së, arbitrat do të pezullojnë procedurat dhe do t'i kërkojnë një gjykatë në Francë që të paraqesë një ose disa çështje pranë Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, me qëllim marrjen e një vendimi paraprak, në përputhje me nenin 267 të TFBE-së.

4. Secila palë është e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të arbitrave.

5. Kërkesa për ndjekjen e procedurave të arbitrazhit sipas paragrafit 1 nuk përbën dhe nuk interpretohet si heqje dorë nga privilegjet ose imunitetet që iu takojnë Palëve.

6. Paragrafët 1 deri në 4 nuk zbatohen për marrëdhëniet ndërmjet Komisionit dhe rajonit francez “Provence-Alpes-Côte d’Azur”.

Neni 51

Mosmarrëveshjet me palët e treta

1. Pa cenuar juridiksionin e asnjë gjykate të caktuar në një Marrëveshje për Grante, të parashikuar në nenin 22, paragrafi 6 i rregullores (BE) 2021/1059, si gjykata kompetente për mosmarrëveshjet që lindin në sajë të një kontrate ndërmjet Autoritetit Menaxhues dhe përfituesve në Shqipëri, BE-ja gëzon imunitet nga paditjet në territorin e Shqipërisë, duke përfshirë edhe arbitrazhin, siç parashikohet në nenin 50 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe imunitet nga ndjekja penale sa u takon mosmarrëveshjeve ndërmjet Komisionit dhe/ose Shqipërisë dhe një pale të tretë, ose ndërmjet palëve të treta, e cila lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me ofrimin e mbështetjes financiare për Shqipërinë në kuadër të programit dhe sipas kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur BE-ja ka hequr dorë shprehimisht nga imuniteti përkatës.

2. Shqipëria, në çdo procedurë ligjore ose administrative përpara një gjykate, tribunali ose instance administrative në Shqipëri, duhet ta ruajë këtë imunitet dhe të mbajë një qëndrim që merr plotësisht në konsideratë interesat e BE-së. Kur është e nevojshme, Shqipëria dhe Komisioni vijnë me konsulta më të gjera sipas nenit 49, lidhur me qëndrimin që duhet të mbajnë.

Neni 52

Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje

1. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë zëvendësimin e një dispozite të saj, e cila është e pavlefshme ose është shpallur e pavlefshme, si dhe plotësimin e çdo mangësie të paqëllimshme, bëhet me shkrim dhe çdo ndryshim i Marrëveshjes duhet të dakordësohet nga të gjitha Palët.

2. Ndryshimet e paraqitura me shkrim do të marrin formën e një letërkëmbimi, pas dakordësisë së të gjitha Palëve.

3. Pala që kërkon ndryshimin, e dorëzon kërkesën pranë Palëve të tjera, minimumi tre muaj përpara se ndryshimi të parashikohet të hyjë në fuqi, me përjashtim të rasteve që janë të justifikuara siç duhet nga Pala kërkuuese dhe që pranohen nga Palët e tjera.

Neni 53

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje

1. Kjo Marrëveshje mund të pezullohet nga secila Palë:

a) nëse një nga Palët shkel një detyrim në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.

b) në rastin e shkeljes së një detyrimi ligjor ndërkombëtar nga njëra prej Palëve, veçanërisht të atyre që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut, parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit;

c) në rastet e rënda të korrupsionit me kusht që ato të kenë një ndikim sistematik në zbatimin e programit apo të projekteve individuale;

d) në rast se BE-ja miraton masa kufizuese kundrejt Shqipërisë;

e) kur Komiteti i Monitorimit nuk ka qenë në gjendje të marrë një vendim në përputhje me nenin 11 ose

f) kur Komiteti i Monitorimit ka rënë dakord për ndërprerjen e programit në përputhje me nenin 12 të rregullores (BE) 2021/1059.

g) në rastin e një force madhore që ndikon në zbatimin e programit.

“Forcë madhore” është çdo situatë ose ngjarje e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme përtej kontrollit të Palëve që i pengon ato në përmbushjen e detyrimeve të tyre, që nuk i atribuohet një gabimi apo neglizhence nga ana e tyre (ose nga ana e kontraktorëve, agjentëve apo punonjësve të tyre) dhe që rezulton e pakapërcyeshme pavarësisht gjithë kujdesit të duhur të ushtruar.

Defektet në pajisje ose materiale apo vonesat në vënien e tyre në dispozicion, mosmarrëveshjet në punë, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore.

Një Palë që ngre pretendimin për forcë madhore duhet të informojë Palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, si dhe të marrë çdo masë për minimizimin e dëmit të mundshëm.

Asnjëra nga palët nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje nëse pengohet në përmbushjen e tyre për shkak të një force madhore, me kusht që të marrë masat për të minimizuar çdo dëm të mundshëm dhe që Palët e tjera të informohen siç duhet.

Palët e tjera bien dakord se ekziston një situatë e forcës madhore ose nisin konsultimet sipas nenit 51, ose bëjnë një njoftim sipas paragrafit 2.

2. Çdo Palë njofton Palët e tjera rreth qëllimit të saj për të pezulluar Marrëveshjen, duke paraqitur justifikimin e duhur. Pezullimi hyn në fuqi 45 ditë pas datës ose njoftimit ose menjëherë pas njoftimit në rastin e aplikimit të masave kufizuese të BE-së. Data e hyrjes në fuqi të pezullimit shërben si datë referencë për qëllimet e këtij neni.

3. Çdo Palë mund të marrë çdo masë të nevojshme paraprake para hyrjes në fuqi të pezullimit.

Përpara njoftimit dhe hyrjes në fuqi të pezullimit, si dhe gjatë periudhës së pezullimit, Palët mund të diskutojnë masat e përshtatshme për të shmangur ose hequr pezullimin.

4. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të pezullimit, alokimet financiare të BE-së dhe kontributi i vendit të tretë (kontributi kombëtar), të përmendura në nenin 4, nuk do të jenë më të detyrueshme.

5. Pezullimi mund të hiqet në rastet kur Palët konstatojnë se është rivendosur përputhshmëria me Marrëveshjen.

6. Kur Palët konstatojnë se nuk është rivendosur përputhshmëria me Marrëveshjen, atëherë pezullimi mbetet në fuqi ose marrëveshja mund të zgjidhet në përputhje me nenin 54.

Neni 54

Zgjidhja e kësaj Marrëveshjeje

1. Kur pezullimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është hequr brenda një periudhe maksimale prej 180 ditësh, çdo Palë mund të paraqesë qëllimin e saj për zgjidhjen e Marrëveshjes. Zgjidhja e Marrëveshjes hyn në fuqi 45 ditë pas datës së njoftimit, përveçse kur bihet dakord ndryshe.

2. Në rastin e ndërprerjes së programit në përputhje me nenin 11, çdo Palë mund të paraqesë kërkesën e saj për zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje përpara se të përfundojë periudha e ekzekutimit.

3. BE-ja ka të drejtën ta zgjidhë këtë Marrëveshje nëse Shqipëria nuk jep kontributin e saj në përputhje me nenin 4, paragrafi 5 dhe paraqet qëllimin e tij për zgjidhjen e Marrëveshjes. Zgjidhja e Marrëveshjes hyn në fuqi 45 ditë pas datës së njoftimit, përveçse kur bihet dakord ndryshe.

Shqipëria ka të drejtën ta zgjidhë këtë Marrëveshje nëse BE-ja nuk përmbush detyrimet e saj të parashikuara në nenin 4, paragrafi 3 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në rastet e përmendura në paragrafët 2 dhe 3, kjo Marrëveshje zgjidhet në datën e rënë dakord nga të tria Palët.

5. Data e zgjidhjes së Marrëveshjes shërben si datë referencë për qëllimet e këtij neni.

6. Pas zgjidhjes së kësaj Marrëveshjeje, alokimi financiar i përmendur në nenin 4 nuk është më i detyrueshëm, përveçse kur pezullimi ka ndodhur përpara zgjidhjes. Në këtë rast, data referencë do të jetë data e dhënë në nenin 53, paragrafi 2.

7. Në rast se Palët nuk bien dakord mbi datën e përfundimit të periudhës së ekzekutimit përpara përfundimit të periudhës së parashikuar në nenin 6, atëherë kjo Marrëveshje do të zgjidhet pesë vite pas datës së një njoftimi të bërë në përputhje me paragrafët 1, 2 dhe 3.

Neni 55

Depozitari

Komisioni është depozitari i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 56

Komponentët e kësaj Marrëveshjeje

Shtojcat në vijim janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje:

Nënshkruar për dhe në emër të Komisionit,

Normunds Popens

Drejtor i përgjithshëm i komanduar

Drejtoria e Përgjithshme për Politikat Rajonale dhe Urbane

(nënshkrimi)

Bruksel, data

Nënshkruar për dhe në emër të rajonit “Provence-Alpes-Côte d’Azur”

(nënshkrimi)

Marsejë, data

Nënshkruar për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë,

Ilir Beqaj

Drejtor i Përgjithshëm/KKIPA

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës

(nënshkrimi)

Tiranë, më 10.10.2023

- Plani i financimit (shtojca I);

- Rregullat e prokurimit publik (shtojca II).

Neni 57

Lidhja, hyrja në fuqi dhe zbatimi i përkohshëm i kësaj Marrëveshjeje

1. Kjo Marrëveshje konsiderohet e lidhur në datën e nënshkrimit të saj nga të gjitha palët.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim përmes të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën, në kanale diplomatike, mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

3. Palët bien dakord që të zbatojnë përkohësisht dispozitat në vijim duke filluar nga data e lidhjes së Marrëveshjes:

- nenet 7 deri në 9;

- neni 12, paragrafët 1 deri në 4;

- nenet 13 deri në 15;
- neni 26 paragrafi 2;
- nenet 35 deri në 41;
- nenet 46 dhe 49;
- nenet 56 dhe 57.

Nënshkruar në tri kopje origjinale, nga një për secilën Palë, në gjuhën angleze dhe në gjuhën franceze

SHTOJCAT:
Shtojca I

Tabela 1: Fondet e miratuara financiare, sipas vitit

Fondi	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	Totali
Fondet Interreg	0	40 072 427	40 750 001	41 398 256	42 080 608	34 949 420	35 648 514	234 899 226

Tabela 2: Totali i fondeve të miratuara financiare të ndara sipas fondit dhe bashkëfinancimit kombëtar

Objektivi politikës	Prioriteti	Fondi	Baza për llogaritjen e mbështetjes së BE-së (kosto totale legjitime ose kontributi publik)	Kontributi i BE-së (a)=(a1)+(a2)	Ndarja treguese e kontributit të BE-së		Kontributi kombëtar (b)=(c)+(d)	Ndarja treguese e kontributit kombëtar		Totali (e)=(a)+(b)	Norma bashkëfinancimit (f)=(a)/(e)	Kontributet nga vendet e treta (për: informacion)
					Pa asistencë teknike (AT), në përputhje me nenin 27, paragrafi 1 (a1)	Për AT, në përputhje me nenin 27, paragrafi 1 (a2)		Kontributi kombëtar publik (c)	Kontributi kombëtar privat (d)			
1	1	Fondet Interreg	Kosto totale legjitime	48 789 198	45 175 184	3 614 014	12 197 300	10 245 732	1 951 568	60 986 498	80%	0
2	2	Fondet Interreg	Kosto totale legjitime	155 006 028	143 524 100	11 481 928	38 751 507	35 230 595	3 520 912	193 757 535	80%	0
3	3	Fondet Interreg	Kosto totale legjitime	31 104 000	28 800 000	2 304 000	7 776 000	7 376 000	400 000	38 880 000	80%	0
	Totali	Fondet Interreg	Kosto totale legjitime	234 899 226	217 499 284	17 399 942	58 724 807	52 852 327	5 872 480	293 624 033	80%	0

C | Ref. Ares (2022)1282540-21/02/2022

Shtojca II

Prokurimi publik

A. Dispozita të përgjithshme

1. Parimet e zbatueshme për kontratat dhe objekti (pasqyron nenin 160 të rregullores financiare⁷)

1. Të gjitha kontratat e financuara nga një kontratë granti respektojnë parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

2. Të gjitha kontratat duhet të jenë pjesë e një procedure konkurruese sa më të gjerë që të jetë e mundur, përveçse kur përdoret procedura me negociim. Vlera e përlogaritur e një kontrate nuk duhet të përcaktohet duke pasur si qëllim anashkalimin e rregullave të zbatueshme dhe nuk duhet të ndahet për të anashkaluar rregullat e zbatueshme. Përfituesi i grantit, duke vepruar si autoriteti kontraktor, e ndan një kontratë në lote, kur është e përshtatshme, duke marrë në konsideratë konkurrencën e gjerë.

3. Përfituesit e grantit nuk duhet t'i përdorin kontratat kuadër në mënyrë të gabuar ose në një mënyrë të tillë që qëllimi apo efekti i tyre të jetë, të pengojnë, kufizojnë ose shtrembërojnë konkurrencën.

2. Kontratat e përziera dhe fjalori i përbashkët i prokurimit (pasqyron nenin 162 të rregullores financiare)

⁷ Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 18 korrik 2018, "Për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian".

1. Një kontratë e përzier që mbulon dy ose më shumë lloje prokurimi (punët, furnizimet ose shërbimet) jepet në përputhje me dispozitat e zbatueshme sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.

2. Në rastin e kontratave të përziera për furnizimet dhe shërbimet, objekti kryesor përcaktohet duke krahasuar vlerat e furnizimeve ose shërbimeve përkatëse.

3. Çdo referencë për nomenklaturat në kontekstin e prokurimit bëhet duke përdorur Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (FPP).

3. Masat e publikimit (pasqyron nenin 163 të rregullores financiare, si dhe pragjet e nenit 178.1 dhe pikës 5 të shtojcës I të kësaj rregulloreje)

1. Për procedurat me vlerë të barabartë ose më të madhe se 300 000 euro në rastin e kontratave të shërbimit dhe furnizimit, apo me vlerë të barabartë ose më të madhe se 5 000 000 euro në rastin e kontratave të punëve, përfituesi i grantit publikon në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian:

a) një njoftim të kontratës me qëllim nisjen e një procedure, përveçse në rastin e procedurës me negociim;

b) një njoftim për dhënien e kontratës ku paraqiten rezultatet e procedurës.

2. Sipas rastit, njoftimi paraprak informues për thirrjet për oferta pas procedurës së hapur ose procedurës së kufizuar, siç përmendet përkatësisht në germet “a” dhe “b” të pikës 4.1, i dërgohet Zyres së Publikimeve në mënyrë elektronike, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Njoftimi për dhënien e kontratës dërgohet kur kontrata është nënshkruar, me përjashtim të rasteve kur, nëse është ende e nevojshme, kontrata është deklaruar si sekrete ose kur zbatimimi i kontratës duhet të shoqërohet nga masa të veçanta sigurie, ose kur diçka e tillë është e nevojshme për të mbrojtur interesat thelbësore të Bashkimit Evropian apo të vendit përfitues, si dhe në rastet kur publikimi i njoftimit për dhënien e kontratës nuk konsiderohet i përshtatshëm.

3. Procedurat që kanë një vlerë më të ulët se pragjet e përmendura më sipër komunikohen përmes mjeteve të përshtatshme.

4. Krahas komunikimit të parashikuar në paragrafin 1 dhe në pikën 30.2, procedurat e prokurimit mund të komunikohen edhe në një mënyrë tjetër, në veçanti në formë elektronike. Këto komunikime duhet t'i referohen njoftimit të publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, nëse njoftimi është publikuar, dhe nuk duhet t'i paraprijnë publikimit të këtij njoftimi, i cili në vetvete është autentik.

Ky komunikim nuk paraqet asnjë diskriminim ndërmjet kandidatëve apo ofertuesve dhe as nuk përmban detaje të tjera përveç atyre në njoftimin e kontratës, nëse ky njoftim është publikuar.

5. Informacione të caktuara për dhënien e kontratës mund të mos publikohen në rast se publikimi i tyre do të pengonte zbatimin e ligjit ose do të ishte në kundërshtim me interesin publik, do të dëmtonte interesat tregtare legjitime të operatorëve ekonomikë ose mund të cenonte konkurrencën e drejtë midis tyre.

B. Llojet e procedurave

4. Procedurat e prokurimit (pasqyron nenin 164 të rregullores financiare)

1. Procedurat e prokurimit për dhënien e kontratave të koncesionit ose kontratave publike, duke përfshirë kontratat kuadër, marrin një nga format në vijim:

a) procedurë e hapur;

b) procedurë e kufizuar;

c) procedurë me negociim, duke përfshirë pa publikim paraprak;

d) procedurë konkurruese me negociim;

e) procedura që përfshijnë një thirrje për shprehje të interesit.

2. Në procedurat e hapura, çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë.

3. Në procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negociim, çdo operator ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje duke dhënë informacionin e kërkuar nga përfituesi i grantit. Përfituesi i grantit fton të gjithë kandidatët, të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes dhe nuk janë në asnjë prej situatave të përjashtimit ose refuzimit të përmendura në nenin 136, paragrafi 1 dhe nenin 141, paragrafi 1 të rregullores financiare⁸, që të paraqesin një ofertë.

⁸ Dispozitat e tjera për situatat e përjashtimit dhe refuzimit në këtë dokument duhet të kuptohen duke iu referuar nenit

Pavarësisht paragrafit të parë, përfituesi i grantit mund të kufizojë numrin e kandidatëve që do të ftohen për të marrë pjesë në procedurë, bazuar në kriteret e përzgjedhjes objektive dhe jodiskriminuese, të cilat bëhen të ditura në njoftimin e kontratës ose në thirrjen për shprehjen e interesit. Numri i kandidatëve të ftuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të garantuar një konkurrencë reale.

4. Në të gjitha procedurat që përfshijnë negociim, përfituesi i grantit negocion ofertën fillestare, si dhe çdo ofertë pasuese ose pjesë të tyre me ofertuesit, me përjashtim të ofertës përfundimtare, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tyre. Kërkesat minimale dhe kriteret e specifikuar në dokumentet e prokurimit nuk janë objekt negociimi. Një përfitues granti mund të japë një kontratë në bazë të ofertës fillestare pa negociim në rast se ka specifikuar në dokumentet e prokurimit se rezervon mundësinë për ta bërë diçka të tillë.

5. Përfituesi i grantit mund të përdorë:

a) procedurën e hapur ose të kufizuar për çdo blerje;

b) procedurat që përfshijnë një thirrje për shprehje të interesit për kontratat me vlerë më të ulët se pragjet e përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce, për të parazgjedhur kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar oferta në përgjigje të ftesave të ardhshme të kufizuara për oferta, ose për të përgatitur një listë me operatorët ekonomikë që do të ftohen për të paraqitur kërkesa për pjesëmarrje ose për dorëzimin e ofertave;

c) procedurën konkurruese me negociim, në rastin e kontratave të shërbimit për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike⁹, si dhe në rastet kur kjo justifikohet nga rrethana specifike që janë të lidhura, ndër të tjera, me natyrën ose kompleksitetin e objektit të kontratës apo me llojin specifik të kontratës, siç detajohet më tej në pikën 7.2;

d) procedurën me negociim pa publikim paraprak për lloje të caktuara blerjesh që nuk bëjnë pjesë në objektin e direktivës 2014/24/BE ose në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara qartë dhe të parashikuara në këtë shtojcë.

5. Pragjet dhe procedurat (pasqyron pikën 38 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Procedurat e prokurimit në fushën e veprimeve të jashtme janë si në vijim:

a) procedura e kufizuar, siç parashikohet në pikën 4.1.b të kësaj shtojce;

b) procedura e hapur, siç parashikohet në pikën 4.1.a të kësaj shtojce;

c) procedura e hapur lokale;

d) procedura e thjeshtuar.

2. Bazuar në pragjet përkatëse, procedurat e prokurimit përdoren si në vijim:

a) procedura e hapur ose e kufizuar mund të përdoret, për:

i. kontratat e shërbimit dhe të furnizimit dhe kontratat e koncesionit të shërbimeve, me vlerë prej të paktën 300 000 eurosh;

ii. kontratat e punëve dhe kontratat e koncesionit të punëve, me vlerë prej të paktën 5 000 000 euro;

b) procedura e hapur lokale mund të përdoret, për:

i. kontratat e furnizimit me vlerë nga 100 000 euro deri në 300 000 euro;

ii. kontratat e punëve dhe kontratat e koncesionit të punëve, me vlerë nga 300 000 euro deri në 5 000 000 euro;

c) procedura e thjeshtuar mund të përdoret për:

i. kontratat e shërbimit, kontratat e koncesionit të shërbimeve, kontratat e punëve dhe kontratat e koncesionit të punëve, me vlerë nën 300 000 euro;

ii. kontratat e furnizimit, me vlerë nën 100 000 euro;

d) kontratat me vlerë më të ulët ose të barabartë me 20 000 euro mund të jepen mbi bazën e një oferte të vetme;

e) pagesat me vlerë më të ulët ose të barabartë me 2500 euro për zërat e shpenzimeve mund të realizohen thjesht si pagesa faturash, pa qenë e nevojshme të merret një ofertë paraprake.

136, paragrafi 1 dhe nenit 141, paragrafi 1 të rregullores financiare.

⁹ Siç përmendet në shtojcën XIV të direktivës 2014/24/BE.

3. Në procedurën e kufizuar të përmendur në germën “a” të paragrafit 1, njoftimi i kontratës specifikon numrin e kandidatëve që do të ftohen për të paraqitur oferta. Në rastin e kontratave të shërbimeve ftohen të paktën katër kandidatë. Numri i kandidatëve që lejohet të paraqesin oferta duhet të jetë i mjaftueshëm për të garantuar një konkurrencë reale. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen e internetit të përfituesit të grantit.

Nëse numri i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes ose nivelet minimale të kapacitetit është më i ulët se numri minimal, përfituesi i grantit mund të ftojë për të paraqitur oferta vetëm ata kandidatë që përmbushin kriteret për dorëzimin e një oferte.

4. Në kuadër të procedurës së hapur lokale të përmendur në germën “c” të paragrafit 1, njoftimi i kontratës publikohet minimalisht në gazetën zyrtare të shtetit marrës ose në format të barasvlershëm për ftesat lokale për oferta.

5. Në kuadër të procedurës së thjeshtuar të përmendur në germën “d” të paragrafit 1, autoriteti kontraktor harton një listë me të paktën tre ofertues të përzgjedhur prej tij, pa publikuar një njoftim. Ofertuesit për procedurën e thjeshtuar mund të përzgjidhen nga lista e operatorëve ekonomikë të përmendur në germën “b” të pikës 9. 1, e cila bëhet e ditur përmes një thirrjeje për shprehje të interesit.

Nëse, pas konsultimit të ofertuesve, autoriteti kontraktor merr vetëm një ofertë të vlefshme nga aspekti administrativ dhe teknik, atëherë kontrata mund të jepet me kusht që të përmbushen kriteret për dhënien e saj.

6. Për sa u përket shërbimeve ligjore që nuk mbulohen në germën “g” të pikës 6.1, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e thjeshtuar, pavarësisht vlerës së përlogaritur të kontratës.

6. Përdorimi i procedurës me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës (pasqyron pikën 11 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Kur përfituesi i grantit përdor procedurën me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, ai respekton masat e negociimit të përcaktuara në pikën 7.1. Përfituesi i grantit mund të përdorë procedurën me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, pavarësisht vlerës së përlogaritur të kontratës, në rastet në vijim:

a) kur nuk janë dorëzuar oferta apo oferta të përshtatshme, ose kur nuk janë dorëzuar kërkesa për pjesëmarrje apo kërkesa të përshtatshme për pjesëmarrje, siç parashikohet në paragrafin 2, në përgjigje të një procedure të hapur ose procedure të kufizuar pas përfundimit të kësaj procedure, me kusht që dokumentet origjinale të prokurimit të mos jenë ndryshuar në mënyrë thelbësore;

b) kur punët, furnizimet ose shërbimet mund të ofrohen nga vetëm një operator ekonomik, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 3, si dhe për një nga arsyet në vijim:

i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose një performance artistike unike;

ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;

iii. duhet të garantohet mbrojtja e të drejtave ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale;

c) nëse është jashtëzakonisht e nevojshme në rastet kur, për arsye të urgjencës ekstreme të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme, është e pamundur të respektohen afatet kohore të përcaktuara në pikën 22 të kësaj shtojce dhe kur argumentimi i kësaj urgjence ekstreme nuk mund t'i atribuohet autoritetit kontraktor;

d) për punët ose shërbimet e reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit i është dhënë një kontratë fillestare nga i njëjti përfitues i grantit, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë për të cilin është dhënë kontrata fillestare pas publikimit të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 4;

e) për kontratat e furnizimit:

i. për furnizime shtesë, të cilat kanë si qëllim zëvendësimin e pjesshëm të furnizimeve ose instalimeve, apo shtimin e furnizimeve ose instalimeve ekzistuese, në rastet kur një ndryshim i furnizuesit do të detyronte autoritetin kontraktor që të merrte furnizime me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike

joproporcionale në procedurat e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes; në rastet kur institucionet e Bashkimit Evropian japin kontrata për llogari të tyre, kohëzgjatja e këtyre kontratave nuk i tejkalon tre vjet;

ii. kur produktet janë prodhuar vetëm për qëllime kërkimore, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi; megjithatë, këto kontrata nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur sukses tregtar ose për të rikuperuar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit;

iii. për furnizimet e kuotuarra dhe të blera në tregun e lëndëve të para dhe produkteve primare;

iv. për blerjet e furnizimeve me kushte veçanërisht të favorshme nga një operator ekonomik që po likuidon përfundimisht veprimtaritë e tij tregtare, ose nga likuiduesit në një procedurë falimentimi, një marrëveshje me kreditorët ose një procedurë e ngjashme sipas legjislacionit të brendshëm;

f) për kontratat e ndërtimit, pas studimit të tregut lokal;

g) për kontratat për një nga rastet e mëposhtme:

i. përfaqësimin ligjor nga një avokat në procedurat e arbitrazhit ose pajtimit ose procedurat gjyqësore;

ii. konsulencën ligjore që jepet në përgatitjen e procedurave të përmendura në pikën i. ose kur ka një tregues të qartë dhe probabilitet të lartë që çështja me të cilën lidhet konsulenca të bëhet subjekt i këtyre procedurave, me kusht që konsulenca të jepet nga një avokat;

iii. shërbimet e arbitrazhit dhe pajtimit;

iv. shërbimet e certifikimit dhe autentifikimit të dokumenteve, të cilat duhet të ofrohen nga noterët.

2. Një ofertë konsiderohet e papërshtatshme kur ajo nuk lidhet me objektin e kontratës ndërsa kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet e papërshtatshme kur operatori ekonomik është në një situatë përjashtuese ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes.

3. Përjashtimet e përcaktuara në germën “b”, pikat “ii” dhe “iii” të paragrafit 1 zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i një ngushtimi artificial të parametrave gjatë përcaktimit të prokurimit.

4. Në rastet e përmendura në germën “d” të paragrafit 1, projekti bazë duhet të tregojë nivelin e punëve ose shërbimeve të mundshme të reja dhe kushtet sipas të cilave do të jepen. Sapo projekti bazë të shpallet pjesë e prokurimit duhet të njoftohet përdorimi i mundshëm i procedurës me negociim dhe kosto e përgjithshme e përlllogaritur e punëve ose shërbimeve vijuese duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të pragjeve të përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce.

7. Përdorimi i procedurës konkurruese me negociim (pasqyron pikën 12.1, germa “b” të shtojcës I dhe nenin 164.4 të rregullores financiare)

1. Kur përfituesi i grantit përdor procedurën konkurruese me negociim, ai duhet të marrë në konsideratë masat e negociimit në vijim:

a) përfituesi i grantit negocion ofertën fillestare, si dhe çdo ofertë pasuese ose pjesë të tyre me ofertuesit, me përjashtim të ofertës përfundimtare, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tyre. Kërkesat minimale dhe kriteret e specifikuar në dokumentet e prokurimit nuk janë objekt negociimi;

b) një përfitues granti mund të japë një kontratë në bazë të ofertës fillestare pa negociim në rast se ka specifikuar në dokumentet e prokurimit se rezervon mundësinë për ta bërë diçka të tillë.

2. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë procedurë, pavarësisht vlerës së përlllogaritur të kontratës, në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet që përmbushin një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

a) kur nevojat e autoritetit kontraktor nuk mund të përmbushen pa përshtatur një zgjidhje të gatshme;

b) punët, furnizimet ose shërbimet përfshijnë projektimin ose zgjidhjet novatore;

c) kontrata nuk mund të jepet pa negociim paraparak për shkak të rrethanave specifike që lidhen me natyrën, kompleksitetin ose përbërjen juridike dhe financiare të kontratës ose për shkak të rreziqeve të lidhura me objektin e kontratës;

d) specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me përpikëri të mjaftueshme nga autoriteti kontraktor duke iu referuar një standardi.

8. Përdorimi i procedurës me negociim për kontratat e shërbimit, furnizimit dhe punëve (pasqyron pikën 39 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Përfituesit e grantit mund të përdorin procedurën me negociim me një ofertë të vetme në rastet në vijim:

a) kur shërbimet u janë besuar organeve të sektorit publik ose shoqatave apo institucioneve jofitimprurëse dhe kanë lidhje me aktivitete të natyrës institucionale ose janë të projektuara për të ofruar asistencë për personat në fushën sociale;

b) kur procedura e dorëzimit të ofertave ka rezultuar e pasuksesshme, pra kur nuk janë marrë oferta cilësore dhe/ose të përshtatshme nga pikëpamja financiare. Në këtë rast, pas anulimit të procedurës së dorëzimit të ofertave, përfituesi i grantit mund të negociojë me një ose disa ofertues të përzgjedhur prej tij nga grupi i ofertuesve që morën pjesë në ftesën për dorëzimin e ofertave, me kusht që dokumentet e prokurimit të mos jenë ndryshuar në mënyrë thelbësore;

c) kur duhet lidhur një kontratë e re pas zgjidhjes së parakohshme të një kontrate ekzistuese.

2. Për qëllime të pikës 6.1, germa “c”, operacionet e kryera gjatë një krize konsiderohen se përmbushin kushtin e urgjencës ekstreme. Përfituesi i grantit përcakton ekzistencën e një situatë të urgjencës ekstreme dhe shqyrton rregullisht vendimin e tij/saj duke marrë në konsideratë parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar.

3. Aktivitetet e natyrës institucionale të përmendura në germën “a” të pikës 8.1 përfshijnë shërbimet e lidhura drejtpërdrejt me misionin statutor të organeve të sektorit publik.

9. Procedura që përfshin një thirrje për shprehje të interesit (pasqyron pikat 13.1 dhe 13.2 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Për kontratat me vlerë me të ulët se pragjet e përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce, si dhe pa cenuar pikat 6 dhe 7 të kësaj shtojce, përfituesi i grantit mund të përdorë një thirrje për shprehje të interesit për të kryer një nga procedurat e mëposhtme:

a) për të parazgjedhur kandidatët që do të ftohen për të dorëzuar oferta në përgjigje të ftesave të ardhshme të kufizuara për oferta;

b) për të përgatitur një listë me operatorët ekonomikë që do të ftohen për të dorëzuar kërkesa për pjesëmarrje ose oferta.

2. Lista e hartuar në vijim të një thirrjeje për shprehje interesi është e vlefshme për maksimumi katër vite nga data e publikimit të njoftimit. Lista e përmendur në paragrafin e parë mund të përfshijë nënlistë. Çdo operator ekonomik mund të shprehë interes në çdo kohë gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës, me përjashtim të tre muajve të fundit të kësaj periudhe.

10. Përdorimi i ankandeve elektronike (pasqyron pikën 22 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Përfituesi i grantit mund të përdorë ankandet elektronike ku paraqiten çmime të reja, çmime të ndryshuara me ulje dhe/ose vlera të reja në lidhje me elemente të caktuara të ofertave.

Përfituesi i grantit e strukturon ankandin elektronik si një proces elektronik përsëritës, që ndodh pas një vlerësimi të plotë fillestar të ofertave, duke mundësuar renditjen e tyre nëpërmjet metodave automatike të vlerësimit.

2. Në procedurat e hapura ose të kufizuara ose në procedurat konkurruese me negociim, përfituesi i grantit mund të vendosë që dhënia e një kontrate publike të paraprihet nga një ankand elektronik kur dokumentet e prokurimit mund të përcaktohen me saktësi.

Një ankand elektronik mund të organizohet për të rihapur konkurrimin ndërmjet palëve në një kontratë kuadër, siç përmendet në pikën 1 të shtojcës I të rregullores financiare.

Ankandi elektronik bazohet në një nga metodat e dhënies së kontratës të përcaktuara në pikën 17.4 të kësaj shtojce.

3. Autoriteti kontraktor që vendos të zhvillojë një ankand elektronik e deklaron këtë fakt në njoftimin e kontratës. Dokumentet e prokurimit përfshijnë të dhënat mëposhtme:

a) vlerat e zërave që do të jenë subjekt i një ankandi elektronik, me kusht që këto zëra të jenë të matshëm dhe të mund të shprehen në shifra ose përqindje;

b) çdo kufi për vlerat që mund të paraqiten, sipas specifikimeve në lidhje me objektin e kontratës;

c) informacionin që u vihet në dispozicion ofertuesve gjatë ankandit elektronik dhe, sipas rastit, kohën se kur do t'u vihet në dispozicion;

d) informacionin përkatës në lidhje me procesin e ankandit elektronik, duke përfshirë faktin nëse është i ndarë në faza dhe mënyrën e mbylljes së procesit, siç përcaktohet në pikën 10.7;

e) kushtet sipas të cilave ofertuesit do të jenë në gjendje të paraqesin një ofertë dhe në veçanti, diferencat minimale që do të nevojiten kur të dorëzohet oferta, sipas rastit;

f) informacionin përkatës në lidhje me pajisjet elektronike të përdorura, si dhe masat dhe specifikimet teknike për lidhjen.

4. Të gjithë ofertuesit që kanë dorëzuar oferta të pranueshme ftohen në të njëjtën kohë, në mënyrë elektronike, që të marrin pjesë në ankandin elektronik duke përdorur lidhjet në përputhje me udhëzimet. Ftesa specifikon datën dhe orën e fillimit të ankandit elektronik.

Ankandi elektronik mund të zhvillohet në disa faza të njëpasnjëshme. Ankandi elektronik fillon minimalisht dy ditë-punë pas datës së dërgimit të ftesave.

5. Ftesa shoqërohet me rezultatin e një vlerësimi të plotë të ofertës përkatëse. Ftesa specifikon gjithashtu formulën matematike që do të përdoret në ankandin elektronik për të përcaktuar rirenditjet automatike, në bazë të çmimeve të reja dhe/ose vlerave të reja të paraqitura. Kjo formulë përfshin peshën që u është dhënë të gjitha kriterëve të përzgjedhura për të përcaktuar ofertën më të favorshme nga pikëpamja ekonomike, siç tregohet në dokumentet e prokurimit. Megjithatë, për këtë qëllim, kufijtë reduktohen paraprakisht në një vlerë specifike. Në rastet kur autorizohen variante, për çdo variant parashikohet një formulë e veçantë.

6. Gjatë çdo faze të një ankandi elektronik, autoriteti kontraktor u komunikon menjëherë të gjithë ofertuesve të paktën informacionin e mjaftueshëm me qëllim që të verifikojnë renditjet e tyre përkatëse në çdo moment. Kur kjo është treguar paraprakisht, ai mund të komunikojë informacione të tjera që lidhen me çmime ose vlera të tjera që janë paraqitur, si dhe të bëjë të ditur numrin e ofertuesve në çdo fazë specifike të ankandit. Megjithatë, autoriteti kontraktor nuk zbulon identitetet e ofertuesve gjatë asnjë faze të ankandit elektronik.

7. Përfituesi i grantit e mbyll një ankand elektronik në një ose disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) në datën dhe orën e caktuar më parë;

b) kur nuk merr më çmime të reja ose vlera të reja që plotësojnë kërkesat në lidhje me diferencat minimale, me kusht që të ketë përcaktuar paraprakisht kohën që do të lejojë të kalojë pas marrjes së ofertës së fundit përpara se të mbyllë ankandin elektronik;

c) kur është arritur numri i caktuar paraprakisht i fazave të ankandit.

8. Pas mbylljes së një ankandi elektronik, autoriteti kontraktor shpall kontratën fituese në bazë të rezultateve të ankandit elektronik.

11. Katalogët elektronikë (pasqyron pikën 27 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Kur kërkohet përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që ofertat të paraqiten në formatin e një katalogu elektronik ose të përfshijnë një katalog elektronik.

2. Kur pranohet ose kërkohet paraqitja e ofertave në formën e katalogëve elektronikë, autoriteti kontraktor:

a) e konstaton diçka të tillë në njoftimin e kontratës;

b) specifikon në dokumentet e prokurimit të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me formatin, pajisjet elektronike të përdorura, si dhe masat për lidhjen teknike dhe specifikimet për katalogun.

3. Në rastet kur, pas dorëzimit të ofertave në formën e katalogëve elektronikë, është lidhur një kontratë kuadër e shumëfishtë, atëherë autoriteti kontraktor mund të parashikojë që të bëhet rihapja e konkurrimit për disa kontrata të caktuara, mbi bazën e katalogëve të përditësuar, duke përdorur një nga metodat në vijim:

a) autoriteti kontraktor fton kontraktorët që të ridorëzojnë katalogët e tyre elektronikë, të përshtatur sipas kërkesave të kontratës specifike në fjalë;

b) autoriteti kontraktor njofton kontraktorët se synon të mbledhë nga katalogët elektronikë të dorëzuar, informacionin e nevojshëm për të përgatitur oferta të përshtatura me kërkesat e kontratës

specifike në fjalë, me kusht që përdorimi i kësaj metode të jetë shprehur në dokumentet e prokurimit për kontratën kuadër.

4. Kur përdor metodën e përmendur në germën “b” të pikës 11.3, autoriteti kontraktor njofton kontraktorët rreth datës dhe orës kur synon të mbledhë informacionin e nevojshëm për të përgatitur oferta të përshtatura me kërkesat e kontratës specifike në fjalë dhe u jep kontraktorëve mundësinë për ta refuzuar këtë mbledhje të informacionit.

Autoriteti kontraktor lejon një periudhë të përshtatshme ndërmjet njoftimit dhe mbledhjes së informacionit.

Përpara se të japë një kontratë specifike, autoriteti kontraktor i paraqet kontraktorit të interesuar informacionin e mbledhur, në mënyrë që t'i japë mundësinë të kundërshtojë ose të konfirmojë se oferta e përgatitur nuk përmban asnjë gabim material.

C. Përgatitja

12. Përgatitja e procedurës së prokurimit (pasqyron nenin 166 të rregullores financiare)

1. Përpara nisjes së një procedure prokurimi, përfituesi i grantit mund të realizojë një studim paraprak të tregut, me qëllim që të përgatisë procedurën.

2. Në dokumentet e prokurimit, përfituesi i grantit identifikon objektin e prokurimit duke ofruar një përshkrim të nevojave të tij dhe të karakteristikave të nevojshme të punëve, furnizimeve ose shërbimeve që do të prokurohen, si dhe specifikon kriteret e zbatueshme të përjashtimit, përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës. Përfituesi i grantit specifikon gjithashtu elementet të cilat përcaktojnë kërkesat minimale që duhet të plotësojnë të gjitha ofertat. Kërkesat minimale përfshijnë respektimin e detyrimeve të legjislacionit në fuqi për çështjet mjedisore, sociale dhe të punës, të përcaktuara nga legjislacioni i BE-së, legjislacioni i brendshëm, marrëveshjet kolektive ose nga konventat ndërkombëtare në fuqi për çështjet sociale dhe mjedisore të renditura në shtojcën X të direktivës 2014/24/BE.

13. Prokurimi i përbashkët (përshtatje e thjeshtuar e nenit 165 të rregullores financiare)

1. Kur një kontratë ose një kontratë kuadër është në interes të dy ose më shumë përfituesve të grantit në të njëjtën veprimtari, si dhe kur ekziston mundësia për të arritur përfitime në aspektin e efikasitetit, përfituesit përkatës të grantit mund ta realizojnë procedurën dhe menaxhimin e kontratës apo të kontratës kuadër vijuese në baza ndërinstitucionale, nën udhëheqjen e njërit prej përfituesve të grantit.

Kushtet e kontratës kuadër zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve kontraktore që janë identifikuar për atë qëllim në dokumentet e prokurimit dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë në kontratën kuadër.

2. Kur një kontratë ose kontratë kuadër është e nevojshme për zbatimin e një veprimi të përbashkët ndërmjet një ose disa përfituesve të grantit nga vendet partnere dhe një ose disa përfituesve të grantit nga shtetet anëtare, atëherë procedura e prokurimit mund të realizohet bashkërisht. Dispozitat procedurale që do të zbatohen do të jenë ato të përfituesit të grantit që udhëheq procedurën e prokurimit.

14. Dokumentet e prokurimit (pasqyron pikën 16 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Dokumentet e prokurimit përfshijnë:

- a) sipas rastit, njoftimin e kontratës ose masa të tjera komunikimi, siç parashikohet në pikën 3.4;
- b) ftesën për ofertë;
- c) specifikimet e ofertës, duke përfshirë specifikimet teknike dhe kriteret përkatëse;
- d) draftin e kontratës bazuar në kontratën tip.

Germa “d” e paragrafit të parë nuk zbatohet në rastet kur, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, kontrata tip nuk mund të përdoret.

2. Në ftesën për ofertë:

a) specifikohen rregullat për paraqitjen e ofertave, duke përfshirë në veçanti kushtet që garantojnë konfidencialitetin e tyre deri në momentin e shpalljes, datën dhe orën e afatit përfundimtar të pranimit, si dhe adresën ku duhet të dërgohet apo të dorëzohet ose adresën në internet, në rastin e dorëzimit elektronik;

b) deklarohet se dorëzimi i një oferte nënkupton pranimin e kushteve të përgjithshme të parashikuara në dokumentet e prokurimit dhe se ky dorëzim e bën subjekt të detyrimeve kontraktorin e shpallur fitues, gjatë zbatimit të kontratës;

c) specifikohet periudha e vlefshmërisë së ofertës, e cila nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndryshimi;

d) ndalohet çdo lloj komunikimi ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit gjatë zhvillimit të procedurave, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, kur sipas kushteve të parashikuara në pikën 23 të kësaj shtojce, si dhe kur parashikohet një vizitë në terren, specifikohen kushtet e kësaj vizite;

e) specifikohen dëshmitë që vërtetojnë përmbushjen e afatit kohor për pranimin e ofertave;

f) përcaktohet se dorëzimi i një oferte nënkupton pranimin e marrjes së njoftimit të rezulttit të procedurës përmes mjeteve elektronike.

3. Specifikimet e ofertës përmbajnë:

a) kriteret e përzgjedhjes dhe të përjashtimit;

b) kriteret për dhënien e kontratës dhe ponderimin e tyre relativ, ose kur ponderimi nuk është i mundur për shkaqe objektive, paraqitjen e kriterëve sipas rëndësisë në rend zbritës, që zbatohet edhe për variantet, nëse janë autorizuar në njoftimin e kontratës;

c) specifikimet teknike të përmendura në pikën 16 të kësaj shtojce;

d) kërkesat minimale që duhet të përmbushin variantet, nëse janë të autorizuar;

e) dëshmitë e hyrjes në procedurat e prokurimit;

f) detyrimin për të treguar vendin ku janë të vendosur ofertuesit dhe paraqitjen e dëshmimeve mbështetëse gjerësisht të pranueshme sipas legjislacionit të vendit përkatës;

g) në rastin e katalogëve elektronikë, informacionin për pajisjet elektronike të përdorura, si dhe masat për lidhjen teknike dhe specifikimet e nevojshme.

4. Drafti i kontratës:

a) specifikon dëmet e likuidueshme në rastin e mospërmbushjes së klauzolave të saj;

b) specifikon të dhënat që duhen përfshirë në fatura dhe në dokumentacionin mbështetës përkatës;

c) specifikon gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

d) specifikon se kontraktori respekton detyrimet në fuqi në fushën e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, siç përcaktohet nga legjislacioni i BE-së, legjislacioni i brendshëm, marrëveshjet kolektive ose nga konventat ndërkombëtare në fuqi për çështjet sociale dhe mjedisore të renditura në shtojcën X të direktivës 2014/24/BE;

e) specifikon nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale;

f) deklaron se çmimi i kuotuar në ofertë është fiks dhe i pandryshueshëm, ose parashikon kushtet apo formulat për rishikimin e çmimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Për qëllimet e pikës “P”, nëse kontrata parashikon rishikimin e çmimeve, përfituesi i grantit merr në konsideratë të veçantë:

a) objektin e prokurimit dhe rrethanat ekonomike në të cilat kryhet kjo gjë;

b) llojin e kontratës, detyrat dhe kohëzgjatjen e saj;

c) interesat financiarë të autoritetit kontraktor.

15. Akses i dokumentet e prokurimit dhe afati kohor për dhënien e informacioneve shtesë (pasqyron pikën 25.1 të shtojcës I të rregullores financiare)

Përfituesi i grantit ofron akses të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë përmes mjeteve elektronike në dokumentet e prokurimit, që nga data e publikimit të njoftimit të kontratës ose, në rastin e procedurave pa njoftim kontrate apo në përputhje me pikën 9 të kësaj shtojce, që nga data e dërgimit të ftesës për paraqitjen e ofertave.

Në raste të arsyetuara, përfituesi i grantit mund t'i përcjellë dokumentet e prokurimit përmes mjeteve të tjera të specifikuara nga ai, nëse akses i drejtpërdrejtë përmes mjeteve elektronike nuk është i mundur për shkaqe teknike ose nëse dokumentet e prokurimit përmbajnë informacione konfidenciale.

Përfituesi i grantit mund të përcaktojë kërkesa për operatorët ekonomikë, të cilat kanë si qëllim të mbrojnë natyrën konfidenciale të informacionit që përmbajnë dokumentet e prokurimit. Ai i bën të ditura kërkesat, duke përfshirë edhe mënyrën e aksesimit të dokumenteve të prokurimit në fjalë.

D. Specifikimet teknike dhe kriteret e vlerësimit

16. Specifikimet teknike (pasqyron pikën 17.1, 17.2 dhe 17.8 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit dhe nuk duhet të përbëjnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën e hapur në procedurat e prokurimit.

Specifikimet teknike përfshijnë karakteristikat e nevojshme për punët, furnizimet ose shërbimet, duke përfshirë kërkesat minimale, në mënyrë që të përmbushin qëllimin e tyre, siç kërkohet nga autoriteti kontraktor.

2. Karakteristikat e përmendura në paragrafin 1 mund të përfshijnë, sipas rastit:

a) nivelet e cilësisë;
b) pasojat në mjedis dhe klimë;
c) për blerjet e synuara për përdorim nga personat fizikë, kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet;

d) nivelet dhe procedurat e vlerësimit të përputhshmërisë;

e) rendimentin dhe përdorimin e furnizimit;

f) sigurinë dhe dimensionet, duke përfshirë emrin tregtar dhe manualin e përdorimit sa u takon furnizimeve, si dhe terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit, ambalazhin, shënjimin ose etiketimin, proceset dhe metodat e prodhimit, sa u takon të gjitha kontratave;

g) në rastin e kontratave të punëve, procedurat lidhur me garantimin e cilësisë dhe rregullat lidhur për projektimin dhe llogaritjen e kostove, kushtet e testimit, inspektimit dhe pranimin të punëve, si dhe teknikat ose metodat e ndërtimit dhe të gjitha kushtet e tjera teknike që autoriteti kontraktor është në gjendje të specifikojë, në zbatim të rregulloreve të përgjithshme ose specifike, në lidhje me punët e përfunduara dhe me materialet ose pjesët që ato përmbajnë.

3. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik, si dhe asnjë markë tregtare, patentë, lloj ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa produkteve ose operatorëve ekonomikë.

Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur objekti i kontratës nuk mund të përshkruhet në mënyrë mjaftueshëm të detajuar apo të kuptueshme. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose e barasvlershme”.

17. Dhënia e kontratave (pasqyron nenin 167 të rregullores financiare)

1. Kontratat jepen në bazë të kriterëve për dhënien e kontratës, me kusht që autoriteti kontraktor të ketë verifikuar sa më poshtë:

a) oferta përmbush kërkesat minimale të specifikuara në dokumentet e prokurimit;

b) kandidati ose ofertuesi nuk është i përjashtuar apo i refuzuar;

c) kandidati ose ofertuesi përmbush kriteret e përzgjedhjes të specifikuara të dokumentet e prokurimit dhe nuk është subjekt i konflikteve të interesit, të cilat mund të kenë ndikim negativ në zbatimin e kontratës.

2. Përfituesi i grantit zbaton kriteret e përzgjedhjes për të vlerësuar kapacitetin e kandidatit apo ofertuesit. Kriteret e përzgjedhjes përfshijnë vetëm kapacitetin ligjor dhe rregullator për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar, si dhe kapacitetin teknik dhe profesional.

3. Përfituesi i grantit zbaton kriteret e dhënies së kontratës për të vlerësuar ofertuesin.

4. Përfituesi i grantit e bazon dhënien e kontratës në parimin e ofertës më të favorshme ekonomikisht, që konsiston në një prej tri metodave të dhënies: çmimi më i ulët, kostoja më e ulët ose

raporti më i mirë çmim-cilësi. Sa i takon metodës së kostos më të ulët, përfituesi i grantit ndjek qasjen e bazuar në efikasitetin e kostos, duke përfshirë llogaritjen e kostos së ciklit jetësor. Ndërsa, lidhur me raportin më të mirë çmim-cilësi, autoriteti kontraktor merr në konsideratë çmimin ose koston dhe kriteret e tjera të cilësisë lidhur me objektin e kontratës.

18. Kriteret e përjashtimit dhe përzgjedhjes (pasqyron pikën 18 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Për qëllime të deklarimit dhe vërtetimit se nuk është objekt i rrethanave të përjashtimit, në përputhje me nenin 137 të rregullores financiare, përfituesi i grantit pranon një deklaratë ligjore, të nënshkruar dhe datuar.

2. Përfituesi i grantit paraqet në dokumentet e prokurimit kriteret e përzgjedhjes, nivelet minimale të kapacitetit dhe dëshmitë e nevojshme për ta vërtetuar këtë kapacitet. Të gjitha kërkesat duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Përfituesi i grantit specifikon në dokumentet e prokurimit mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të përmbushin kriteret e përzgjedhjes duke marrë parasysh pikën 18.6.

Kur kontrata ndahet në lote, përfituesi i grantit mund të përcaktojë nivelet minimale të kapacitetit për secilin lot. Ai mund të caktojë nivele minimale të kapacitetit në rast se të njëjtit kontraktor i jepen disa lote.

3. Lidhur me kapacitetin për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë një operatori ekonomik që të përmbushë të paktën një prej kushteve të mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar në një regjister profesional ose tregtar të vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur operatori ekonomik është një organizatë ndërkombëtare;

b) për kontratat e shërbimit, të disponojë një autorizim të posaçëm që dëshmon se ai është i autorizuar të zbatojë kontratën në vendin ku është vendosur ose të jetë anëtar i një organizate profesionale specifike.

4. Në momentin e marrjes së kërkesave për pjesëmarrje ose oferta, autoriteti kontraktor pranon një deklaratë ligjore ku shprehet se kandidati ose ofertuesi përmbush kriteret e përzgjedhjes. Kërkesa për dorëzimin e një deklarate ligjore mund të hiqet për kontratat me vlerë shumë të ulët, domethënë për ato kontrata që nuk i kalojnë 15 000 euro.

Përfituesi i grantit mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve në çdo kohë gjatë procedurës që të paraqesin një deklaratë të përditësuar ose të gjitha apo një pjesë të dokumenteve mbështetëse, kur kjo është e nevojshme për të garantuar kryerjen e procedurës në mënyrën e duhur.

Përfituesi i grantit mund t'u kërkojë kandidatëve ose ofertuesve të përzgjedhur që të dorëzojnë dokumente mbështetëse të përditësuara, me përjashtim të rastit kur i ka marrë ato ndërkohë për qëllimet e një procedure tjetër dhe me kusht që dokumentet të jenë ende të përditësuara, ose mund t'i aksesojë ato në një bazë të dhënash kombëtare pa pagesë.

5. Në varësi të vlerësimit të risqeve, përfituesi i grantit mund të vendosë që të mos kërkojë dëshmi të kapacitetit ligjor, rregullator, financiar, ekonomik, teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë në rastet e mëposhtme:

a) procedurat për kontratat e dhëna, me një vlerë që nuk i kalon pragjet e përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce;

b) procedurat për kontratat e dhëna në përputhje me gerrat “b”, “d”, “e” nën pikat “i” dhe “iv” dhe germen “g” të pikës 6.1.

Në rastet kur përfituesi i grantit vendos që të mos kërkojë dëshmi të kapacitetit ligjor, rregullator, financiar, ekonomik, teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, nuk bëhet asnjë financim paraprak, me përjashtim të rasteve të arsyetuara siç duhet.

6. Një operator ekonomik, sipas rastit dhe për një kontratë të veçantë, mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ka me to. Ai duhet të provojë në këtë rast për përfituesin e grantit, që do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme për zbatimin e kontratës duke paraqitur një angazhim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Në lidhje me kriteret teknike dhe profesionale, një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera vetëm kur këto të fundit do të realizojnë punën ose shërbimet për të cilat nevojiten ato kapacitete.

Kur një operator ekonomik mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, për sa u përket kritereve që lidhen me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe këto subjekte të mbajnë përgjegjësi të përbashkët për zbatimin e kontratës.

Përfituesi i grantit mund të kërkojë informacion nga ofertuesi për çdo pjesë të kontratës që ofertuesi synon të nënkontraktojë, si dhe për identitetin e secilit nënkontraktor.

Për punët dhe shërbimet që ofrohen në një ambient nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të përfituesit të grantit, ky i fundit i kërkon kontraktorit të bëjë të ditur emrat, kontaktet dhe përfaqësuesit e autorizuar të të gjithë nënkontraktorëve të përfshirë në zbatimin e kontratës, duke përfshirë edhe ndryshimet e nënkontraktorëve.

7. Përfituesi i grantit verifikon nëse subjektet, në kapacitetin e të cilëve synon të mbështetet operatori ekonomik, dhe nëse nënkontraktorët e parashikuar, kur nënkontraktimi përbën një pjesë të rëndësishme të kontratës, përmbushin kriteret përkatëse të përzgjedhjes. .

Përfituesi i grantit kërkon që operatori ekonomik të zëvendësojë një subjekt apo nënkontraktor që nuk përmbush një kriter të caktuar të përzgjedhjes.

8. Në rastin e kontratave për punë, kontratave për shërbime dhe operacioneve të vendosjes ose të instalimit në kontekstin e një kontrate furnizimi, përfituesi i grantit mund të kërkojë që disa detyra kritike të kryhen drejtpërsëdrejti nga vetë ofertuesi, ose, kur oferta dorëzohet nga një grup operatorësh ekonomikë, nga një anëtar i atij grupi.

9. Përfituesi i grantit nuk kërkon që, në mënyrë që të paraqesë një ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, grupi i operatorëve ekonomikë të ketë një formë juridike të caktuar, por pas përzgjedhjes mund t'i duhet të ndër marrë një formë juridike konkrete, nëse ky ndryshim është i nevojshëm për zbatimin e duhur të kontratës.

19. Kapaciteti ekonomik dhe financiar (pasqyron pikën 19 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Për t'u siguruar që operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetin ekonomik dhe financiar të nevojshëm për realizimin e kontratës, autoriteti kontraktor mund të kërkojë në veçanti që:

a) që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar, duke përfshirë një xhiro minimale të caktuar në fushën që mbulon kontrata;

b) operatorët ekonomikë të japin informacion mbi bilancet e tyre vjetore, ku përfshihet raporti ndërmjet aktiveve dhe pasiveve;

c) operatorët ekonomikë të mundësojnë një nivel të përshtatshëm të sigurimit ndaj rreziqeve profesionale.

Për qëllimet e germës "a", xhiroja vjetore minimale nuk duhet të kalojë dyfishin e vlerës vjetore të parashikuar në kontratë, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet, të lidhura me natyrën e blerjes, të cilën përfituesi i grantit e shpjegon në dokumentet e prokurimit.

Për qëllimet e germës "b", përfituesi i grantit shpjegon metodat dhe kriteret për këto raporte në dokumentet e prokurimit.

2. Përfituesi i grantit specifikon në dokumentet e prokurimit të dhënat që duhet të jepen nga operatori ekonomik, për të demonstruar kapacitetin e tij ekonomik dhe financiar. Veçanërisht, mund të kërkojë një ose disa prej dokumenteve të mëposhtme:

a) deklaratat e dhura nga bankat, ose sipas rastit, vërtetimin përkatës për sigurim ndaj rreziqeve profesionale;

b) pasqyrat financiare ose ekstraktet e tyre për një periudhë të barabartë me ose më të shkurtër se tre vitet financiare të fundit, për të cilat llogaritë janë mbyllur;

c) një deklaratë të xhiros totale të operatorit ekonomik dhe, sipas rastit, të xhiros në fushën që mbulon kontrata për një periudhë që nuk i kalon tre vjetët financiarë të fundit të disponueshme.

Nëse operatori ekonomik, për çfarëdolloj arsyeje të vlefshme, nuk është në gjendje të japë referencat e kërkuara nga përfituesi i grantit, ai mund të vërtetojë gjendjen e tij ekonomike dhe financiare përmes një dokumenti tjetër, të cilin përfituesi i grantit e konsideron të përshtatshëm.

20. Kapaciteti teknik dhe profesional (pasqyron pikën 20, me përjashtim të pikës 20.4, të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Përfituesi i grantit verifikon nëse kandidatët ose ofertuesit përmbushin kriteret minimale të përzgjedhjes lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, në përputhje me pikat 20.2 deri në 20.4 të kësaj shtojce.

2. Përfituesi i grantit specifikon në dokumentet e prokurimit të dhënat që duhet të jepen nga operatori ekonomik, për të demonstruar kapacitetin e tij teknik dhe profesional. Mund të kërkojë një ose disa prej dokumenteve të mëposhtme:

a) për punët, furnizimet e të cilave kërkojnë operacione ose shërbime të vendosjes apo instalimit, informacion mbi kualifikimet profesionale, aftësitë, përvojën dhe ekspertizën e personave përgjegjës për zbatimin;

b) një listë që përfshin:

i. shërbimet kryesore të ofruara dhe furnizimet e dërguara gjatë tre vjetëve të fundit, ku përfshihen shumat, datat dhe klientët, publikë ose privatë, duke i shoqëruar me deklaratat e lëshuara nga klientët, sipas kërkesës;

ii. punët e kryera gjatë pesë viteve të shkuara, shoqëruar me vërtetime për realizimin e kënaqshëm të punëve më të rëndësishme.

c) një deklaratë të pajisjeve teknike, mjeteve ose të impianteve të disponueshme për operatorin ekonomik për zbatimin e një kontrate të punëve ose shërbimeve;

d) përshkrimin e mjeteve dhe masave teknike të disponueshme për operatorin ekonomik për të siguruar cilësinë dhe një përshkrim të ambienteve të kërimit dhe studimit;

e) informacion për teknikët ose organet teknike në dispozicion të operatorit ekonomik, në varësi të drejtpërdrejtë të tij ose jo, veçanërisht ata që janë përgjegjës për kontrollin e cilësisë;

f) në lidhje me furnizimet: mostra, përshkrime ose fotografi autentike apo certifikata të hartuara nga institute zyrtare të kontrollit të cilësisë ose agjenci të njohura që vërtetojnë përputhshmërinë e produkteve të identifikuara qartë me anë të referencave në specifikime ose standarde teknike.

g) për punët ose shërbimet, një deklaratë të fuqisë punëtore mesatare vjetore dhe të numrit të personelit drejtues të operatorit ekonomik gjatë tre vjetëve të fundit;

h) një informacion për zinxhirin e drejtimit të furnizimit dhe sistemet e gjurmimit që operatori ekonomik do të jetë në gjendje të përdorë gjatë zbatimit të kontratës;

i) një informacion për masat e menaxhimit mjedisor që operatori ekonomik do të jetë në gjendje të zbatojë gjatë realizimit të kontratës;

Për qëllimet e germës “b”, pika i. të paragrafit të parë, kur është e nevojshme për të garantuar një nivel të përshtatshëm konkurrimi, përfituesi i grantit mund të përcaktojë nëse do të merren në konsideratë provat për furnizime ose shërbime të ngjashme të kryera edhe përpara tre vjetëve të fundit.

Për qëllimet e germës “b”, pika ii. të paragrafit të parë, kur është e nevojshme për të garantuar një nivel të përshtatshëm konkurrimi, përfituesi i grantit mund të përcaktojë nëse do të merren në konsideratë provat për punë të ngjashme të kryera edhe përpara pesë viteve të fundit.

3. Në rastet kur furnizimet ose shërbimet janë komplekse ose, në raste të veçanta, kërkohen për një qëllim specifik, kapaciteti teknik dhe profesional mund të vërtetohet përmes një kontrolli të kryer nga autoriteti kontraktor ose, për llogari të tij, nga një organ kompetent zyrtar në vendin ku është vendosur operatori ekonomik, me dakordësinë e atij organi. Këto kontrole vlerësojnë kapacitetin teknik dhe kapacitetin e prodhimit të furnizuesit dhe, nëse është e nevojshme, ambientet e studimit dhe kërimit, si dhe masat për kontrollin e cilësisë.

4. Nëse përfituesi i grantit kërkon certifikata të hartuara nga organet e pavarura, që vërtetojnë se operatori ekonomik është në përputhje me sisteme ose standarde të caktuara të menaxhimit mjedisor, ato i referohen Skemës së Bashkimit Evropian për Menaxhimin Ekologjik dhe Auditimin ose sistemeve të tjera të njohura të menaxhimit mjedisor, në përputhje me nenin 45 të rregullores (KE) nr. 1221/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ose standardeve të tjera të menaxhimit mjedisor që bazohen në standardet përkatëse evropiane ose ndërkombëtare nga organe të akredituara.

Kur është e qartë se një operator ekonomik nuk ka pasur akses në këto certifikata, ose asnjë mundësi për t'i marrë ato brenda afateve kohore përkatëse, për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti kontraktor pranon edhe prova të tjera për masat e menaxhimit mjedisor, me kusht që operatori ekonomik të vërtetojë se këto masa janë të njëjta me ato që kërkojnë në zbatim të sistemit ose standardit të zbatueshëm të menaxhimit mjedisor.

5. Përfituesi i grantit mund të konstatojë se një operator ekonomik nuk ka kapacitetin e kërkuar profesional për zbatimin e kontratës sipas një standardi cilësie të përshtatshëm, kur autoriteti kontraktor ka dalë në përfundimin se operatori ekonomik ka konflikte interesi që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës.

21. Kriteret për dhënien e kontratës (pasqyron pikën 21 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Kriteret e cilësisë mund të përfshijnë elemente të tilla si cilësitë teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmëria, dizajni për të gjithë përdoruesit, karakteristikat novatore, mjedisore dhe sociale, prodhimi, ofrimi dhe procesi i tregtimit dhe çdo proces tjetër specifik në secilën fazë të ciklit të kohëzgjatjes së punëve, furnizimeve ose shërbimeve, organizimi i personelit të ngarkuar me zbatimin e kontratës, shërbimi pas shitjes, asistenca teknike ose kushtet e realizimit, të tilla si data e dorëzimit, procesi i dorëzimit dhe periudha e dorëzimit ose periudha e përfundimit.

2. Përfituesi i grantit specifikon në dokumentet e prokurimit ponderimin relativ që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur përdoret vetëm metoda e çmimit më të ulët. Këto ponderime mund të shprehen në formën e një diapazoni vlerash me një hendek të përshtatshëm minimal dhe maksimal. Ponderimi i zbatuar për çmimin ose koston në raport me kriteret e tjera nuk rezulton në neutralizimin e kriterit të çmimit ose të koston. Nëse ponderimi nuk është i mundur për shkaqe objektive, autoriteti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

3. Përfituesi i grantit mund të përcaktojë nivelet minimale të cilësisë. Ofertat nën nivelet e përcaktuara të cilësisë refuzohen.

4. Llogaritja e koston gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të punëve, furnizimeve ose shërbimeve:

a) koston që mbulohen nga autoriteti kontraktor ose nga përdoruesi tjetër, si:

i. koston që lidhen me blerjen;

ii. koston e përdorimit, të tilla si konsumi i energjisë dhe i burimeve të tjera;

iii. koston e mirëmbajtjes;

iv. koston pas daljes nga përdorimi, si për shembull koston për grumbullimin dhe riciklim,

b) koston e shkaktuara nga pasojat mjedisore, në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet gjatë ciklit të tyre të jetës, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe verifikohet.

5. Kur përfituesi i grantit i vlerëson koston duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ai specifikon në dokumentet e prokurimit të dhënat që duhet të jepen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdoret për të përcaktuar koston e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur koston e shkaktuara nga pasojat mjedisore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) të bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese;

b) të jetë e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;;

c) operatorët ekonomikë të mund të japin të dhënat e kërkuara, me anë të përpjekjeve të arsyeshme.

Sipas rastit, autoriteti kontraktor përdor metodat e zakonshme të detyrueshme për llogaritjen e kostove gjatë ciklit jetësor, siç parashikohet në aktet ligjore të BE-së, të renditur në shtojcën XIII të direktivës 2014/24/BE.

E. Dorëzimi, vlerësimi dhe vendimi për dhënien e kontratës

22. Afatet kohore për procedurat (pasqyron pikën 41 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Për kontratat e shërbimit, afati minimal ndërmjet ditës pas datës së dërgimit të ftesës për ofertë dhe datës përfundimtare për pranimin e ofertave do të jetë 50 ditë. Megjithatë, në raste urgjente mund të autorizohen afate të tjera.

2. Ofertuesit mund të paraqesin pyetjet e tyre me shkrim, përpara datës përfundimtare të pranimit të ofertave. Përfituesi i grantit jep përgjigje për pyetjet përpara datës përfundimtare të pranimit të ofertave.

3. Për procedurat e kufizuara, afati minimal për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje është 30 ditë nga data në të cilën publikohet njoftimi i kontratës. Periudha ndërmjet datës që pason datën e dërgimit të ftesës për ofertë dhe datës përfundimtare të marrjes së ofertave nuk duhet të jetë më pak se 50 ditë. Megjithatë, në raste të tjera përjashtimore mund të autorizohen afate të tjera.

4. Në procedurat e hapura, afatet kohore për marrjen e ofertave, të cilat fillojnë një ditë pas datës së publikimit të njoftimit të kontratës, janë të paktën:

- a) 90 ditë për kontratat e punëve;
- b) 60 ditë për kontratat e furnizimit.

Megjithatë, në raste të tjera përjashtimore mund të autorizohen afate të tjera.

5. Në procedurat e hapura lokale, afatet kohore për marrjen e ofertave, të cilat fillojnë një ditë pas datës së publikimit të njoftimit të kontratës, janë të paktën:

- a) 60 ditë për kontratat e punëve;
- b) 30 ditë për kontratat e furnizimit.

Megjithatë, në raste të tjera përjashtimore mund të autorizohen afate të tjera.

6. Në rastin e procedurave të thjeshtuara të përmendura në germën “d” të pikës 5.1, kandidatët kanë të paktën 30 ditë kohë për të dorëzuar ofertat e tyre, duke filluar nga data e dërgimit të ftesës për ofertë.

23. Komunikimet gjatë procedurës së prokurimit (pasqyron nenin 169 të rregullores financiare)

1. Përpara përfundimit të afatit kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje apo për oferta, përfituesi i grantit mund të komunikojë informacion shtesë lidhur me dokumentet e prokurimit nëse zbulon ndonjë gabim apo mungesë të dhënash në tekst, ose sipas kërkesës nga kandidatët ose ofertuesit. Informacioni i dhënë vihet në dispozicion të të gjithë kandidatëve ose ofertuesve.

2. Pas përfundimit të afatit kohor të kërkesave për pjesëmarrje ose për oferta, çdo rast ku ka pasur komunikime, dhe çdo rast tjetër i justifikuar siç duhet ku nuk ka pasur komunikime, siç parashikohet në nenin 151 të rregullores financiare, shënohet në dosjen e prokurimit.

24. Dorëzimi, komunikimi elektronik dhe vlerësimi (pasqyron nenin 168 të rregullores financiare)

1. Përfituesi i grantit përcakton afatet kohore për marrjen e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e blerjes dhe duke u lënë operatorëve ekonomikë një periudhë të përshtatshme kohe që të përgatisin ofertat e tyre.

2. Nëse konsiderohet e përshtatshme dhe proporcionale, përfituesi i grantit mund t’u kërkojë ofertuesve që të depozitojnë një garanci për t’u siguruar se ofertat e dorëzuara nuk do të tërhiqen përpara nënshkrimit të kontratës. Garancia e kërkuar përfaqëson 1 deri në 2% të vlerës totale të përlogaritur të kontratës. Përfituesi i grantit lëshon garanci:

a) për ofertuesit ose ofertat e refuzuara të përmendura në pikën 26, paragrafi 2, germat “b” ose “c”, pasi ka dhënë informacion rreth rezultatit të procedurës;

b) për ofertuesit e renditur siç përmendet në pikën 26, paragrafi 2, germa “e”, pas nënshkrimit të kontratës.

3. Përfituesi i grantit hap të gjitha ofertat dhe kërkesat për pjesëmarrje. Megjithatë, përfituesi i grantit refuzon:

a) ofertat dhe kërkesat për pjesëmarrje që nuk respektojnë afatet kohore të dorëzimit dhe nuk i hap ato;

b) ofertat që janë të hapura në momentin e marrjes, pa shqyrtuar përmbajtjen e tyre.

4. Një ofertë konsiderohet e parregullt në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur nuk përmbush kërkesat minimale të specifikuara në dokumentet e prokurimit;

b) kur nuk përmbush kërkesat e dorëzimit, të përcaktuara në pikën 24.3 të kësaj shtojce;

c) kur ofertuesi refuzohet për arsyet në vijim:

i. nuk ka paraqitur informacionin e kërkuar si kusht për të marrë pjesë në procedurë ose ka dhënë informacion të gabuar;

ii. ka qenë i përfshirë më parë në përgatitjen e dokumenteve të përdorura në procedurën e dhënies së kontratës, në rastet kur diçka e tillë përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, duke përfshirë shtrebbërim të konkurrencës, të cilat nuk mund të korrigjohen në mënyra të tjera.

d) kur përfituesi i grantit ka deklaruar se oferta është anomalisht e ulët.

5. Një ofertë konsiderohet e papranueshme në një nga rastet e mëposhtme:

a) kur çmimi i ofertës tejkalon buxhetin maksimal të përfituesit të grantit, të përcaktuar dhe të dokumentuar përpara nisjes së procedurës së prokurimit;

b) kur oferta nuk përmbush nivelet minimale të cilësisë të parashikuara në kriteret për dhënien e kontratës.

6. Ofertat dhe kërkesat për pjesëmarrje, të cilat janë të përshtatshme sipas pikës 6.2 dhe të cilat nuk janë as të parregullta sipas paragrafit 4 dhe as të papranueshme sipas paragrafit 5 të kësaj pike, konsiderohen të pranueshme.

7. Duke deroguar nga pika 14.3, për të gjitha procedurat që përfshijnë një kërkesë për pjesëmarrje, specifikimet e ofertës mund të ndahen sipas dy fazave të procedurës dhe faza e parë mund të përmbajë vetëm informacionin e përmendur në gerat “a” dhe “e” të pikës 14.3.

8. Përfituesi i grantit vlerëson të gjitha ofertat dhe kërkesat për pjesëmarrje që nuk janë refuzuar gjatë fazës së hapjes, siç parashikohet në paragrafin 3, bazuar në kriteret e specifikuar në dokumentet e prokurimit, me qëllim dhënien e kontratës ose fillimin e një ankandi elektronik.

9. Përfituesi i grantit mund të heqë dorë nga caktimi i një komiteti vlerësimi për procedurat që kanë një vlerë më të ulët ose të barabartë me 20 000 euro.

10. Ofertat dhe kërkesat për pjesëmarrje që nuk përmbushin të gjitha kërkesat minimale të përcaktuara në dokumente do të refuzohen.

25. Ofertat anomalisht të ulëta (pasqyron pikën 23 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Nëse, për një kontratë të caktuar, çmimi ose kostot e propozuara në një ofertë duket se janë anomalisht të ulëta, përfituesi i grantit kërkon me shkrim detaje të elementeve përbërës të çmimit apo të kostove, të cilat i konsideron të rëndësishme, si dhe i jep ofertuesit mundësinë që të paraqesë komentet e tij. Në veçanti, përfituesi i grantit mund të marrë në konsideratë konstatimet që lidhen me:

a) aspektin ekonomik të procesit të prodhimit, të ofrimit të shërbimeve ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura ose kushtet tejet favorizuese në dispozicion të ofertuesit;

c) origjinalitetin e ofertës;

d) pajtueshmërinë e ofertuesit me detyrimet e zbatueshme të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

e) pajtueshmërinë e nënkontraktorëve me detyrimet e zbatueshme në fushën e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

f) mundësinë e ofertuesit për të përftuar ndihmë shtetërore në përputhje me rregullat e zbatueshme.

2. Autoriteti kontraktor e refuzon ofertën vetëm kur provat e dhëna nuk justifikojnë në një masë të kënaqshme kostot ose çmimin e ulët të propozuar.

Autoriteti kontraktor e refuzon ofertën kur konstaton se oferta është anomalisht e ulët sepse nuk përmbush detyrimet e zbatueshme të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

26. Rezultatet e vlerësimit dhe vendimi për dhënien e kontratës (pasqyron nenin 170.1 të rregullores financiare dhe pikën 30 të shtojcës I)

1. Rezultati i vlerësimit është një raport vlerësimi që përmban propozimin për dhënien e kontratës. Raporti i vlerësimit datohet dhe nënshkruhet nga personi apo personat që kanë realizuar vlerësimin ose nga anëtarët e komitetit të vlerësimit. Ky raport mund të nënshkruhet në një sistem elektronik që siguron identifikim të mjaftueshëm të nënshkruesit.

Nëse komitetit të vlerësimit nuk i është dhënë përgjegjësia për të verifikuar ofertat në raport me kriteret e përjashtimit dhe të përzgjedhjes, atëherë raporti i vlerësimit nënshkruhet gjithashtu nga personat që u është dhënë kjo përgjegjësi nga nëpunësi përgjegjës autorizues.

2. Raporti i vlerësimit përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor, si dhe objektin dhe vlerën e kontratës, ose objektin dhe vlerën maksimale të kontratës kuadër;
- b) emrat e kandidatëve ose ofertuesve të refuzuar dhe arsyet për refuzimin e tyre duke iu referuar kriterëve të përzgjedhjes;
- c) referencat me ofertat e refuzuara dhe arsyet për refuzimin e tyre, duke iu referuar njërit prej aspekteve në vijim:
 - i. mosrespektimit të kërkesave minimale siç përmendet në germën “a” të pikës 17.1 të kësaj shtojce;
 - ii. mospërbushjes së niveleve minimale të cilësisë të përcaktuara në pikën 21.3 të kësaj shtojce;
 - iii. ofertat e konstatuara si anomalisht të ulëta, siç përmendet në pikën 25 të kësaj shtojce;
- d) emrat e kandidatëve ose ofertuesve të përzgjedhur dhe arsyet për përzgjedhjen e tyre;
- e) emrat e ofertuesve që do të renditen sipas rezultateve të marra dhe justifikimet përkatëse;
- f) emrat e kandidatëve të propozuar ose ofertuesve të suksesshëm dhe arsyet e përzgjedhjes;
- g) nëse dihet, pjesa e kontratës apo kontratës kuadër që kontraktori i propozuar synon të nënkontrakttojë te palët e treta.

3. Autoriteti kontraktor e merr vendimin për dhënien e kontratës duke paraqitur:

a) një miratim të raportit të vlerësimit që përmban të gjithë informacionin e renditur në pikën 26.2, të shoqëruar nga informacioni në vijim:

i. emri i ofertuesit të suksesshëm dhe arsyet për zgjedhjen e tij duke iu referuar kriterëve të publikuara paraprakisht për përzgjedhjen dhe dhënien e kontratës, duke përfshirë, sipas rastit, arsyet për mosndjekjen e rekomandimit të dhënë në raportin e vlerësimit;

ii. në rastin e procedurës me negociim pa publikim paraprak dhe të procedurës konkurruese me negociim, rrethanat e përmendura në pikat 6, 7 dhe 8 që justifikojnë përdorimin e tyre;

b) sipas rastit, arsyet se pse përfituesi i grantit ka vendosur të mos japë një kontratë.

4. Përfituesi i grantit mund të bashkojë përmbajtjen e raportit të vlerësimit dhe të vendimit për dhënien e kontratës në një dokument të vetëm dhe ta nënshkruajë atë në një nga rastet në vijim:

a) për procedurat nën pragjet e përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce, në rastet kur është marrë vetëm një ofertë;

b) kur rihap procedurën e konkurrimit bazuar në një kontratë kuadër dhe kur nuk është caktuar një komitet vlerësimi;

c) për rastet e përmendura në pikën 6.1, germën “c”, germën “d”, germën “e”, nënpika i., germën “f”, nënpika iii. dhe germën “g”, kur nuk është caktuar një komitet vlerësimi.

5. Për një procedurë prokurimi të nisur bashkërisht, vendimi i përmendur në pikën 26.3 merret nga përfituesi i grantit që është përgjegjës për procedurën e prokurimit.

6. Përfituesi i grantit vendos se kujt do t'i jepet kontrata, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës të specifikuara në dokumentet e prokurimit.

27. Informacion për kandidatët ose ofertuesit (pasqyron nenin 170 të rregullores financiare dhe pikën 31 të shtojcës I)

1. Përfituesi i grantit njofton të gjithë kandidatët ose ofertuesit, të cilëve u janë refuzuar ofertat ose kërkesat për pjesëmarrje, rreth arsyeve për marrjen e vendimit, si dhe rreth kohëzgjatjes së periudhës së pezullimit. Periudha e pezullimit zgjat 10 ditë në rastin e përdorimit të mjeteve elektronike të komunikimit dhe 15 ditë në rastin e përdorimit të mjeteve të tjera.

Për dhënien e kontratave të caktuara bazuar në një kontratë kuadër me rihapje të procedurës së konkurrimit, autoriteti kontraktor informon ofertuesit për rezultatin e vlerësimit.

2. Përfituesi i grantit informon çdo ofertues që nuk është në situatë përjashtimi, që nuk është i përjashtuar, që ka dorëzuar ofertë në përputhje me dokumentet e prokurimit dhe që bën një kërkesë me shkrim, për cilindo prej aspekteve të mëposhtme:

a) emrin e ofertuesit, ose ofertuesve në rastin e një kontrate kuadër, të cilit/të cilëve u është dhënë kontrata dhe, përveç rastit të një kontrate të caktuar bazuar në një kontratë kuadër me rihapje të procedurës së konkurrimit, karakteristikat dhe avantazhet relative të ofertës së suksesshme, çmimin e paguar ose vlerën e kontratës, cilado qoftë më e përshtatshme;

b) ecurinë e negociatave dhe të dialogut me ofertuesit.

Megjithatë, përfituesi i grantit mund të vendosë të mos publikojë informacione në rast se publikimi i tyre do të pengonte zbatimin e ligjit, do të ishte në kundërshtim me interesin publik ose do të cenonte interesat tregtare legjitime të operatorëve ekonomikë ose mund të shtrembëronte konkurrencën e drejtë midis tyre.

3. Përfituesi i grantit informon të gjithë kandidatët ose ofertuesit, njëkohësisht dhe individualisht, në mënyrë elektronike, rreth vendimit të arritur lidhur me rezultatin e procedurës, sa më shpejt që të jetë e mundur:

a) pas fazës së hapjes për rastet e përmendura në pikën 24.3 të kësaj shtojce;

b) pasi është marrë një vendim në bazë të kritereve të përjashtimit dhe të përzgjedhjes në procedurat e prokurimit të organizuara në dy faza të veçanta;

c) pas dhënies së vendimit.

Në çdo rast, përfituesi i grantit tregon arsyet se pse nuk është pranuar oferta ose kërkesa për pjesëmarrje, si dhe zgjidhjet ligjore të disponueshme.

Kur informon ofertuesin e suksesshëm, përfituesi i grantit specifikon faktin se vendimi i njoftuar nuk përbën një angazhim nga ana e tij.

4. Përfituesi i grantit komunikon informacionin e parashikuar në pikën 27.2, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast, brenda 15 ditëve nga marrja e një kërkesë me shkrim. Kur jep kontrata për llogari të tij, përfituesi i grantit duhet të përdorë mjete elektronike. Ofertuesi mund ta dërgojë gjithashtu kërkesën në mënyrë elektronike.

5. Kur përfituesi i grantit e komunikon informacionin në mënyrë elektronike, atëherë informacioni konsiderohet se është marrë nga kandidatët ose ofertuesit nëse përfituesi i grantit mund të vërtetojë se e ka dërguar në adresën elektronike të përmendur në ofertë ose në kërkesën për pjesëmarrje.

Në këtë rast, informacioni konsiderohet se është marrë nga kandidati ose ofertuesi në datën e dërgimit nga përfituesi i grantit.

28. Anulimi i procedurës së prokurimit (pasqyron nenin 171 të rregullores financiare)

Përfituesi i grantit mund ta anulojë procedurën e prokurimit, përpara nënshkrimit të kontratës, dhe në këtë rast kandidatët ose ofertuesit nuk gëzojnë të drejtën të kërkojnë asnjë kompensim. Vendimi për anulimin duhet justifikuar dhe sjellë në vëmendjen e kandidatëve apo ofertuesve, sa më shpejt që të jetë e mundur.

29. Periudha e pezullimit përpara nënshkrimit të kontratës (pasqyron pikën 35 të shtojcës I të rregullores financiare)

1. Periudha e pezullimit fillon nga një prej datave të mëposhtme:

a) në ditën pas dërgimit të njëkohshëm, në mënyrë elektronike, të njoftimeve për ofertuesit e suksesshëm dhe të pasuksesshëm.

b) kur kontrata ose kontrata kuadër është dhënë në përputhje me germën “b” të pikës 6.1, në ditën pas publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nëse është e nevojshme, përfituesi i grantit mund të pezullojë nënshkrimin e kontratës për të realizuar shqyrtime shtesë nëse diçka e tillë justifikohet nga kërkesat apo komentet e bëra nga kandidatët e pasuksesshëm ose të dëmtuar, nga ofertuesit, ose si pasojë e informacioneve të tjera të rëndësishme të marra gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 27.1 të kësaj shtojce. Në rast pezullimi, të gjithë kandidatët ose ofertuesit informohen brenda tri ditë-pune pas vendimit të pezullimit.

Kur kontrata ose kontrata kuadër nuk mund të nënshkruhet me ofertuesin e suksesshëm të parashikuar, autoriteti kontraktor mund t’ia japë kontratën ofertuesit më të mirë të radhës.

2. Periudha e përcaktuar në pikën 29.1 nuk zbatohet në rastet e mëposhtme:

a) për procedurat ku është dorëzuar vetëm një ofertë;

b) për kontratat e bazuara në një kontratë kuadër;

c) për procedurën me negocim pa publikime paraprake, të përmendur në pikën 6, me përjashtim të kontratave të dhëna në përputhje me germën “b” të pikës 6.1.

F. Zbatimi i kontratës

30. Zbatimi dhe modifikimet e kontratës (pasqyron nenin 172 të rregullores financiare dhe pikën 2.5 të shtojcës I)

1. Zbatimi i kontratës nuk fillon përpara nënshkrimit të saj.

2. Përfituesi i grantit mund ta modifikojë një kontratë apo kontratë kuadër pa procedurë prokurimi vetëm në rastet e parashikuara në paragrafin 3 dhe me kusht që modifikimi të mos ndryshojë objektin e kontratës apo të kontratës kuadër. Përfituesi i grantit publikon në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian një njoftim mbi modifikimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, në rastet e përcaktuara në germat “a” dhe “b” të pikës 30.4, kur vlera e modifikimit është e barabartë ose më e lartë se kufijtë e përmendur në pikën 3 të kësaj shtojce.

3. Një kontratë, një kontratë kuadër, ose një kontratë specifike e bazuar në një kontratë kuadër, mund të modifikohet pa një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme:

a) për punët, furnizimet ose shërbimet shtesë nga kontraktori fillestar, të cilat janë bërë të nevojshme dhe nuk janë përfshirë në prokurimin fillestar, kur përmbushen kushtet e mëposhtme:

i. ndryshimi i kontraktorit nuk mund të bëhet për arsye teknike të lidhura me kërkesat e zëvendësimit apo ndërveprueshmërisë me pajisjet, shërbimet ose instalimet ekzistuese;

ii. ndryshimi i kontraktorit do të shkaktonte dublikime të konsiderueshme të kostove për autoritetin kontraktor;

iii. çdo rritje e çmimit, duke përfshirë vlerën kumulative neto të modifikimeve pasuese, nuk tejkalon 50% të vlerës së kontratës fillestare;

b) kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. nevoja për modifikim ka lindur nga rrethana të cilat nuk mund të parashikoheshin nga një përfitues granti i kujdesshëm;

ii. çdo rritje e çmimit nuk tejkalon 50% të vlerës së kontratës fillestare.

c) kur vlera e modifikimit është më e ulët se pragjet në vijim:

i. pragjet e përmendura në pikën 3 të kësaj shtojce, të zbatueshme në momentin e modifikimit; dhe

ii. 10% të vlerës së kontratës fillestare për kontratat e shërbimit publik dhe furnizimit dhe për kontratat e punëve dhe të koncesionit të shërbimeve dhe nën 15% të vlerës së kontratës fillestare për kontratat e punëve publike;

d) kur përmbushen të dy kushtet në vijim:

i. kërkesat minimale të procedurës fillestare të prokurimit nuk ndryshohen;

ii. çdo modifikim pasues i vlerës është në përputhje me kushtet e përcaktuara në germën “c” të këtij paragrafi, përveçse kur ky modifikim i vlerës rezulton nga zbatimi i rreptë i dokumenteve të prokurimit apo dispozitave kontraktuale.

Vlera e kontratës fillestare nuk merr në konsideratë rishikimet e çmimit. Vlera kumulative neto e disa modifikimeve pasuese, sipas germës “c” të paragrafit të parë, nuk tejkalon asnjë prej pragjeve të përmendura aty. Autoriteti kontraktor aplikon masat e publikimit *ex post* të përcaktuara në pikën 3 të kësaj shtojce.

31. Garancitë e performancës dhe garancitë e mbajtjes së parave (pasqyron deklamimin 115 dhe nenin 173 të rregullores financiare)

1. Përfituesi i grantit mund të kërkojë një garanci performance në lidhje me punët, furnizimet dhe shërbimet komplekse për të garantuar pajtueshmërinë me detyrimet thelbësore kontraktuale, si dhe për të garantuar performancën e duhur gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Përfituesi i grantit mund të kërkojë gjithashtu një garanci të mbajtjes së parave për të mbuluar periudhën e detyrimeve të kontratës.

2. Garancia e performancës ka vlerë maksimale prej 10% të vlerës totale të kontratës. Kjo garanci lëshohet pas pranimit përfundimtar të punëve, furnizimeve ose shërbimeve komplekse, brenda një periudhe të specifikuar në kontratë. Lëshimi i garancisë bëhet brenda:

a) 90 ditëve kalendarike për shërbimet teknike ose për veprimet që janë veçanërisht komplekse për t'u vlerësuar dhe për të cilat pagesa varet nga miratimi i një raporti apo një certifikate;

b) 60 ditëve kalendarike për të gjitha kontratat e tjera, për të cilat pagesa varet nga miratimi i një raporti apo një certifikate;

c) 30 ditëve kalendarike për të gjitha kontratat e tjera.

Garancia mund të lëshohet pjesërisht apo plotësisht pas pranimit të përkohshëm të punëve, furnizimeve ose shërbimeve komplekse.

3. Garancia e mbajtjes së parave, e cila ka një vlerë maksimale prej 10% të vlerës totale të kontratës, mund të përbëhet nga zbritjet nga pagesat e përkohshme, në momentin që ato kryhen, ose nga zbritjet nga pagesa përfundimtare.

Përfituesi i grantit përcakton shumën e garancisë së mbajtjes së parave, e cila është proporcionale me risqet e identifikuara në lidhje me zbatimin e kontratës, duke marrë në konsideratë objektin e saj dhe kushtet e zakonshme tregtare të zbatueshme në sektorin përkatës.

Garancia e mbajtjes së parave nuk përdoret në një kontratë në rastet kur është kërkuar dhe nuk është lëshuar një garanci e performancës.

4. Pas miratimit nga përfituesi i grantit, kontraktori mund të kërkojë zëvendësimin e garancisë së mbajtjes së parave me një garanci të lëshuar nga një bankë ose nga një institucion i autorizuar financiar, apo me një garanci të përbashkët dhe individuale të një kontraktori dhe një pale të tretë.

5. Përfituesi i grantit lëshon garancinë e mbajtjes së parave pas përfundimit të periudhës së detyrimeve të kontratës, brenda një periudhe që është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në paragrafin 2 dhe që do të specifikohet në kontratë.

Programi INTERREG SFC2021

CCI	2021TC16FFTN001
Titulli	(Interreg VI-B) euro Mesdhe (EURO MED)
Versioni	1.1
Viti i parë	2021
Viti i fundit	2027
Neni 17(4)(b)	Buxhet i vetëm për "Fondet Interreg"
Fondet e buxhetit të vetëm	ERDF IPA
I pranueshëm nga	1 janari 2021
I pranueshëm deri në	31 dhjetor 2029
Numri i vendimit të KE-së	C(2022)3715
Data e vendimit të KE-së	31 maj 2022
Rajonet NUTS që mbulon Programi	EL411 - Αέσβος, Λήμνος EL412 - Ιακρία, Σάμος EL413 - Χίος EL42 - Νότιο Αιγαίο EL421 - Κάλυμνος, Κάρπαθος – Ηρωική Νήσος Κάσος, Κως, Ρόδος EL422 - Άνδρος, Θήρα, Κέα, Μήλος, Μύκονος, Νάξος, Πάρος, Σύρος, Τήνος EL43 - Κρήτη EL431 - Ηράκλειο EL432 - Λασιθί EL433 - Ρέθυμνο EL434 - Χανιά EL5 - Βόρεια Ελλάδα EL51 - Ανατολική Μακεδονία, Θράκη EL511 - Έβρος EL512 - Ξάνθη EL513 - Ροδόπη EL514 - Δράμα EL515 - Θάσος, Καβάλα EL52 - Κεντρική Μακεδονία

EL521 - Ημαθία
EL522 - Θεσσαλονίκη
EL523 - Κιλκίς
EL524 - Πέλλα
EL525 - Πιερία
EL526 - Σέρρες
EL527 - Χαλκιδική
EL53 - Δυτική Μακεδονία
EL531 - Γρεβενά, Κοζάνη
EL532 - Καστοριά
EL533 - Φλώρινα
EL54 - Ήπειρος
EL541 - Άρτα, Πρέβεζα
EL542 - Θεσπρωτία
EL543 - Ιωάννινα
EL6 - Κεντρική Ελλάδα
EL61 - Θεσσαλία
EL611 - Καρδίτσα, Τρίκαλα
EL612 - Λάρισα
EL613 - Μαγνησία, Σποράδες
EL62 - Ιόνια Νησιά
EL621 - Ζάκυνθος
EL622 - Κέρκυρα
EL623 - Ιθάκη, Κεφαλληνία
EL624 - Λευκάδα
EL63 - Δυτική Ελλάδα
EL631 - Αιτωλοακαρνανία
EL632 - Αχαΐα
EL633 - Ηλεία
EL64 - Στερεά Ελλάδα
EL641 - Βοιωτία
EL642 - Εύβοια
EL643 - Ευρυτανία
EL644 - Φθιώτιδα
EL645 - Φωκίδα
EL65 - Πελοπόννησος
EL651 - Αργολίδα, Αρκαδία
EL652 - Κορινθία
EL653 - Λακωνία, Μεσσηνία
ITC - Nord-Ovest
ITC1 - Piemonte
ITC11 - Torino
ITC12 - Vercelli
ITC13 - Biella
ITC14 - Verbano-Cusio-Ossola
ITC15 - Novara
ITC16 - Cuneo
ITC17 - Asti
ITC18 - Alessandria
ITC2 - Valle d'Aosta/Vallée d'Aoste
ITC20 - Valle d'Aosta/Vallée d'Aoste
ITC3 - Liguria
ITC31 - Imperia
ITC32 - Savona
ITC33 - Genova
ITC34 - La Spezia
ITC4 - Lombardia
ITC41 - Varese
ITC42 - Como
ITC43 - Lecco
ITC44 - Sondrio
ITC46 - Bergamo

	ITC47 - Brescia
	ITC48 - Pavia
	ITC49 - Lodi
	ITC4A - Cremona
	ITC4B - Mantova
	ITC4C - Milano
	ITC4D - Monza e della Brianza
	ITF - Sud
	ITF1 - Abruzzo
	ITF11 - L'Aquila
	ITF12 - Teramo
	ITF13 - Pescara
	ITF14 - Chieti
	ITF2 - Molise
	ITF21 - Isernia
	ITF22 - Campobasso
	ITF3 - Campania
	ITF31 - Caserta
	ITF32 - Benevento
	ITF33 - Napoli
	ITF34 - Avellino
	ITF35 - Salerno
	ITF4 - Puglia
	ITF43 - Taranto
	ITF44 - Brindisi
	ITF45 - Lecce
	ITF46 - Foggia
	ITF47 - Bari
	ITF48 - Barletta-Andria-Trani
	ITF5 - Basilicata
	ITF51 - Potenza
	ITF52 - Matera
	ITF6 - Calabria
	ITF61 - Cosenza
	ITF62 - Crotone
	ITF63 - Catanzaro
	ITF64 - Vibo Valentia
	ITF65 - Reggio di Calabria
	ITG - Isole
	ITG1 - Sicilia
	ITG11 - Trapani
	ITG12 - Palermo
	ITG13 - Messina
	ITG14 - Agrigento
	ITG15 - Caltanissetta
	ITG16 - Enna
	ITG17 - Catania
	ITG18 - Ragusa
	ITG19 - Siracusa
	ITG2 - Sardegna
	ITG2D - Sassari
	ITG2E - Nuoro
	ITG2F - Cagliari
	ITG2G - Oristano
	ITG2H - Sud Sardegna
	ITH3 - Veneto
	ITH31 - Verona
	ITH32 - Vicenza
	ITH33 - Belluno
	ITH34 - Treviso
	ITH35 - Venezia
	ITH36 - Padova

	ITH37 - Rovigo
	ITH4 - Friuli-Venezia Giulia
	ITH41 - Pordenone
	ITH42 - Udine
	ITH43 - Gorizia
	ITH44 - Trieste
	ITH5 - Emilia-Romagna
	ITH51 - Piacenza
	ITH52 - Parma
	ITH53 - Reggio nell'Emilia
	ITH54 - Modena
	ITH55 - Bologna
	ITH56 - Ferrara
	ITH57 - Ravenna
	ITH58 - Forlì-Cesena
	ITH59 - Rimini
	ITI - Centro (IT)
	ITI1 - Toscana
	ITI11 - Massa-Carrara
	ITI12 - Lucca
	ITI13 - Pistoia
	ITI14 - Firenze
	ITI15 - Prato
	ITI16 - Livorno
	ITI17 - Pisa
	ITI18 - Arezzo
	ITI19 - Siena
	ITI1A - Grosseto
	ITI2 - Umbria
	ITI21 - Perugia
	ITI22 - Terni
	ITI3 - Marche
	ITI31 - Pesaro e Urbino
	ITI32 - Ancona
	ITI33 - Macerata
	ITI34 - Ascoli Piceno
	ITI35 - Fermo
	ITI4 - Lazio
	ITI41 - Viterbo
	ITI42 - Rieti
	ITI43 - Roma
	ITI44 - Latina
	ITI45 - Frosinone
	MT0 - Malta
	MT00 - Malta
	MT001 - Malta
	MT002 - Gozo and Comino/Għaëdex u Kemmuna
	ME0 - Црна Гора
	ME00 - Црна Гора
	ME000 - Црна Гора
	MK0 - Северна Македонија
	MK00 - Северна Македонија
	MK001 - Вардарски
	MK002 - Источен
	MK003 - Југозападен
	MK004 - Југоисточен
	MK005 - Пелагониски
	MK006 - Полошки
	MK007 - Североисточен
	_____MK008 - Скопски
	PT15 - Algarve
	PT150 - Algarve

	PT17 - Área Metropolitana de Lisboa
	PT170 - Área Metropolitana de Lisboa
	PT18 - Alentejo
	PT181 - Alentejo Litoral
	PT184 - Baixo Alentejo
	PT185 - Lezíria do Tejo
	PT186 - Alto Alentejo
	PT187 - Alentejo Central
	SI0 - Slovenija
	SI03 - Vzhodna Slovenija
	SI031 - Pomurska
	SI032 - Podravska
	SI033 - Koroška
	SI034 - Savinjska
	SI035 - Zasavska
	SI036 - Posavska
	SI037 - Jugovzhodna Slovenija
	SI038 - Primorsko-notranjska
	SI04 - Zahodna Slovenija
	SI041 - RSOednjeslovenska
	SI042 - Gorenjska
	FRJ - Occitanie
	FRJ1 - Languedoc-Roussillon
	FRJ11 - Aude
	FRJ12 - Gard
	FRJ13 - Hérault
	FRJ14 - Lozère
	FRJ15 - Pyrénées-Orientales
	FRJ2 - Midi-Pyrénées
	FRJ21 - Ariège
	FRJ22 - Aveyron
	FRJ23 - Haute-Garonne
	FRJ24 - Gers
	FRJ25 - Lot
	FRJ26 - Hautes-Pyrénées
	FRJ27 - Tarn
	FRJ28 - Tarn-et-Garonne
	EN 6 EN
	FRK2 - Rhône-Alpes
	FRK21 - Ain
	FRK22 - Ardèche
	FRK23 - Drôme
	FRK24 - Isère
	FRK25 - Loire
	FRK26 - Rhône
	FRK27 - Savoie
	FRK28 - Haute-Savoie
	FRL - Provence-Alpes-Côte d’Azur
	FRL0 - Provence-Alpes-Côte d’Azur
	FRL01 - Alpes-de-Haute-Provence
	FRL02 - Hautes-Alpes
	FRL03 - Alpes-Maritimes
	FRL04 - Bouches-du-Rhône
	FRL05 - Var
	FRL06 - Vaucluse
	FRM - Corse
	FRM0 - Corse
	FRM01 - Corse-du-Sud
	FRM02 - Haute-Corse
	SI043 - Goriška
	SI044 - Obalno-kraška
	ES24 - Aragón

	ES241 - Huesca
	ES242 - Teruel
	ES243 - Zaragoza
	ES3 - Comunidad de Madrid
	ES30 - Comunidad de Madrid
	ES300 - Madrid
	ES42 - Castilla-La Mancha
	ES421 - Albacete
	ES422 - Ciudad Real
	ES423 - Cuenca
	ES424 - Guadalajara
	ES425 - Toledo
	ES43 - Extremadura
	ES431 - Badajoz
	ES432 - Cáceres
	ES5 - Este
	ES51 - Cataluña
	ES511 - Barcelona
	ES512 - Girona
	ES513 - Lleida
	ES514 - Tarragona
	ES52 - Comunitat Valenciana
	ES521 - Alicante/Alacant
	ES522 - Castellón/Castelló
	ES523 - Valencia/València
	ES53 - Illes Balears
	ES531 - Eivissa y Formentera
	ES532 - Mallorca
	ES533 - Menorca
	ES6 - Sur
	ES61 - Andalucía
	ES611 - Almería
	ES612 - Cádiz
	ES613 - Córdoba
	ES614 - Granada
	ES615 - Huelva
	ES616 - Jaén
	ES617 - Málaga
	ES618 - Sevilla
	ES62 - Región de Murcia
	ES620 - Murcia
	ES63 - Ciudad de Ceuta
	ES630 - Ceuta
	ES64 - Ciudad de Melilla
	ES640 - Melilla
	AL0 - Shqipëria
	AL01 - Veri
	AL011 - Dibër
	AL012 - Durrës
	AL013 - Kukës
	AL014 - Lezhë
	AL015 - Shkodër
	AL02 - Qender
	AL021 - Elbasan
	AL022 - Tiranë
	AL03 - Jug
	AL031 - Berat
	AL032 - Fier
	AL033 - Gjirokastër
	AL034 - Korçë
	AL035 - Vlorë
	BG3 - Северна и Югоизточна България

	BG31 - Северозападен
	BG311 - Видин
	BG312 - Монтана
	BG313 - Враца
	BG314 - Плевен
	BG315 - Ловеч
	BG32 - Северен централен
	BG321 - Велико Търново
	BG322 - Габрово
	BG323 - Русе
	BG324 - Разград
	BG325 - Силистра
	BG33 - Североизточен
	BG331 - Варна
	BG332 - Добрич
	BG333 - Шумен
	BG334 - Търговище
	BG34 - Югоизточен
	BG341 - Бургас
	BG342 - Сливен
	BG343 - Ямбол
	BG344 - Стара Загора
	BG4 - Югозападна и Южна централна България
	BG41 - Югозападен
	BG411 - София (столица)
	BG412 - София
	BG413 - Благоевград
	BG414 - Перник
	BG415 - Кюстендил
	BG42 - Южен централен
	BG421 - Пловдив
	BG422 - Хасково
	BG423 - Пазарджик
	BG424 - Смолян
	BG425 - Кърджали
	BA - Bosnia and Herzegovina
	BA001 - Brčko District
	BA002 - Municipalities
	HR0 - Hrvatska
	HR02 - Panonska Hrvatska
	HR021 - Bjelovarsko-bilogorska županija
	HR022 - Virovitičko-podravska županija
	HR023 - Požeško-slavonska županija
	HR024 - Brodsko-posavska županija
	HR025 - Osječko-baranjska županija
	HR026 - Vukovarsko-srijemska županija
	HR027 - Karlovačka županija
	HR028 - Sisačko-moslavačka županija
	HR03 - Jadranska Hrvatska
	HR031 - Primorsko-goranska županija
	HR032 - Ličko-senjska županija
	HR033 - Zadarska županija
	HR034 - Šibensko-kninska županija
	HR035 - Splitsko-dalmatinska županija
	HR036 - Istarska županija
	HR037 - Dubrovačko-neretvanska županija
	HR05 - Grad Zagreb
	HR050 - Grad Zagreb
	HR06 - Sjeverna Hrvatska
	HR061 - Međimurska županija
	HR062 - Varaždinska županija
	HR063 - Koprivničko-križevačka županija

	HR064 - Krapinsko-zagorska županija HR065 - Zagrebačka županija CY0 - Κύπρος CY00 - Κύπρος CY000 - Κύπρος EL3 - Αττική EL30 - Αττική EL301 - Βόρειος Τομέας Αθηνών EL302 - Δυτικός Τομέας Αθηνών EL303 - Κεντρικός Τομέας Αθηνών EL304 - Νότιος Τομέας Αθηνών EL305 - Ανατολική Αττική EL306 - Δυτική Αττική EL307 - Πειραιάς, Νήσοι EL4 - Νησιά Αιγαίου, Κρήτη
Drejtimi:	Drejtimi B: Programi i Bashkëpunimit Transnacional TN (BTE)

Pasqyra e lëndës

1. Strategjia e përbashkët e programit: zhvillimet kryesore, sfidat dhe politikat

1.1 Zona e programit (nuk kërkohet për programet Interreg C)

1.2 Strategjia e përbashkët e programit: përmbledhje e sfidave të përbashkëta kryesore, duke pasur parasysh pabarazitë ekonomike, social edhe territoriale si edhe nevojat për investime të përbashkëta, komplementaritetin dhe sinergjitë me programet dhe instrumentet e tjera financuese, mësimet e nxjerra nga përvoja e mëparshme dhe strategjitë makrorajonale, si dhe strategjitë për basenet lumore ku zona e programit mbulohet pjesërisht ose plotësisht nga një apo më shumë strategji.

1.3 Arsytimi për përzgjedhjen e objektivave të politikave dhe të objektivave specifike për Interreg, prioritetet korresponduese, objektivat specifike dhe format e mbështetjes, duke adresuar sipas rastit hallkat e munguara në infrastrukturën ndërkufitare.

Tabela 1.

2. Prioritetet

2.1 Prioriteti: 1 – MED më inteligjent

2.1.1 Objektivi specifik: RSO1.1. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe novacionit dhe i përvetësimit të teknologjive të avancuara

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

2.1.1.2 Treguesit

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

2.1 Prioriteti: 2 – MED më i gjelbër

2.1.1 Objektivi specifik: RSO2.4. Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore dhe rezistencës, duke marrë parasysh qasjen e bazuara në ekosistem

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

2.1.1.2 Treguesit

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

2.1.1 Objektivi specifik: RSO 2.6. Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me efikasitet të burimeve

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifikë dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

2.1.1.2 Treguesit

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

2.1.1 Objektivi specifik: RSO2.7. Forcimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë në zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifikë dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

2.1.1.2 Treguesit

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare 90

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

2.1 Prioriteti: 3 – Qeverisja e MED

2.1.1 Objektivi specifik: ISO6.6. Veprime të tjera për të mbështetur më mirë qeverisjen e bashkëpunimit (të gjitha drejtimet)

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

2.1.1.2 Treguesit

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Tabela 4 - Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Tabela 5 - Dimensioni 2 – forma e financimit

Tabela 6 - Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

3. Plani financiar

3.1 Alokimet financiare vjetore

Tabela 7

3.2 Totali i alokimeve financiare sipas fondeve dhe bashkëfinancimit kombëtar

Tabela 8

4. Veprimet e ndërmarra për të përfshirë partnerët e programit në përgatitjen e programit Interreg dhe roli i këtyre partnerëve programi në zbatim, monitorim dhe vlerësim

5. Qasja e komunikimit dhe vizibilitetit për programin Interreg (objektivat, audiencat e synuara, kanalet e komunikimit, përfshirë mediat sociale sipas rastit, buxheti i planifikuar dhe treguesit përkatës për monitorimin dhe vlerësimin)

6. Mbështetja për projekte të vogla, përfshirë projektet e vogla brenda fondeve për projekte të vogla

7. Dispozitat zbatuese

7.1 Autoritetet e programit

Tabela 9

7.2 Procedura për ngritjen e Sekretariatit të Përbashkët

7.3 Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet Shteteve Anëtare pjesëmarrëse dhe, sipas rastit, ndër vendet partnere dhe VTPD-të, në rast korrigjimesh financiare që imponon autoriteti menaxhues ose Komisioni

8. Kostot për njësi, shumat totale, normat fikse dhe financimet që nuk lidhen me kostot

Tabela 10. Kostot për njësi, shumat totale normat fikse dhe financimet që nuk lidhen me kostot

Shtojca 1

A. Përmbajtja e elementeve kryesore

Shtojca 1

B. Detajet sipas llojit të operacionit

C. Llogaritja e shkallës standarde të kostove për njësi, shumave totale dhe normave fikse

1. Burimi i të dhënave të përdorura për të llogaritur shkallën standarde të kostove për njësi, shumave totale dhe normave fikse

2. Lutemi, sqaroni pse metoda e propozuar dhe përllogaritja bazuar në nenin 94(2) është relevant për llojin e operacionit.

3. Lutemi, sqaroni si janë bërë llogaritjet, veçanërisht për ndonjë supozim për cilësinë apo sasitë. Sipas rastit, duhet të përdoren evidencat statistikore dhe parametra dhe, nëse kërkohet, të përgatiten në format të përdorshëm për Komisionin:

4. Lutemi, shpjegoni si keni garantuar përfshirjen vetëm të shpenzimeve të pranueshme në përllogaritjen e shkallës standard të kostove për njësi, shumave totale apo normës fikse:

5. Vlerësimi i autoritetit(eve) auditues për metodologjinë e përlogaritjes dhe shumat dhe për modalitetet për të garantuar verifikimin, cilësinë, mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave:

Shtojca 2

A. Përmbajtja e elementeve kryesore

B. Detajet sipas llojit të operacionit

Shtojca 3: Lista e operacioneve të planifikuara me rëndësi strategjike me një kalendar – neni 22(3) i CPR-së

DOKUMENTET

1. Strategjia e përbashkët e programit: zhvillimet kryesore, sfidat dhe politikat

1.1. Zona e programit (nuk kërkohet për programet Interreg C)

Referenca: germa (a) e nenit 17(3), germa (a) e nenit 17(9)

Në bregun verior të detit Mesdhe, programi INTERREG Euro-MED mbulon një territor të gjerë që shtrihet nga rajonet portugeze në bregdetin e Atlantikut, deri në Qipro në skajin lindor të Mesdheut duke kaluar përmes Ballkanit. Gjithashtu, për herë të parë pas dy periudhave programimi, shtrihet edhe në zonën bregdetare bullgare të Detit të Zi.

Në fakt, pas një zgjerimi të vogël të programit në vitin 2014, në këtë periudhë programimi u miratua një zgjerim më thelbësor: në zonën e pranueshme u shtuan dy vende, Bullgaria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut plus, si dhe tri rajone spanjolle (Castilla la Mancha, Extremadura dhe Madrid).

Për shkak të *Brexit*, Gjibraltari (MB) nuk është më pjesë e zonës së programit Interreg Euro-MED.

Programi Interreg Euro-MED tani mbulon 69 rajone, ndër të cilat 65 rajone (NUTS 2) të 10 vendeve të BE-së (Bullgaria, Qipro, Kroacia, Franca, Greqia, Italia, Malta, Portugalia, Sllovenia dhe Spanja), si dhe 4 vende kandidate për IPA (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut). Zona gjeografike e pranueshme përbën rreth 25% të territorit të Bashkimit Evropian, me mbi 140 milionë njerëz (përfshirë të gjitha vendet partnere).

Territori ka veçori natyrore, fizike dhe gjeografike jashtëzakonisht të larmishme. Me vijë bregdetare prej më shumë se 15 000 kilometrash dhe fusha pjellore, të cilat ishin djepi i bujqësisë mesdhetare me kultivimin e hardhisë dhe plantacionet e ullirit dhe agrumeve. Gjithashtu, ka vargmale të larta si Alpet, Ballkanin, Pindin dhe Pirenejtë. Një tjetër veçori e zonës MED është prania e rëndësishme e ishujve, duke përfshirë dy shtete anëtare (Qipron dhe Maltën) dhe basenet lumore, si: Ebro (Spanjë), Reni (Francë), Po (Itali) dhe Danub (Bullgari).

Të gjitha vendet që lagen nga Deti Mesdhe janë pjesë e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (OKB FAO).

Rajoni i Mesdheut ka edhe biodiversitet tokësor të pasur me 25 000 specie bimësh, 290 specie pemësh dhe shkurresh nga të cilat rreth 70% janë endemike, si dhe 220 specie gjitarësh. Ndërsa në Deti Mesdhe jetojnë një larmi e jashtëzakonshme organizmash detarë shumë prej të cilëve janë endemikë për rajonin. Vlerësohet se Mesdheu përmban 8-9% të krijesave detare të botës.

1.2 Strategjia e përbashkët e programit: përmbledhje e sfidave të përbashkëta kryesore, duke pasur parasysh pabarazitë ekonomike, social edhe territoriale, si edhe nevojat për investime të përbashkëta, komplementaritetin dhe sinergjitë me programet dhe instrumentet e tjera financuese, mësimet e nxjerra nga përvoja e mëparshme dhe strategjitë makrorajonale, si dhe strategjitë për basenet lumore ku zona e programit mbulohet pjesërisht ose plotësisht nga një apo më shumë strategji.

Referenca: germa (b) e nenit 17(3), germa (b) e nenit 17(9)

Programi Interreg Euro-MED është program i bashkëpunimi territorial evropian në nivel transnacional. Objektivi i përgjithshëm mishërohet si në fjalën “bashkëpunim”, ashtu edhe në tre mbiemrat që e përcaktojnë me rregullore: territorial, evropian dhe transnacional. Misioni i programit është të gjejë, të transferojë dhe të zbatojë zgjidhje për problemet e identifikuara si prioritete në fushat e novacionit, ekonomisë dhe mjedisit (përshtatuar më poshtë), përmes partneriteteve shumëkulturore dhe shumëpalëshe (publike dhe private) në kuadrin e projekteve objektivi kryesor i të cilëve janë nevojat e territoreve dhe të popullsisë të Mesdheut. Ky do të përbëjë objektivin e përgjithshëm të Interreg Euro-MED: të promovojë reflektimin e përbashkët me qëllim zbatimin e zgjidhjeve të

përbashkëta dhe në këtë mënyrë të forcojë kohezionin e zonës sonë evropiane. Megjithatë, ky objektivi mund të arrihet vetëm nëse të gjitha palët e interesuara identifikojnë, zbërthejnë dhe pranojnë sfidat që do të trajtohen.

Vitet e fundit janë publikuar shumë raporte dhe studime, me idenë e përcaktimit të prioriteteve për Mesdheun deri më 2020, 2030... 2050. Të krijohet përshtypja se këto prioritete mbeten të njëjta, megjithëse horizonti po largohet. Kjo nënkupton, nga njëra anë, se prioritetet për brezin e tretë të Interreg MED janë rikonfirmuar dhe, nga ana tjetër, se puna për t'i realizuar kërkon fokus të fuqishëm të përqendrimit i burimeve.

Kapitalizimi i të gjithë trashëgimisë së Interreg MED mbetet prioritet dhe sfida në vetvete, edhe për programimin e ri 2021–2027.

Sot, Mesdheu është një zonë shumëplanëshe me sfida madhore për të gjithë planetin: qendërimi si zonë përfaqësuese e bën laborator për studimin e fenomeneve të ndërlikuara, krizave dhe rezistencës.¹⁰

Sfidat

Cilat janë sfidat dhe nga vijnë?

Kriza e vitit 2008 goditi fort shumë pjesë të BE-së dhe përmbysi trendin afatgjatë të zvogëlimit të pabarazive rajonale. Në periudhën 2009–2015, kriza rezultoi në uljen e PBB-së për frymë në rreth 40% të rajoneve, kryesisht në Irlandë, Itali, Spanjë, Portugali dhe Greqi. Pabarazitë rajonale u zgjeruan, por në vitin 2015 filluan të ngushtohen sërish deri në vitin 2020...

Është fakt që në pranverën e 2020-ës, shpërthimi i pandemisë COVID-19 goditi rëndë ekonominë evropiane.¹¹

Aktiviteti ekonomik pësoi rënie të fortë: në gjysmën e parë të vitit, ekonomia evropiane pati ulje drastike dhe të papritur të aktivitetit ekonomik midis marsit dhe majit. Pas rënies me 3.7% në tremujorin e parë, PBB-ja e eurozonës ra me 11.8% në të dytën.

Për referencë, rënia e fundit është gati 4 herë më e madhe se tkurrja maksimale tremujore gjatë recesionit të madh në 2008–2009. Gjatë gjysmës së parë të vitit, aktiviteti ekonomik në eurozonë u tkurr me rreth 15%, duke e rikthyer prodhimin pranë niveleve fillimit të vitit 2005.

Kriza e COVID-19 shkaktoi dëm veçanërisht të rëndë në tregtinë e jashtme të BE-së dhe eurozonës, pasi rënia e papritur dhe e sinkronizuar e kërkesës globale u ndërthur me kufizimet e ofertës për shkak të shtetrrëthimeve, mbylljes së kufijve, ndalimit të udhëtimeve dhe kufizimeve ndaj lëvizshmërisë së brendshme.

Goditja e Shteteve Anëtare u amplifikua më tej për shkak të integritetit të tyre të lartë zinxhirët e vlerës globale. Pandemia COVID-19 i ka tendosur fort tregjet e punës të BE-së. Humbjet e vendeve të punës gjatë gjysmës së parë të vitit ishin të paprecedentë, megjithëse këto humbje ishin shumë më të kufizuara sesa vetë rënia e aktivitetit ekonomik dhe rritja e shkallës së papunësisë.

Sektori ku ndikimi i pandemisë po lë plagë të thella është turizmi. Kjo nënkupton që vendet me varësi të madhe të turizmit janë goditur më rëndë dhe mund të kenë nevojë për më shumë kohë për riaftësim të plotë.¹²

Ndër gjashtë Shtetet Anëtare më të mëdha të BE-së, Spanja (rreth 22%), Franca (18.75%) dhe Italia (17.75%) shënuan rënie më të madhe të PBB-së sesa Gjermania (11.50%), Holanda (9.75%) dhe Polonia (9.25%). Në total, rënia e shpenzimeve konsumatore në gjysmën e parë të vitit në vendet më të mëdha të eurozonës varioi nga 25.25% në Spanjë, në rreth 17.50% në Itali, 17% në Francë dhe 13.25% në Gjermani..

Në tërësi, investimet shënuan rënie kumulative prej 8.3% në Gjermani dhe 10.7% në Holandë, ndërsa rreth 25% në Francë, Itali dhe Spanjë. Këto dallime pasqyrojnë kryesisht investimet në ndërtim, të cilat shënuan rritje me 0.7% në Gjermani dhe rënie me 2.4% në Holandë, por patën rënie 26–29% në Francë, Itali dhe Spanjë...

Në përgjithësi, rajonet “më të varfra” mund të ndahen në dy grupe të dallueshme: zonat rurale me popullsi të rrallë të karakterizuara nga plakja e popullsisë dhe emigracioni neto; dhe rajonet post-industriale që e kanë humbur bazën industriale tradicionale industriale, pjesërisht për shkak të pasojave të globalizimit. Rajonet më të varfra në BE janë të vendosura kryesisht në një brez që shtrihet

¹⁰ Dossier « La Méditerranée » La lettre Aix-Marseille Université, dhjetor 2019.

¹¹ “Parashikimi Ekonomik Evropian” – dokument institucional 135, nëntor 2020 (KE).

¹² Në vitin 2018, turizmi përbënte 13.0% të PBB-së (14.7% të punësimit) në Itali, 11.8% (13.5%) në Spanjë, 8.0% (9.8%) në Portugali, 7.4% (7.5%) në Francë dhe 6.8% (10.0%) në Greqi (burimi: OECD (2020) Tendencat dhe politikat e turizmit).

nga Letonia në veri, përmes pjesëve lindore të BE-së, në Greqi dhe Italinë jugore, më pas përhapen në rajonet jugore të Spanjës dhe në pjesën më të madhe të Portugalisë, ndërsa krijimi i pasurisë është shpesh i përqendruar në kryeqytete dhe rajone metropolitane.

Sipas raporteve të ESPON-it për “Bashkëpunimin territorial për të ardhmen e Evropës (2017)” dhe “Gjendja e territorit evropian (2019)”:

1. Në **rajonet rurale periferike të mbetura pas**, ekziston nevoja për përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve të interesit të përgjithshëm, bashkëpunimit ndërrajonal dhe transnacional, si dhe bashkëpunimit publik-privat për të siguruar rritje gjithëpërfshirëse dhe përmirësim të cilësisë së jetës. Në veçanti për rajonet e mbetura pas, promovimi dhe shfrytëzimi i dijeve dhe aseteve vendore (p.sh. trashëgimia kulturore dhe natyrore) kanë potencialin t'i bëjnë zona me diversifikim ekonomik, duke hedhur themelet për zhvillimin e ekonomisë së dijes.

2. Në **rajonet periferike më pak të zhvilluara** politikat duhet të mbështesin përmirësimin e novacioneve ekzistuese, pasi këto rajone kanë më shumë mundësi për eksperimente dhe ndryshime rrënjësore, pasi ato janë më pak të varura nga sistemi (d.m.th. ekosistemet novatore që duhet të përshtaten me ndryshimet janë më pak të zhvilluara dhe rrjedhimisht përshtaten më lehtë). Kjo alternativë është më pak e rrezikshme dhe e kushtueshme sesa përpjekjet për të krijuar dije të reja dhe ka më shumë gjasa të ketë sukses kur aktorët ekonomikë novatorë dhe me performancë të lartë nuk janë shumë të përqendruar në një rajon.

3. Në **rajonet me novacion imitues**, aktiviteti i fortë sipërmarrës mund të nxisë përvetësimin e dijeve nga jashtë rajonit dhe shndërrimin e tyre në aktivitete novatore vendore. Kërkimi dhe marrja e dijeve të jashtme duhet të mbështetet nëpërmjet stimuljeve për bizneset vendore (ekzistuese ose të reja) për të zhvilluar projekte plotësuese me korporatat shumëkombëshe ose për të zhvilluar marrëdhënie të specializuara nënkontraktimi me to.

Zhvillimi i kapaciteteve për novacion dhe kërkim shkencor në territoret tona mesdhetare është domosdoshmëria e parë për forcimin dhe konsolidimin e një shoqërie të dijes në rajonin tonë, në dobi të administratave, universiteteve, kompanive, qytetarëve...

Megjithatë, Programi duhet të trajtojë edhe plot çështje të tjera, veçanërisht në lidhje me pasojat e ndryshimeve klimatike.

Edhe në raportet ESPON-it të përmendura më lart, gjejmë se:

Ndryshimet klimatike kanë ndikime të ndryshme në rajone të ndryshme biogeografike të Evropës, siç tregohet në raportin e fundit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA 2017). Ndikimet e konstatuara nga ndryshimet e mjedisit janë: thatësira, valët e të nxehtit, përmytjet e shpejta dhe përmytjet bregdetare, ndryshime të shumta në ekosisteme (p.sh. migrimi i specieve drejt veriut) dhe ndryshime në sistemin ushqimor (p.sh. ndryshimet në rendimentet e të korrave) dhe sistemin energjetik (p.sh. rritja e kërkesës për energji për ftohje). Këto ndikime të ndryshme territoriale varen nga pozicioni gjeografik dhe karakteristikat territoriale të rajoneve evropiane, mundësitë specifike të rajonit për të realizuar përshtatjen dhe zbutjen, dhe kapacitetet e ndryshme për t'iu përgjigjur kushteve klimatike në ndryshim.

Ndryshimet klimatike do të kenë ndikimin më të lartë mjedisor në rajonet veriore dhe jugore të Evropë. Zonat me rrezik përmytjesh përqendrohen përgjatë Mesdheut.

Kapaciteti për t'iu përgjigjur kushteve klimatike të ndryshueshme nëpërmjet strategjive të zbutjes, përshtatjes dhe rezistencës ndryshon shumë nëpër të gjithë Evropën. Dallimi është i dukshëm në kontrastin midis kapacitetit të madh përshtatë që ka Evropa veriore dhe cenueshmërisë së lartë të rajoneve në Evropën jugore dhe juglindore, si dhe në Skandinavinë Veriore dhe Finlandë. Territorët e cenueshme në Evropën jugore dhe juglindore që mund të kenë nevojë për orientime në **hartimin e strategjive të përshtatjes, zbutjes dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të mbështeten me transferim të praktikave të mira [...], ndërsa vetë kjo të mbështetet me një bazë të dbënasb të përbashkët që përmban strategji të suksesshme përshtatjeje, zbutjeje dhe rezistence si dhe studime krabasuese që synojnë të evidentojnë dallimet (p.sh. specifikat gjeografike) dhe ngjashmëritë (p.sh. masat e transferueshme) ndërmjet territoreve.**

Pasojat e ndryshimeve klimatike në Mesdhe prekin të gjitha territoret në kufi me basenin dhe më gjerë, duke e bërë këtë problematikën më unifikuese dhe prioritare për çdo vendimmarrës. Asnjë program i bashkëpunimit territorial evropian, asnjë program rajonal, asnjë program tematik për kërkimin shkencor, transportin, kulturën etj. dhe asnjë strategji nuk duhet ta anashkalojë këtë problematikë.

Për më tepër, ndikimet negative të ndotjes të shëndeti, mjedisi detar, biodiversiteti dhe ndryshimet klimatike përbëjnë shqetësim kryesor për Mesdheun, veçanërisht ndotja e anijeve, e cila është burim kryesor i ndotjes në detin Mesdhe.

Sfida e nevojshme e Paktit të Gjellbër do të shoqërohet me përpjekje për monitorim, koordinim, bashkëpunim teknik dhe politik tërësisht transversal për çdo zonë dhe vend që ndërhyr në basenin e Mesdheut.

Siç theksoi Komisioneri për Fqinjësinë, Olivér Várhelyi, gjatë një fjalimi në Forumin e Unionit për Mesdheun (UfM) për Tregtinë dhe Investimet më 12 nëntor 2020, është e dëshirueshme që të dy brigjet e Mesdheut të qëndrojnë të bashkuara dhe të tregojnë *“krijueshmëri për të forcuar rezistencën tonë dhe për të ndërtuar begatinë, veçanërisht në lidhje me riashtësimin nga pandemia COVID-19”*.

E njëjta ide është përsëritur nga Josep Borrell, Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian për politikën e punëve të jashtme dhe sigurisë më 3 mars 2021: *“Sfidat ekonomike, sociale, ekologjike dhe të sigurisë me të cilat përballlet rajoni janë thelluar nga pandemia COVID-19. Trajtimi i të gjithave bashkë është sfidë kyçe për politikën tonë të jashtme”*.

Le ta citojmë ESPON-in për herë të fundit: *“Kornizat e strukturuar politike siç janë strategjitë makrorajonale dhe për basenet detare, mund të krijojnë sinergji të koordinuara transnacionale, ndërrajonale dhe ndërkuftare. Kjo mund të mobilizojë rrjetet ekzistuese ose të gjenerojë rrjete të reja të specializuara, që promovojnë partneritetet e zgjuara specializuara bazuar në ekspertizën e secilit rajon/vend. Kjo mund të prodhojë efekt shumëfishues, të mobilizojë ekonominë e shkallës dhe të krijojë aktivitete të qëndrueshme me efekt kaskadë”*.

Me bindjen e thellë për këtë nevojë për bashkëpunim më të gjerë, Shtetet partnere të programit Interreg MED vendosën të ndërmarrin “qeverisje më të mirë” në periudhën 2014–2020 duke financuar një aks të dedikuar.

Dy shtyllat e projekteve territoriale të programit Euro-MED, **novacioni** dhe **mjedisi**, kërkojnë patjetër gjatë zbatimit një kornizë që mbështet çdo operacion për shkëmbime sa më efektive, me qëllim që të arrijë të çdo palë e interesuar.

Si rrjedhojë, shtylla e tretë **qeverisja** (ISO1) gjen rolin e merituar në programimin 2021–2027 dhe plotëson kështu skemën.

Temat territoriale lidhen me nevojën që objektivi i përgjithshëm i programit të përputhet me domosdoshmërinë për ndikim më të madh të tij në zonë (“endogjen”) dhe në basenin e Mesdheut (“ekzogjen”), duke nënvizuar kështu detyrimin për bashkëpunim me të tjera programe, nisma, strategji dhe institucione.

E gjithë arkitektura e Interreg Euro-MED është ideuar që të maksimizojë ndikimin e vet: me tipologji të ndryshme projektesh (modulare dhe strategjike për eksperimentim dhe transferim në territore me nivele të ndryshme dhe për aktorë të ndryshëm; komunitete tematike dhe institucionale për kapitalizimin e rrjetit dhe për *mainstream* evropiane dhe kombëtare), të cilat do të jenë të mundura me qëllim mbulimin e misionëve të planifikuara.

Zgjedhjet dhe orientimet e programit dëshirojnë jo vetëm t'i përgjigjen kontekstit socio-ekonomik të krizës që vazhdon që nga viti 2008 dhe u rëndua me pandeminë COVID-19, por edhe të nxisin parimet e solidaritetit dhe përbashkimit të politikës së kohezionit të Bashkimit Evropian. Vendimet e shteteve partnere bazohen në rregullat e përqendrimit, synimit, thjeshtimit dhe fleksibilitetit të diktuar prej Rregulloreve.

Për më tepër, Programi Interreg Euro-MED do të duhet të trajtojë si karakteristikat “detare” (p.sh. mjedisi detar, zonat e mbrojtura detare, portet etj.), edhe komponentët “tokësorë” (zonat e brendshme, d.m.th. zonat rurale, malore, bregdetare dhe urbane); të gjitha këto janë të rëndësishme për zonën MED për sa u përket specifikave dhe popullsisë së interesuar.

Ky kompleksitet i zonës është i kombinuar mirë me përzgjedhjen e objektivave të politikave OP1, OP2 dhe ISO1, të cilat mund të përshtaten lehtësisht me territoret, duke na lejuar të fokusohemi në tematika *ad hoc* në zona veçanërisht strategjike si ishujt, portet urbane, zonat rurale dhe/ose malore.

Reflektimet në lidhje me kapacitetin tonë për t'u koordinuar më mirë - që nga hartimi i programit - me aktorët kryesorë në Mesdhe, kanë qenë gjithmonë prioritet për t'u vlerësuar veçanërisht

nëpërmjet proceseve të kapitalizimit dhe ndërlidhjes të planifikuara nga ISO1. Kjo vlen posaçërisht për nismat më poshtë:

- Nisma WestMed;
- strategjitë makrorajonale EUSALP dhe EUSAIR dhe programet e tyre mbështetëse Interreg Hapësira Alpine dhe ADRION si dhe çdo strategji e re makrorajonale që mund të hartohet në lidhje me Mesdheun;
- Politika e Fqinjësisë së Mesdheut e mbështetur nga Programi Interreg *Next-Med*;
- Unioni për partneritetet shumëpalëshe mesdhetare dhe specifikisht masat e tij për ujin, mjedisin dhe ekonominë Blu (deklarata ministrore 2/2/2021) dhe masat për energjinë dhe klimën;
- Nisma BLUEMED.

Në këto përpjekje, vlera e shtuar e bashkëpunimit më të fortë me programet ndërkufitare Interreg do të mbahet gjithmonë parasysht.

Kjo ishte edhe më e lehtë për t'u përfytyruar dhe konceptuar, pasi kemi grumbulluar tashmë përvojë solide gjatë periudhës së programimit 2014–2020. Në fakt, përmes platformës së qeverisjes Panoramed dhe Partnerëve të Asociuar, apo edhe përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë (kjo vlen për shembull për WestMed ose Unionin për Mesdheun), Interreg-MED 2012–2020 ka vendosur tashmë lidhje partneriteti me shumicën e strategjive, aktorëve dhe programeve të përmendura - dhe partneriteti do të zhvillohet më tej në 2021–2027.

Për shembull, Programi ndërmori veprime gjatë periudhës 2014–2020 për të vendosur bashkëpunim me autoritetet EUSAIR. Kontributi i programit në zbatimin e prioritetëve EUSAIR është parashikuar nëpërmjet sinergjive dhe koordinimit me programin Adrion.

Po kështu, koordinimi i aktiviteteve me nismën WestMed ka filluar që në periudhën 2014–2020, përmes projekteve tematike komunitare Rritja Blu me angazhimin e palëve të interesuara, veçanërisht nga drejtuesit e grupeve blu dhe organizatat kërkimore me pjesëmarrje të barabartë në program dhe grupet e punës së nismës. Nga ana tjetër, Programi po merr pjesë me status vëzhguesi edhe në këto grupe pune të cilët mund të përforcohen duke kontribuar si në diskutimet mbi politikën, ashtu edhe në planin e veprimit të Nismës me elemente bazuar në evidenca që ofrojnë projektet Euro-Med.

Programi ka nisur negociatat teknike me autoritetet drejtuese të ADRION dhe NEXT MED nga njëra anë dhe Itali–Francë Maritimo, Greqi–Qipro dhe Itali–Maltë Programet nga ana tjetër me qëllim që të mbulohen si anët transnacionale ashtu edhe ato ndërkufitare. Qëllimi i përgjithshëm është krijimi i një koordinimi të strukturuar dhe të vazhdueshëm ndërmjet programeve ETC që veprojnë në të njëjtën fushë bashkëpunimi; si fazë paraprake, standardi minimal i përbashkët i bashkëpunimit të përbashkët/të përbashkët do të bazohet në tema/tema të përmbajtjes së identifikuar të cilat do të përfitojnë nga veprimet e përbashkëta.

Nisur edhe nga udhëzimet e përcaktuara në dokumentin orientues të KE-së, Programi Euro-MED ka filluar bisedimet teknike me autoritetet menaxhuese të ADRION dhe NEXT MED nga njëra anë dhe me Programet Maritimo Itali–Francë, Greqi–Qipro dhe Itali–Maltë nga ana tjetër, me qëllim që të mbulojë si aspektin transnacional edhe atë ndërkufitar. Qëllimi i përgjithshëm është të vendoset koordinim i strukturuar dhe i vazhdueshëm ndërmjet programeve të bashkëpunimit territorial evropian që zbatohen në të njëjtën zonë bashkëpunimi; si fazë paraprake, do të përcaktohen standarde minimale të përbashkëta bashkëpunimi, të cilat do të bazohen në temat/çështjet e identifikuara të cilat do të përfitojnë nga masat e përbashkëta.

Modalitetet do të përcaktohen sipas kalendarit të zbatimit të programeve të ndryshme. Niveli i koordinimit (shumëpalësh apo dypalësh) mund të përcaktohet bazuar në:

- a) tematikat për bashkëpunimi të mundshëm (objektivat specifike);
- b) aktivitete të përbashkëta të mundshme (p.sh. aktivitete të përbashkëta rikuperimi sipas temave të synuara ose bazuar në shkallën e mundshme të integritetit, thirrje për projektpropozime që kapitalizojnë rezultatet e projekteve të tjera të financuara nën programe të ndryshme etj.);
- c) kalendarë dhe afate për zbatimin e objektivave të çdo programi;
- d) rregulla të përbashkëta menaxhimi që ka secili program, me qëllim që të lehtësohet sa më shumë komunikimi i thjeshtuar me përdoruesit (shpesh të njëjtat autoritete) dhe me shtetet;

c) modalitete të tjera që mund të lindin gjatë zbatimit të programeve, nëpërmjet çfarëdo procesi integruar që ende nuk është parashikuar apo debatuar, duke përfshirë ndër të tjera koordinimin për kontributin në SMR (strategji makrorajonale) dhe SBD (strategji për basenet detare).

Gjatë fazës së zbatimit të programit, monitorimi i rezultateve dhe produkteve do të sigurojë identifikimin e atyre rezultateve që lidhen me strategjitë makrorajonale dhe të baseneve detare dhe nismat përkatëse aktive në zonën e programit, duke mbështetur bashkëpunimin e vendosur. Strategjitë e komunikimit dhe të Amplifikimit të Rezultateve, si dhe Prioriteti i Qeverisjes së programit janë mjete shtesë që do të shfrytëzohen për nevojat e procesit të koordinimit.

Natyrisht, objektivi i këtij bashkëpunimi nuk është të kufizohet në disa programe, por të testojë dhe të konsolidojë procese të cilat më pas mund të shtrihen në çdo program tjetër që dëshiron të integrojë një dinamikë të tillë.

Po shikohet mundësia e ngritjes së një mekanizmi koordinues shumëprogramësh (bashkëpunim i përforcuar) me programe të tjera vullnetare Interreg në Mesdhe dhe testimit përmes një mekanizmi pilot mbi turizmin e qëndrueshëm dhe/ose çdo sektor tjetër relevant.

Eksperimentimi i mësipërm do të shërbejë njëkohësisht si kontribut për përcaktimin e prioriteteve në strategjitë makrorajonale dhe/ose baseneve detare në Mesdhe.

Gjatë fazës së zbatimit mund të konceptohen mekanizma shtesë shumëprogramësh.

Përveç pajtueshmërisë me dispozitat e rregullores Interreg (BE) 2021/1059 (neni 17(3)(b)(4)) dhe neni 17(3)(e)(i) në lidhje me strategjitë makrorajonale (EUSAIR dhe EUSALP) dhe nismën e basenit detar (WestMed), Programi synon të kontribuojë ose të marrë parasysh – nëpërmjet misionëve të veta - një numër të madh strategjish dhe politikash evropiane, si dhe politika, strategji dhe nisma mesdhetare, veçanërisht (ndër të tjera, listë joshteruese):

- Pakti i Gjellbër i BE-së
- E drejta Evropiane për Klimën
- Strategjia e Përshtatjes e BE-së
- Strategjia për Rritjen Blu
- Strategjia afatmesme (2017–2020_ drejt qëndrueshmërisë së Peshkimit në Mesdhe dhe Detin e Zi

- Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun – OKB – Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (GFCM-UN FAO)

- Pakti Evropian për Klimën
- Strategjia e BE-së për BE-në
- Strategjia e BE-së për Planifikimin e Hapësirës Detare
- Plani i Veprimit për Zero Ndotje
- Plani i Veprimit për Ekonominë Qarkulluese
- Plani i Veprimit Rural i BE-së, prezantuar në Vizionin afatgjatë për Zonat Rurale të BE-së (qershor 2021)

- Direktiva Evropiane për Habitatet

- Direktiva Kuadër për Ujin 2000/60/KE, veçanërisht rregulloret për “Ujërat kalimtare” dhe “Ujërat bregdetare”

- RescEU
- Strategjia e BE-së për Pyjet
- Strategjia Industriale Evropiane
- Strategjia për Tekstilet
- Vala e rinovimit
- Strategjia e BE-së për Energjinë e Rinovueshme në Det të Hapur
- Strategjia e BE-së për Integrimin e Sistemeve të Energjisë
- Strategjia për Lëvizshmërinë e Qëndrueshme dhe Inteligjente
- Nisma *Blue-Med* - Kërkim shkencor dhe novacion për vende pune dhe rritje blu në Mesdhe
- Komunikata e BE-së për Ekonominë Blu të Qëndrueshme
- Nisma *Switchmed* për ekonominë qarkulluese në Mesdhe

- Rezolutë e Parlamentit Evropian e 4 shkurtit 2016 për situatën e veçantë në ishuj (2015/3014(RSP))
 - Unioni për Mesdheun, deklarata ministrore për ekonominë blu dhe për mjedisin;
 - Partneriteti i rinovuar me Fqinjësinë jugore – Agjenda e re për Mesdheun – Programet e Aksioneve Prioritare (PAP) të UNEP-MAP dhe veçanërisht: Qendra e Aktiviteteve Rajonale *Plan Bleu* (PB/RAC), Qendra e Aktiviteteve Rajonale të programeve të Aksioneve Prioritare; (PAP/RAC), Qendra e Aktiviteteve Rajonale të Zonave me Mbrojtje të Veçantë (SPA/RAC), Qendra e Aktiviteteve Rajonale për Konsumin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm (SCP/RAC) me seli në Barcelonë, Spanjë;
 - Direktiva Kuadër për Strategjinë Detare, miratuar më 17 qershor 2008;
 - Strategjia e BE-së për Turizëm të Qëndrueshëm (P9 TA(2021)0109);
 - Direktiva për Cilësinë e Ajrit në Ambient;
 - Direktiva për Tavanin Kombëtar të Shkarkimeve;
 - Direktiva për Impiantet Portuale të Pritjes.
- Gjithashtu, konventa ndërkombëtare, si:
- Konventa e Barcelonës dhe protokollet e saj, p.sh. Protokolli për Menaxhimin e Integruar të Zonave Bregdetare (MIZB)
 - Konventa e Ramsarit
 - Konventa për Diversitetin Biologjik
 - Konventa Alpine dhe protokollet e saj
 - Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet (MARPOL)
- Programe të BE-së dhe të Bashkëpunimit Territorial Evropian, si për shembull:
- Horizon 2020;
 - Life;
 - Programi “Evropa Digjitale”;
 - Programet transnacionale Interreg në zonë: Adrion, Hapësira Alpine, Evropa Jugperëndimore,

Next;

- Programe ndërkufitare Interreg në zonë: Greqi-Qipro, Itali-Francë detare...
- Programet ndërrajonale Interreg: Interreg Evropë, Espon, Interact;
- Mekanizmi i rikuperimit dhe rezistencës;
- Plane dhe programe ndërkombëtare që kërkohen nga legjislacioni i BE-së, si për shembull:
- programet kombëtare të kontrollit të ndotjes së ajrit;
- planet e cilësisë së ajrit;
- planet kombëtare të rikuperimit dhe rezistencës.

Roli i pikave kombëtare të kontaktit të programit Interreg Euro-MED është thelbësor për të garantuar komplementaritetin dhe për të shfrytëzuar sinergjitë mes fondeve. Mekanizma bashkëpunimi do të vendohen përmes rrjetit PKK, veçanërisht me organet koordinuese nëpër secilin vend.

Në fund, Programi përmes veprimeve të veta do të kontribuojë edhe në Agjendën territoriale 2020 për të dy komponentët, Evropë e Drejtë dhe Evropë e Gjellbër, duke financuar projekte me qasje bazuar në vend, veçanërisht:

- Projekte që synojnë të forcojnë kohezionin territorial ndërmjet kufijve;
- Projekte që synojnë të forcojnë dimensionin territorial të politikave sektoriale;
- Projekte që synojnë të promovojnë qasje të integruar dhe shumënivëlshë.

Respektimi i parimeve horizontale

Sipas **nenit 9 të rregullores për dispozitat e përbashkëta (CPR [BE] 2021/1060)**, Programi do të reflektojë konsideratat e parimeve horizontale gjatë fazave të përgatitjes, zbatimit, raportimit dhe vlerësimit, përkatësisht: respektimin e të drejtave themelore¹³, promovimin e barazisë gjinore, parandalimin e diskriminimit përfshirë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara,

¹³ Në përputhje me Kartën e të Drejtave të Njeriut të BE-së - <https://eur-lex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?uri=celex%3A12012P%2FTXT>

promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm.¹⁴ Programi do të ngrejë një mekanizëm monitorimi me qëllim raportimin dhe ndjekjen e zhvillimeve lidhur me parimet horizontale. Progresi i përgjithshëm do t'i raportohet KE-së periodikisht, duke vlerësuar të gjitha operacionet. Në fund, vlerësimi i programit ka një pjesë të dedikuar për vlerësimin e masave në këtë drejtim.

Lidhur me koherencën e ndërveprimit ndërmjet objektivave specifike të programit dhe OZHQ-ve të OKB-së, Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (RVSM) parashikon ndërveprim dhe kontribut neutral për objektivat: 3) Shëndet dhe mirëqenie të mirë; 6) Ujë të pastër dhe kanalizime, 7) Energji të përbalueshme dhe të pastër; 9) Industria, novacioni dhe infrastruktura, 11) Qytete dhe komunitete të qëndrueshme; 12) Konsum dhe prodhim të përgjegjshëm; 13) Veprimi për klimën; 14) Jeta nën ujë, 15) Jeta në tokë; dhe 17) Partneriteti. Gjatë zbatimit, projektet tematike komunitare në kuadrin e prioritetit “Qeverisja” do të monitorojnë kontributin e projekteve në OQZH-të në lidhje me misionet e programit.

Është realizuar një analizë për respektimin e parimit Mos Bëni Dëm të Konsiderueshëm (DNSH). Në përgjithësi, nuk priten ndikime negative të konsiderueshme për shkak të natyrës dhe objektivit të objektivave specifike dhe masave përkatëse. Më shumë informacion jepet në seksionin 2.

Siç raportohet në Raportin e Vlerësimit Strategjik të Mjedisit, ato pak efekte të mundshme negative nga zbatimi i projekteve, kryesisht për shkak të konsumit të burimeve (energji, prodhim mbetjesh dhe materiale), mund të shmangen lehtësisht nëse merren masa adekuate parandaluese dhe shoqëruese gjatë zbatimit. Për këtë arsye, të gjitha projektet duhet të minimizojnë gjurmën e tyre të karbonit dhe ta kompensojnë sipas rastit, duke përdorur një metodologji dhe një instrument të përgatitur gjatë periudhës 2014–2020.

Objektivat për klimën dhe biodiversitetin merren parasysh në planifikimin e fondeve në secilën fushë të ndërhyrjes, duke aplikuar koeficientet e konfirmuar; ato do të monitorohen gjatë programimit dhe raportimit të shpenzimeve të operacioneve.

Kontributi në *Nismën e re Bauhaus*: komunikimi mbi vlerat themelore të qëndrueshmërisë, estetikës dhe përfshirjes parashikohen gjatë seminareve me aplikantët.

Kohezioni elektronik

Sistemi i përbashkët i monitorimit elektronik (JEMS) është zhvilluar nga *Interact*, përmes të cilit bëhet shkëmbimi i të dhënave elektronike ndërmjet përfituesve dhe të gjitha autoriteteve të programit gjatë të gjithë ciklit të operacioneve dhe Programit, në përputhje me shtojcën IV të rregullores për dispozitat e përbashkëta.

Sistemi do të jetë plotësisht funksional në momentin e shpalljes së programit dhe do të zvogëlojë barrën administrative të përfituesve që marrin pjesë në disa programe bashkëpunimi të cilët do ta përdorin sistemin.

Përdorimi strategjik i prokurimit publik

Gjatë zbatimit të programit, Autoriteti Menaxhues do të nxitë përdorimin strategjik të prokurimit publik në mbështetje të objektivave të politikës (edhe përpjekjet për profesionalizim, që të ngushtohen boshllëqet në kapacitete). Përfituesit duhet të inkurajohen të përdorin më shumë kriteret që lidhen me cilësinë dhe kostot e ciklit të jetës. Kur është e mundur, në procedurat e prokurimit publik duhet të përfshihen konsiderata mjedisore (p.sh. kriteret e prokurimit publik të gjelbër) dhe ato sociale si dhe stimuj për novacionin.

Kohëzgjatja e operacioneve

Programi nuk ka të bëjë me mbështetjen e biznesit në formën e granteve. Asnjë kohë e reduktuar për qëndrueshmëri nuk do të zbatohet nga programi, sipas nenit 65 CPR.

Pasi prezantuar sfidat e përbashkëta dhe arkitekturën e përgjithshme të programit, tani le të bëjmë një hap pas që të analizojmë dhe të kuptojmë më thellë trashëgiminë e programit 2014–202 (ideuar mbi bazën e programit 2007–2013) dhe argumentet që çuan në zgjedhje të caktuara.

Programi nuk ka të bëjë me mbështetjen e biznesit në formën e granteve. Gjithashtu, nuk përcakton një afat për kohëzgjatjen, në zbatim të nenit 65 të rregullores.

¹⁴ Në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, Marrëveshjen e Parisit dhe parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm” dhe në respektim të *acquis* mjedisor të BE-së.

Mësimet e nxjerra

Periudha e programimit 2014–2020 shënoi zhvendosjen drejt projekteve të orientuara drejt rezultateve si dhe përqendrimit tematik, me përkushtimin që të mbështetet Strategjia 2020 e BE-së. Programi Interreg MED ka përfshirë të dy këto elemente në parimet udhëheqëse dhe në logjikën e vet të ndërhyrjes. Edhe termat e referencës, në masën që ishte e mundur, e kanë ngushtuar fokusin nga një thirrje për projektpropozime në tjetrën.

Pikërisht përmes forcimit të grupimeve të novacionit, aksi 1 dëshiron të promovojë kapacitetet novatore në Mesdhe me qëllim që të zhvillojnë rritje inteligjente dhe të qëndrueshme në sektorët e rritjes blu, rritjes së gjelbër, novacionit social dhe industrive kulturore. Pra, objektivi qëndron te temat/çështjet e trajtuara, por me fokus te grupimet. Projektet e miratuara kanë fuqizuar me sukses aktorët e spirales së katërfishtë përmes ofrimit të instrumenteve dhe shërbimeve mbështetëse, si edhe bashkëpunimit më të fuqishëm transnacional mes tyre. Megjithatë, kushtet për përfshirjen e drejtpërdrejtë të NVM-ve në projektet e bashkëpunimit transnacional ende nuk janë pjekur në këtë periudhë të parë. Në të ardhmen, kushtet e përshtatshme si harmonizimi administrativ i rregullave ndërmjet programeve të ndryshme të BE-së dhe i rregullave të ndihmës shtetërore bashkë me interesin tematik për pjesëmarrje do të lehtësonin përfshirjen e NVM-ve.

Është bërë një zgjedhje që të kemi aksin 2 për ekonominë e karbonit të ulët (lëvizshmëria me energji dhe karbon të ulët) që do të konsolidohet mbi përvojën e gjerë të fituar gjatë 2007–2013. Objektivat specifike shumë të fokusuar japin mundësinë që burimet të maksimizohen në drejtim të forcimit të ekonomisë me karbon të ulët në zonën MED. Pa dyshim që në OS 2.1, projektet kanë kontribuar me sukses në rritjen e kapaciteteve për praktika energjetike më efikase në godinat publike. Në komplementaritet me të, OS 2.2 ka kontribuar në shtimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në zonat e ndjeshme MED, specifikisht në ishuj dhe zona rurale. Në fund, OS 2.2 ka mbështetur zhvillimin e masave të buta drejt lëvizshmërisë urbane me karbon të ulët, ama, vlera e shtuar transnacionale dhe potenciali i transferueshmërisë së këtyre masave ka mbetur i kufizuar. Rezultate janë arritur përmes zhvillimit të instrumenteve dhe shërbimeve mbështetëse, metodologjive dhe planeve të përbashkëta. Tashmë ka ardhur koha të shfrytëzohen dijet dhe ekspertiza ekzistuese, në mënyrë që përvoja dhe rezultatet e përfutuara të shtrihen/replikohen edhe në zonat e tjera.

Theksi kryesor i është vënë aksit 3 për mbrojtjen e burimeve natyrore të zonës MED, përmes dy perspektivave komplementare. OS 3.1, me një larmi të madhe projektesh që kanë punuar drejt menaxhimit dhe politikave të integruara të turizmit, për të garantuar që ky sektor ekonomik kryesor për Mesdheun të kontribuojë në ruajtjen e qëndrueshme të mjedisit. Përveç kësaj, aktorët kryesorë që punojnë në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit (OS 3.2) kanë bashkuar forcat për të arritur objektivin e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore të qëndrueshme në Mesdhe, nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të zonave të mbrojtura si dhe ndryshimeve në sjellje dhe praktika. Por mënyra se si qeverisen/administrohen zonat e mbrojtura në vende të ndryshme ndryshon shumë, gjë që e vështirëson zhvillimin e planeve të përbashkëta të qeverisjes.

Në fund, procesi i qeverisjes novatore të përcaktuar në aksin 4 kërkoi kohë që të fillonte, por rezultoi që përpjekjet po shpërblehen dhe proceset qeverisëse po shfaqen, përfshirë mekanizmat koordinues brenda arkitekturës MED dhe më tej, me qëllimin që të gjitha palët e interesuara të punojnë bashkërisht në drejtimet që konvergojnë.

Më poshtë jepen shkurtimisht dobësitë kryesore të evidentuara për secilin aks.

Aksi 1:

a) zbatimi i politikave politike apo planeve të veprimit për novacionin nuk ka ecur sipas pritshmërive, ndoshta për shkak të natyrave të ndryshme të masave të zhvilluara apo përfshirjes relativisht të ulët të vendimmarrësve në skemat e partneritetit, ose mungesa e aktiviteteve të kapitalizimit;

b) aktivitetet për forcimin e kapaciteteve dhe fuqizimin e autoriteteve publike dhe aktorëve sociale rezultuan të pakta, megjithëse rezultuan të suksesshme për sektorin privat;

c) hapja e objektivit të novacionit në tri tema, si dhe ekzistenca e nëntemave të shumta nën secilën temë bëjnë që pak projekte të zbatojnë një gamë të madhe çështjesh dhe masash, çka me shumë gjasa ka kufizuar përgjigjen globale dhe ndikimin në zonën e programit;

d) pjesëmarrja e kufizuar e NVM-ve tematike si partnerë projekti dëshmon nevojën për t'iu garantuar atyre kushte të favorshme për pjesëmarrje, kur NVM-të thërrihen të marrë pjesë në projekte.

Aksi 2:

a) transferimi aktual i rezultatit të arritur ishte më i ulët sesa pritshmëritë në thirrjen e parë për projektpropozime, ndoshta sepse transferimi kërkon shumë kohë. Projektet e dedikuara për transferimin dhe integrimin u shpallën në fund të periudhës së programimit, por ishin të kufizuara te produktet e identifikuar të projekteve të finalizuar me potencial të lartë transferueshmërie, me qëllim që të baraspeshohet kjo gjetje dhe të insistohet me kapacitetet transferuese të rezultateve;

b) projektet e miratuara fokusoheshin më tepër te instrumentet e zhvillimit dhe testimi, sesa te ndryshimi i politikave; por, meqë Programi është për bashkëpunimin transnacional dhe kapitalizimin e rezultateve, projektet modulare duhet të garantojnë ndikim jo vetëm te politikat, por edhe mekanizmat për përballimin e sfidave të shoqërisë në kalimin drejt reduktimit të energjisë dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;

c) projektet pilot duan mjaft kohë që të hartohen dhe të zbatohen; për të tepër, zbatimi duhet të zgjasë për një kohë të mjaftueshme që të mundësojë mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave;

d) përfshirja e popullatës ka qenë e kufizuar.

Aksi 3:

a) vështirësi në integrimin e NVM-ve dhe ofruesve të shërbimeve në projektet që merren me mbrojtjen mjedisore. Mekanizmat që synojnë baraspeshën mes aktiviteteve njerëzore/ekonomike dhe mbrojtjes mjedisore nuk janë të zhvilluara mjaftueshëm;

b) pavarësisht realizimit të planeve të përbashkëta të qeverisjes, mbetet sfida përmirësimi i koordinimit të politikave për ruajtjen e burimeve natyrore në zonën e Mesdheut;

c) menaxhimi i zonave të mbrojtura bëhet në nivele të ndryshme politikash, si rrjedhojë, procesi i miratimit të planeve të menaxhimit në secilin vend mesdhetar ndryshon në aspektin legjislativ dhe kohor.

d) qëllimi për të përfshirë si partnerë projekti, autoritet menaxhuese të zonave të mbrojtura nuk ka qenë plotësisht i suksesshëm, sepse shumica e këtyre organeve nuk kanë struktura dhe burime njerëzore të përshtatshme për të mbajtur barrën administrative dhe financiare të projekteve të BE-së. Duket se kanë qenë më efektive projektet që kanë përfshirë zonat e mbrojtura jo drejtpërdrejt si partnerë, por si përfitues për zbatimin e planeve të veprimit.

Aksi 4:

a) mungesa e korrespondimit tematik mes temave të aksi 4 dhe komuniteteve tematike pengoi zbatimin e plotë të strategjisë 2014–2020, në drejtim të rritjes së ndikimit të aksit tematik, duke përmirësuar çështjet e qeverisjes;

b) pati mungesë sinkronizimi midis rezultateve të para të formalizuara të komuniteteve tematike dhe fillimit të punës analizuese të PANORAMED (platforma e qeverisjes), duke kufizuar bashkëpunimin midis aksit tematik dhe aksit të qeverisjes.

Megjithatë, sinergjitë brenda dhe ndërmjet 8 komuniteteve tematike dhe aksit të qeverisjes kanë vënë theksin në kontributin e tyre në ndryshimet klimatike; kjo është mbetet sfida më e madhe për t'u fokusuar në të ardhmen. Mësimet e nxjerra gjatë periudhës 2014–2020 kanë treguar se, për të maksimizuar ndikimin e programit në zonën MED, përqendrimi tematik duhet të shkojë më tej në periudhën e programimit 2021–2027, ku të gjithë objektivat duhet të konvergojnë drejt qëllimeve klimatike dhe mjedisore dhe të përqendrohen në vlerën e shtuar të bashkëpunimit transnacional.

Gjithashtu, vlerësimet operationale dhe të ndikimit tregojnë se, nëse vazhdohet me qasjen e komunitetit tematik, duhet të vendosen masa koordinuese të qarta dhe efektive ndërmjet Sekretariatit të Përbashkët dhe projekteve që në fillim të programit. Specializimi tematik, autorësia dhe afërsia e palëve të interesuara që rrjedhin nga kjo qasje duhet të ruhet, por me një arkitekturë më të qartë të projektit.

Duhet të forcohet edhe roli i pikave kombëtare të kontaktit (PKK) në mbështetjen e integritetit të projekteve.

Komunitetet tematike si një hap ndërmjetës mes qeverisjes së programit dhe territoreve maksimizojnë instrumentet që ofron Interreg MED.¹⁵

Bazuar në përvojën e fituar gjatë periudhës së programimit 2014–2020, Interreg Euro-Med mund të fillojë kapitalizimin që nga fillimi i Programit.

Kjo do të jetë edhe më e rëndësishme dhe e nevojshme, sepse vlerësimi i ndikimit tregoi se ekziston konsensus i gjerë mbi nevojën që Programi Interreg MED të përmirësojë vizibilitetin dhe rezultat e produktet në nivel transnacional, në nivel të BE-së, dukshmërinë e tij dhe rezultatet dhe rezultatet e projekteve në nivel ndërkombëtar, në nivel të BE-së, por edhe në lidhje me politikëbërësit.

Sugjerohet fokus më i gjerë në temat që mund të sjellin ndryshime më efektive. Temat e cilësuara relevante janë qeverisja dhe pakti i gjelbër (ekonomia qarkulluese, qasja gjithëpërfshirëse, nismat pilot të transferueshme për novacionin...). Gjithashtu, vlerësohet se ndikimi Programit Interreg MED do të forcohet nëse përcaktohen tregues më të përshtatshëm dhe penalitete për performancë të dobët.

Arkitektura e periudhës së programimit 2014–2020 përshkruhet si eksperiment unik që duhet zhvilluar më tej dhe prej saj të nxirren mësim për periudhën e programimit vijuese. Pavarësisht se ekziston mendimi i përgjithshëm pozitiv për përvojën e përfutur nga ngritja e kësaj arkitekture, janë ngritur disa problematika në lidhje me kompleksitetin dhe nevojën për thjeshtimin e saj.¹⁶

Premisat

Në tërësi, rajoni i Mesdheut ka PBB për frymë, punësim dhe novacion poshtë mesatares së BE-së. Potenciali për novacion dhe zhvillim është i konsiderueshëm nisur nga ekzistenca e grupimeve të biznesit dhe laboratorëve kërkimorë të fokusuar në rritjen e gjelbër dhe blu (shërbimet mjedisore, bioteknologjitë, turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi i burimeve natyrore, energjia e pastër, shkencat detare, peshkimi...). Megjithatë, këto grupime janë kryesisht kombëtare dhe mund të arrihet përparim duke promovuar ndërveprimet në nivel transnacional.

Edhe pse potenciali kërkimor dhe novator shfaq pabarazi të konsiderueshme mes territoreve, rajoni i Mesdheut ka disa fusha specializimi me premisa interesante për zhvillimin e qasjeve të bashkëpunimit transnacional. Analiza e strategjive të specializimit inteligjent në vendet në fjalë tregon se prioritetet e aktorëve të novacionit fokusohen në këto fusha:

- a) novacioni i qëndrueshëm;
- b) teknologjitë ndihmuese;
- c) industritë kulturore dhe krijuese;
- d) shëndeti publik dhe siguria;
- e) teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Për sa i përket infrastrukturës rrugore, zonat rurale janë rreth 80% nën mesataren e BE-së. Rajonet malore si dhe ishujt janë në 70% dhe 80% të kësaj mesatareje dhe niveli pritët të mbetet i ulët deri në vitin 2030 në ishujt dhe rajone më pak të populluara.

Disa rajone ishullore varen nga importet e produkteve bazë si ushqimet dhe energjia dhe të shumicës së mallrave të tjera të konsumit. Transporti detar është mjeti kryesor i transportit për këto importe. Kostot prirjen të jenë më të larta në ishujt sesa në rajonet e brendshme, për shkak të këtyre kufizimeve. Megjithatë, disa mundësi po shfaqen nga këto kufizime, të cilat mund të kërkojnë më shumë promovim të produkteve dhe zinxhirëve të vlerës vendorë dhe më të qëndrueshëm (ref. Strategjia “Nga ferma te tavolina”, si dhe Plani i Veprimtimit për Ekonominë Qarkulluese).

Edhe transporti ajror luan rol të madh në lidhjen e rajoneve mesdhetare dhe është veçanërisht i rëndësishëm për zonat e izoluara dhe ishujt.

Gjithashtu, duhet theksuar se portet kryesore të Mesdheut kanë lidhje tokësore relativisht të mira dhe mund t'i shërbejnë brenda një rrezeje prej katër orësh (udhëtim rrugor) një popullsie prej 5–20 milionë banorë secila.

¹⁵ Vlerësim operacional, raporti përfundimtar, 2020.

¹⁶ Vlerësimi i ndikimit, raport i ndërmjetëm, 2020.

Në këtë kontekst, në luftën për reduktimin e ndotjes nga trafiku detar me dendësi të lartë, prioritet është kontributi në realizimin e ambicies “zero ndotje” në portet detare.

Për sa i përket lëvizshmërisë urbane, dendësia është e favorshme për zhvillimin e sistemeve të transportit të qëndrueshëm me një numër potencialisht të lartë përdoruesish. Jetesa në qytete ofron akses në shumë shërbime, duke përdorur mënyra transporti që harxhojnë më pak energji. Në rajonin e Mesdheut, këto nisma mund të jenë veçanërisht të rëndësishme në qytetet që preken nga ndotja e trafikut detar ose fluksi i turistëve (sezonaliteti). Përveç kësaj, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Paktit të Gjellbër Evropian, portet detare duhet të shihen si prioritet kyç në arritjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike. Furnizimi me energji në breg (OPS) shihet tashmë si pjesë e rëndësishme e kalimit në epokën e re me “zero emetime” dhe digjitalizimit të zinxhirit të furnizimit.

Nga ana tjetër, është më e vështirë të zhvillohen sisteme të qëndrueshme transporti në shumicën e zonave të largëta ku niveli i varësisë nga makina është shumë më i lartë.

Në prodhimin industrial, NVM-të (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) janë mbizotëruese në ekonomi. Norma e krijimit të bizneseve është 9.2%, pak më poshtë mesatares evropiane prej 10.3%. Por, kjo normë ndryshon ndjeshëm nga një vend në tjetrin; për shembull, në vitin 2017 ishte 3% në Qipro, 7.2% në Spanjë dhe Itali, 11.3% në Portugali dhe Slloveni, si dhe 15.4% në Francë. NVM-të janë të pranishme në sektorë me intensitet teknologjik të ulët dhe të mesëm (agroushqim, pjesë makinerish, pajisje zyre, optikë, metalurgji etj.) dhe punësojnë një numër të personash me kualifikim të ulët.¹⁷

Rajoni i Mesdheut njihet gjerësisht edhe si një nga zonat më të ndjeshme mjedisore, politike, socio-ekonomike dhe kulturore në botë.

Ekosistemet unike natyrore janë dëmtuar rëndë nga aktiviteti njerëzor. Burimet e çmuara janë nën kërcënim, pasi mungesa e ujit është përkeqësuar nga ngrohja globale, avancimi urban, turizmi masiv dhe ndotja nga aktivitetet njerëzore.

Potenciali për prodhimin e energjisë së rinovueshme është i rëndësishëm në rajonet e Mesdheut, por niveli i varësisë nga energjia mbetet relativisht i lartë.

Vende të tilla, si: Kroacia, Italia, Portugalia, Spanja dhe Sllovenia janë ndjeshëm mbi mesataren evropiane: mesatarja e energjive të rinovueshme në konsumin bruto të energjisë përfundimtare (biomasa, hidroenergji, era dhe dielli) në BE-27 është rreth 18%, por varion nga pothuaj 30% në Portugali dhe Kroaci, në rreth 22% në Slloveni, 15–20% në Greqi, Itali, Spanjë dhe Francë, 14% në Qipro dhe 8% në Maltë (në këtë fushë, ishujt janë objektiv specifik dhe shënjestrohen drejtpërdrejt nga nisma e fundit “Energji e pastër për ishujt e BE-së” e shpallur nga Komisioni Evropian).¹⁸

Për më tepër, në rajonin e Mesdheut:

- Uji është një nga burimet më të rëndësishme ekonomike dhe mjedisore, por kërcënohet nga ndryshimet klimatike (thatësira) dhe aktivitetet njerëzore (ndotja);

- Ligatinat, të cilat përfaqësojnë një hallkë të rëndësishme në ciklin e ujit, gjithashtu po cenohen ndjeshëm nga aktivitetet njerëzore;

- Mbetjet janë një nga presionet kryesore ndaj mjedisit (ndotja e detit vjen kryesisht nga toka): në këtë rast, një zgjidhje novatore për këtë problem mund të jetë ekonomia qarkulluese, e cila është veçanërisht e rëndësishme për ishujt që përballen me burime të pakta ose më të shtrenjta dhe me më shumë kufizime për menaxhimin e mbetjeve;

- Ndryshimet klimatike pritet të rrisin shfaqjen e rreziqeve natyrore në dekadat e ardhshme (më shumë nxehtësi ekstreme, më pak shira dhe rrjedha lumenjsh, stuhi të forta, rreziqe më të larta të thatësisë dhe shkretimit, rritje të rrezikut të humbjes së biodiversitetit, zjarreve në pyje dhe përmblyetjeve);

- Rritja e popullsisë do të kërkojë rritje të vaditjes së tokave të kultivuara nga 4% në 22% (ky zhvillim do të jetë në konflikt me përdorime të tjera: uji i pijshëm, turizmi, industria);

- Zonat bregdetare kanë pasur urbanizim të dendur; trafiku detar është shumë i rëndësishëm dhe në rritje: si rrjedhojë, deti Mesdhe po përballlet me probleme të mbipopullimit, ndotjes,

¹⁷ Diagnoza territoriale dhe analiza SWOT 2021–2027, raporti përfundimtar, mars 2020.

¹⁸ Diagnoza territoriale dhe analiza SWOT 2021–2027, raporti përfundimtar, mars 2020.

mbishfrytëzimit, erozionit dhe ekziston kërcënim i vazhdueshëm i zjarreve në pyje dhe mungesës kronike të ujit.

Nisur nga sa më lart, do të ishte mirë që në nivel transnacional të forcohen kornizat ekzistuese dhe rrjetëzimi i BE-së të fokusohet në çështje specifike të Mesdheut si ekonomia blu, mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, duke pasur parasysh specifikat që kanë zonat detare, bregdetare, rurale dhe malore.

Aktivitetet transnacionale mund të zhvillohen në koordinim me skema ekzistuese bashkëpunimi si: nisma BLUEMED për të promovuar bashkëpunimin në kërkim shkencor dhe novacion në fushën e ekonomisë blu, apo nisma WestMed për të promovuar ekonominë blu në rajonin e Mesdheut, ose strategjitë makrorajonale EUSALP e EUSAIR, ose Unioni për partneritetin shumëpalësh për Mesdheun.

Si rrjedhojë, sfida për programin e ardhshëm INTERREG Euro-MED fokusohet në **nxitjen e koordinimit të palëve të interesuara, duke testuar apo pilotuar ide të reja për të cilat shkalla transnacionale është thelbësore, si dhe në shkëmbimin e praktikave të mira midis të gjithë aktorëve me synimin për t'i integruar në politikat ekzistuese (proceset e transferimit dhe integritetit).**

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM DHE MISIONET e programit

Propozimi i Komisionit për Kuadrin Financiar Shumëvjeçar 2021–2027 përcakton një objektiv më ambicioz për integrimin e klimës në të gjitha programet e BE-së, me synimin e përgjithshëm që 30% e shpenzimeve të BE-së të kontribuojnë në objektivat klimatike, duke reflektuar rëndësinë e trajtimit të ndryshimeve klimatike në përputhje me angazhimet e BE-së për të zbatuar Marrëveshjen e Parisit dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, Kuadri Financiar Shumëvjeçar përcakton edhe një objektiv ambicioz që për biodiversitetin të shkojnë 7.5% e shpenzimeve nga viti 2024 dhe 10% nga viti 2026.

BE-ja synon të jetë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050 (miratimi i Këshillit Evropian i dhjetorit 2019) – një ekonomi me emetime neto të gazeve serrë. Gjithashtu, Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian miratuan më 21 prill 2021 objektivin e propozuar të Komisionit për reduktimin neto prej të paktën 55% të emetimeve të gazeve serrë në BE deri në vitin 2030, krahasuar me nivelet e vitit 1990.

Kuadri i klimës dhe energjisë 2030 po rishikon rregullisht objektivat e veta për reduktimin e emetimeve deri në vitin 2030.

Për më tepër, Plani i Veprimit për Zero Ndotje, miratuar nga Komisioni Evropian më 12 maj 2021, synon përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës, duke vendosur objektivin për reduktimin me 50% të mbetjeve plastike në det, me 30% të mikroplastikës të hedhur në mjedis dhe me 50% për mbetjet bashkiake.

Këta objektiva janë në qendër të Paktit të Gjelbër Evropian. Kalimi drejt një shoqërie neutrale ndaj klimës dhe rezistente është sa sfidë urgjente edhe mundësi për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë. I gjithë legjislacioni dhe politikat përkatëse të BE-së duhet të jenë në përputhje dhe të kontribuojnë në përmbushjen e objektivit të neutralitetit ndaj klimës, dhe paralelisht, kalimi do të kërkojë investime të konsiderueshme publike dhe private.

Projektet Interreg Euro-MED janë një mundësi e shkëlqyer për të mbështetur territoret, si dhe politikat kombëtare dhe rajonale, për të arritur objektivat e përcaktuar në Paktin e Gjelbër të BE-së, duke kontribuar në një qasje të integruar.

Në përputhje me fokusin e BE-së në objektivat mjedisore dhe klimatike, mjedisi është tema kryesore për programin Interreg Euro-MED i cili garanton vazhdimësinë e programit Interreg MED të periudhës 2014–2020, aksi 2 (Ekonomia me karbon të ulët) dhe aksi 3 (Mbrojtja e mjedisit), por trajton edhe tema të zhvilluara nën aksin 1 (Novacioni), duke lidhur kështu OP1 aktual (MED më inteligjente) me OP2 (MED më i gjelbër).

Edhe nëse së shpejti do të nxirren disa përfundime nga kriza shëndetësore (dhe ekonomike dhe sociale), tashmë mund të merren parasysh dy reflektime fillestare:

Edhe pse është shpejt të nxirren përfundime nga kriza shëndetësore (dhe ekonomike e sociale), sërish mund të bëhen disa reflektime fillestare:

1. Mbyllja globale pati pa dyshim ndikim pozitiv në gjendjen e mjedisit (ulje të ndotjes, përmirësimi të gjendjes së habitateve natyrore, ulje të trafikut në zonat urbane, reduktim të konsumit etj. Nëse kjo ishte prova që të bindemi se aktivitetet njerëzore po ndikojnë kryesisht në mjedisin tonë, atëherë duhet të përfitojmë prej saj për të ndryshuar drejt një shoqërie më rezistente.

2. Pasojat e mbylljes shkaktuan një krizë ekonomike të pashembullt, edhe pse jo strukturore. Rimëkëmbja e shpejtë ekonomike kërkon mbështetje intensive, veçanërisht në sektorët të prekur më rëndë si turizmi dhe industritë kulturore dhe krijuese (IKK).

Tani është mëse e qartë se duhet të ndryshojmë drejt një sistemi më rezistent dhe programi mund të kontribuojë në këtë drejtim, përmes zgjidhjeve novatore për sfidat e përbashkëta mjedisore në Mesdhe. Për këto arsye, **qëllimi kryesor i programit është të kontribuojë në kalimin drejt një shoqërie neutrale ndaj klimës dhe më rezistente, duke luftuar ndaj ndikimit të ndryshimeve globale në burimet e Mesdheut, ndërkohë që garantohet rritja e qëndrueshme dhe mirëqenia e qytetarëve.**

Programi ka zgjedhur një qasje strategjike rreth 4 misioneve operacionale që kontribuojnë në arritjen e qëllimit të përgjithshëm të përcaktuar më lart. Kjo qasje tematike strategjike do të jetë si fanar për strategjitë e komunikimit të programit dhe për strategjitë e amplifikimit të rezultateve në kuadrin e prioritetit të “Qeverisjes”.

MISIONI 1: FORCIMI I EKONOMISË SË QËNDRUESHME NOVATORE

Kërkimi shkencor dhe novacioni, hartimi i strategjive dhe zbatimi i ndryshimeve sistematike që përshkojnë sektorë të ndryshëm (p.sh. bujqësinë, peshkimin dhe akuakulturën, ushqimin, manufakturën, turizmin) janë thelbësore për menaxhimin e qëndrueshëm jo vetëm të burimeve natyrore por edhe të zgjidhjeve teknologjike, veçanërisht në situatën aktuale të rritjes së presionit ndaj mjedisit dhe humbjes së biodiversitetit. Praktikrat dhe politikat duhet të jenë të ndërlidhura dhe të funksionojnë në sinkron për të garantuar produkte dhe shërbime të qëndrueshme. Bashkëpunimi i palëve të interesuara përgjatë zinxhirëve të vlerës duhet të përforcohet për t’iu përgjigjur më mirë kushteve të mjedisit të biznesit dhe për të nxitur zhvillimet simbiotike industriale me qëllim zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike në mjedis.

Për të luftuar krizën ekonomike pas COVID-19, nevojiten zgjidhje novatore që riformësojnë ekonominë lineare dhe ofrojnë shtigje drejt modeleve qarkulluese dhe shoqërisë së qëndrueshme. Eksperimentimi në shkallë më të gjerë – me teknologji, ide biznesi, politika dhe qeverisje, do të bëjë të mundur kalimin drejt rritjes gjithëpërfshirëse dhe qarkulluese.

Objekti i këtij misioni shkon përtej dhe synon të ndihmojë edhe misionet e tjera të programit. Si rrjedhojë, është mision ndërsektorial, sepse synon të mbështesë veprimet që mund të ndihmojnë në kalimin drejt një ekonomie më të gjelbër, zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike, sigurimin e ekonomisë së përbashkët dhe zona me jetesë më të mirë.

Veprimet në këtë mision duhet të lejojnë bashkëpunimin transnacional në të gjitha llojet e novacionit (pilotime, rrjete të zinxhirit të vlerës, avancim teknologjik, diversifikim të produkteve, kapacitete kërkimore dhe novatore në teknologjitë e avancuara), por edhe novacionin që bazohet te shërbimet dhe jo te teknologjia (dizenjimi, puna krijuese) dhe modelet organizative (instrumentet novatore si prokurimi publik novator) në shumë sektorë prioritarë për rajonin e Mesdheut – p.sh. rritja e gjelbër dhe rritja blu, turizmi, industritë kulturore dhe krijuese, burimet e rinovueshme dhe biodiversiteti.

Do të kërkohet vazhdimi i punës së bërë gjatë periudhës së mëparshme të programimit në lidhje me ekonominë qarkulluese dhe novacionin, me fokus të qartë në përmirësimin e dimensionit mjedisor të të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe shërbimeve e produkteve shoqëruese.

MISIONI 2: MBROJTJA, RESTAURIMI DHE VALORIZIMI I MJEDISIT NATYROR DHE TRASHËGIMISË

Ruajtja dhe restaurimi i ekosistemeve dhe biodiversitetit është thelbësor për jetën e njeriut. Natyra kontribuon në një shoqëri më të shëndetshme dhe më rezistente. Ruajtja e ekosistemeve mundëson

zbutje të fatkeqësive natyrore dhe sëmundjeve, rritje të rezistencës dhe rregullim të klimës, duke reduktuar kështu rreziqet për shoqëritë njerëzore.

Shkaku kryesor i drejtpërdrejtë i humbjes së biodiversitetit është ndryshimi në përdorimin e tokës dhe detit, që ndikon në ekosistemet tokësore dhe të ujërave të ëmbël. Dy faktorë të tjerë kryesorë që kontribuojnë në degradimin e ekosistemeve natyrore janë mbishfrytëzimi i burimeve natyrore dhe ndryshimet klimatike.

Ky mision ka si synim kryesor përmbushjen e objektivave mjedisore të planifikuara nga BE-ja dhe të përcaktuara në Paktin e Gjellbër të BE-së, por edhe të shtjelluara mjaft mirë në Komunikatën e BE-së për Ekonominë e Qëndrueshme Blu dhe në Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030, në Konventën e Barcelonës dhe në Konventën për Diversitetin Biologjik (CBD).

Bashkë me dy misionet e tjera, synon të kontribuojë në promovimin e një modeli mjedisor më të shëndetshëm dhe ekonomikisht më të qëndrueshëm për shoqërinë nëpërmjet mbrojtjes, restaurimit dhe valorizimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Në këtë këndvështrim, qëllimi i programit është të vazhdojë të luftojë kundër humbjes së biodiversitetit duke nxitur veprimet e përshtatjes/zbutjes së ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të këtij misioni, Programi synon t'i japë vazhdimësi punës së kryer gjatë periudhës së mëparshme të programimit, duke mbështetur veprimet transnacionale të përgatitura për zhvillimin e kornizave efektive të qeverisjes dhe garantimin e qëndrueshmërisë në menaxhimin e burimeve natyrore si dhe në mekanizmat e financimit. Lidhja mes ekosistemeve natyrore dhe mes drejtuesve të zonave të mbrojtura, do të vazhdojë të jetë çelësi për habitate natyrore të shëndetshme, por edhe për zgjerimin e gamës së zonave të mbrojtura. Për sa i përket konceptit të “ndërlidhjes”, risi do të jetë përfshirja e zonave të brendshme; rrjedhimisht, është me rëndësi që të inkurajohen qasjet e integruara. Në këtë kuptim, ruajtja e biodiversitetit detar dhe restaurimi i mjedisave detare të degraduara do të ndërlidhen dhe do të shoqërohen me restaurimin e ujërave të ëmbla, ligatinave dhe tokës së degraduar.

Paralelisht, prioritet do të jetë ruajtja e mjedisit në gjendje të mirë, me veprime që janë në gjendje të parandalojnë dhe të zbusin rreziqet/pasojat e ngjarjeve natyrore dhe aktivitetit njerëzor. Ekziston nevoja që të këmbëngulet me zbatimin e instrumenteve ekzistuese për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare (MIZB), zgjidhjeve bazuar në natyrë, planifikimin hapësinor detar dhe, paralelisht, të mbështetet përfshirja në planet strategjive vendore jo vetëm e sfidave të ndryshimeve klimatike, por edhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Rezultatet e deritanishme tregojnë se në planin afatgjatë është thelbësore për rajonin e Mesdheut që të ketë koordinim midis politikave dhe sektorëve ekonomikë, si edhe mes niveleve vendore, rajonale, kombëtare dhe mesdhetare.

Mbrojtja dhe restaurimi i mjedisit duhet të bëhet prioriteti kryesor në të gjitha llojet e investimeve dhe masave të politikave. Aktivitetet ekonomike nuk mund të anashkalojnë ndikimin e tyre në mjedis dhe nevojitet një “ndryshim transformues” në mënyrën se si përdoruesit/sektorët zbatojnë aktivitetet e tyre.

MISIONI 3: PROMOVIMI I HAPËSIRAVE TË JETESËS SË GJELBËR

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i hapësirave të jetesës janë themelore për cilësinë e jetës së popujve mesdhetarë.

Në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër të BE-së dhe “zgjimin” në rritje për emergjencën klimatike, duhet të inkurajohet një vizion i integruar i tranzicionit energjetik të territoreve.

Për shkak të kompleksitetit të këtij tranzicioni, autoritetet publike, palët e interesuara private dhe komunitetet duhet të punojnë së bashku për të rinovuar planet (dhe për të rritur ndërgjegjësimin) se si territoret janë menaxhuar deri më tani, në mënyrë që të nxitet kohezioni i komunitetit dhe mjedisit më i shëndetshëm, si dhe të stimulohet novacioni dhe punësimi në territoret tona të ndryshme në Mesdhe.

Në veçanti, ekziston nevoja urgjente për të marrë masa në lidhje me ndikimet negative të aktiviteteve urbane që përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, në aspektin e ndotjes së ajrit, konsumit të energjisë, lëvizshmërisë, (mos)ndërlidhjes etj. Nga ana tjetër, siç evidentohet në vitet e fundit, hapësirat tona të jetesës janë shumë të cënueshme nga efektet e ndryshimeve klimatike

dhe po përballen gjithnjë e më shumë me fenomene natyrore ekstreme. Kjo situatë kërkon qasje të integruar që kombinon të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë sonë, që të arrihet ndryshim vendimtar dhe ambicioz në mënyrën se si administrojmë territoret ku jetojmë, me të gjithë diversitetin e tyre.

Kalimi drejt energjisë së pastër mund të ndiqet vetëm duke pasur parasysh ndikimet që territoret kanë te mjedisi dhe ekonomia. Nëpërmjet planifikimit dhe financimit të energjisë në mënyrë të shëndoshë për mjedisin, veçanërisht infrastrukturën e gjelbra dhe rinovimin e integruar të ndërtesave, përdorimin efikas të burimeve të rinovueshme, ndryshimin e mënyrës se si e konsiderojmë turizmin dhe lëvizshmërinë, ne do të punojmë për të minimizuar ndikimin e hapësirave të banuara në Mesdhe dhe në sistemin global të klimës, në rrugën e tyre për t'u bërë vërtet neutrale ndaj karbonit.

Është fakt që autoritetet publike kanë përgjegjësinë parësore për mjedisin; ndërsa gjithnjë e më shumë autoritete vendore marrin përsipër sfidat e qëndrueshmërisë, shfaqet jo vetëm nevoja për strategji dhe politika të gjelbra të reja, por edhe përshtatja e kuadrit rregullator bëhet thelbësor për realizimin e tyre. Në fakt, kjo mund të arrihet vetëm me perspektivën nga lart poshtë, ku qytetarët dhe komunitetet angazhohen që të veprojnë si forcë transformuese në krijimin e aleancave vendore socio-ekologjike. Përfshirja e sektorit privat është po aq e rëndësishme për harmonizimin dhe aktivizimin e planeve të qarta të rezistencës në hapësirat tona të jetesës.

Mbështetja për kalimin drejt energjisë dhe hapësirave të gjelbra të jetesës do t'i përgjigjet sfidës së misionit që është komplementare me misionin 1 dhe 2, sepse trajton në mënyrë të integruar si sfidën e kalimit drejt energjisë së gjelbër, ashtu edhe zhvillimin e hapësirave të jetesës të gjelbra.

MISIONI 4: FORCIMI I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM

Sektori i turizmit ishte prioritet që me programin MED 2014–2020 me fokus në qëndrueshmërinë e tij, përmes mbrojtjes dhe valorizimit të burimeve natyrore dhe kulturore të zonës. Ndikimet e mëdha të pandemisë mbi këtë sektor në Mesdhe vazhdojnë ta bëjnë edhe më urgjente nevojën për të mbështetur riaftësimin e turizmit. Nisur nga fakti që programi me natyrë transnacionale e ka fokusin e përgjithshëm te mjedisi dhe klima, *riaftësimi i turizmit të qëndrueshëm trajtohet në mënyrë transversale në të gjitha prioritetet e programit*, me qëllim që “rajonet MED të praktikojnë qeverisjes të turizmit e cila mundëson përmirësime të vazhdueshme në qëndrueshmërinë mjedisore, sociale dhe ekonomike, rrit konkurrueshmërinë përmes cilësisë dhe novacionit, si dhe garanton zbatim dhe monitorim të strategjive dhe politikave”.¹⁹ Vërtet që tani më shumë se kurrë është mundësia që të mbështetet ndryshimi i përhershëm dhe i qëndrueshëm në praktikën e turizmit.

Secili objektiv specifik parashikon lloje të caktuara masash për turizmin, të cilat do të shtjellohen më tej në termat e referencës për secilën thirrje.

1.3. Arsytimi për përzgjedhjen e objektivave të politikave dhe të objektivave specifike për Interreg, prioritetet korresponduese, objektivat specifike dhe format e mbështetjes, duke adresuar sipas rastit hallkat e munguara në infrastrukturën ndërkufitare.

Referenca: germa (c) e nenit 17(3)

Tabela 1.

Objektivi i politikave i përzgjedhur ose objektivi specifik i Interreg i përzgjedhur	Objektivi specifik i përzgjedhur	Prioriteti	Arsytimi për përzgjedhjen
1. Evropë më konkurruese dhe më inteligjente, duke promovuar transformimin ekonomik novator dhe inteligjent si dhe ndërlidhjen rajonale TIK	SOR1.1. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe novacionit dhe i përvetësimit të teknologjive të avancuara	1. MED-i më inteligjent	Rajonet e Mesdheut ngelen pas mesatares së BE-së për sa i përket performancës së novacionit, pavarësisht ekzistencës së rajoneve me performancë më të mirë në Spanjë, Francë, Itali dhe Slloveni. Potenciali i novacionit të zonës MED theksohet në strategjitë rajonale të specializimit inteligjent, për të cilat konsiderohet vendimtar zhvillimi dhe zbatimi, bashkëpunimi i palëve të

¹⁹ Panoramed – Dokument politikash kryesore për turizmin, qershor 2020.

			interesit të spirales së katërfishtë. Potencialet e novacionit dhe zhvillimit janë të konsiderueshme falë ekzistencës së grupimeve që veprojnë në fushat kyçe të ndërhyrjes që lidhen me ekonominë blu dhe të gjelbër (shërbimet mjedisore, bioteknologjitë, turizmi i qëndrueshëm, menaxhimi i burimeve natyrore, energjia e pastër, shkenca detare, peshkimi...). Arritje të mëdha janë shënuar në nivelin tematik të komunitetit, duke lidhur grupimet kombëtare, qendrat dhe rrjetet transnacionale, veçanërisht në sektorin detar. Rreth 22 rrjete dhe grupime transnacionale janë mbështetur në aktivitetet e tyre. Me zgjedhjen e kësaj OS-je, Programi do t'u përgjigjet nevojave të mëposhtme: - përmirësimi i kapaciteteve të novacionit, konkurrueshmërisë dhe ndërkombëtarizimit / ekstroversionit të NVM-ve që përballen me konkurrencë ndërkombëtare në sektorët e ekonomisë parësore, dytësore dhe terciare p.sh. bujqësia, peshkimi dhe akuakultura, prodhimi i ushqimit, manifaktura inteligjente, turizmi, drejt tranzicionit të tyre të gjelbër; - forcimi i Strategjive të Specializimit Inteligent, promovimi i teknologjive të përparuara (digjitalizimi është tani më shumë se kurrë nxitës i ekonomisë së qëndrueshme) dhe novacioneve joteknologjike; - forcimi i bashkëpunimit midis palëve të interesuara të spirales së katërfishtë, duke marrë parasysh dimensionin mjedisor në aktivitetet e tyre; - përforcimi i sektorëve të rritjes që mbështetin nismat mjedisore dhe të ndryshimeve klimatike dhe përfaqësojnë potencial të lartë punësimi (p.sh. sektorët e rritjes blu dhe të gjelbër, turizmi); - mbështetja për modelet e reja të biznesit të orientuara drejt gjenerimit të vlerës së përbashkët dhe industritë kulturore dhe krijuese në kontekstin pas Covid-it; - nxitja e përmirësimeve mjedisore përmes proceseve industriale novatore dhe më efikase. Forma e mbështetjes: grante, sepse projektet nuk gjenerojnë të ardhura.
2. Tranzicion më të gjelbër dhe me karbon të ulët drejt një ekonomike me karbon neto zero dhe Evropë rezistente, duke promovuar tranzicionin e pastër dhe të drejtë të energjisë, investimet e gjelbra dhe blu, ekonominë qarkulluese, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe lëvizshmëri urbane të qëndrueshme.	RSO 2.4. Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore dhe rezistencës, duke pasur parasysh qasjet e bazuara në ekosistem.	MED më i gjelbër	Ndryshimet klimatike pritet të rrisin numrin e rreziqeve natyrore në dekadat e ardhshme. Këto rreziqe përfshijnë ngritjen e nivelit të detit, erozionin e bregdetit, mot ekstrem, thatësira dhe zjarre në pyje, shkretim, degradim të biotopeve, humbje të burimeve bujqësore, efekte shëndetësore etj. Studime të ndryshme tregojnë se shumica e vendeve që pritet të preken nga efekte veçanërisht të rënda janë në Evropën Jugore. Për sa u përket politikave publike dhe inxhinierimit të projekteve, zgjidhjet novatore do të duhet të zhvillohen për këto rreziqe të ndryshme. “Zgjidhjet e bazuara në natyrë” janë alternativa të rëndësishme për të realizuar

			përgjigje afatgjata. Nga pikëpamja mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore, promovimi i një modeli të qëndrueshëm të turizmit për të balancuar efektet e turizmit masiv, është thelbësor për të garantuar zhvillim më të respektueshëm ndaj mjedisit dhe burimeve. Përveç parandalimit të rreziqeve dhe zhvillimit të qëndrueshmërisë së ekosistemeve tona, ne mund të përgatitemi që t'i përshtatemi ndryshimeve klimatike duke përshtatur hapësirat tona të jetesës. Kështu, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe menaxhimi i zonave të gjelbra të jetesës do të kontribuojnë në këtë përshtatje, veçanërisht duke mbështetur tranzicionin e energjisë dhe lëvizshmërinë e butë, si dhe duke përfshirë qytetarët në mënyrë aktive. Duke zgjedhur këtë OS, Programi do t'u përgjigjet nevojave të mëposhtme: - Përballimin e problematikës kryesore të ndryshimeve klimatike për të ardhmen e rajoneve të Mesdheut (ngrohja e përsheptuar); - Nxitja e mbrojtjes së mjedisit në funksion të presionit të aktiviteteve njerëzore dhe/ose ndryshimeve klimatike; - Përmirësimi i qasjeve të bazuara në ekosistem, për të parandaluar fatkeqësitë natyrore dhe për të përmirësuar rezistencën; - Përmirësimi i parandalimit dhe zbutjes së rreziqeve; - Promovimi i rëndësisë së tranzicionit të energjisë në kontekstin e ndryshimeve klimatike; - Trajtimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në shëndet - Përfshirja e qytetarëve në një tranzicion më të gjelbër të hapësirave të jetesës; - Nxitja e modeleve të turizmit të qëndrueshëm që sigurojnë mbrojtjen e mjedisit, përfshirë burimet natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Forma e mbështetjes: grante, sepse projektet nuk gjenerojnë të ardhura.
2. Tranzicion më të gjelbër dhe me karbon të ulët drejt një ekonomike me karbon neto zero dhe Evropë rezistente, duke promovuar tranzicionin e pastër dhe të drejtë të energjisë, investimet e gjelbra dhe blu, ekonominë qarkulluese, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe lëvizshmëri urbane të qëndrueshme	RSO 2.6. Promovimi i tranzicionit drejt një ekonomie qarkulluese dhe efikase me burimet	MED më i gjelbër	Ka vend për përmirësim në lidhje me kapacitetet e novacionit në ekonominë rrethore dhe sjelljen e konsumatorëve. Zgjidhjet novatore mund të zhvillohen në nivel territorial dhe vendor, veçanërisht në zonat me mungesë burimesh dhe/ose sfida të menaxhimit të mbetjeve. Lëvizja drejt një ekonomie qarkulluese ofron edhe mundësi të reja zhvillimi të biznesit që lidhen me ekonovacionin në sektorët e bujqësisë, akuakulturës dhe peshkimit, energjisë, manufakturës dhe pylltarisë, si dhe me ripërdorimin, riprodhimin dhe riciklimin e produkteve/materialeve. Po vërehen disa tendenca specializimi (furnizimi me biomasë, përpunimi dhe konversioni, praktikat e reduktimit të mbetjeve në prodhimin dhe furnizimin me ushqime, ngritja e dizajnit qarkullues). Puna për zbatimin e planit të veprimit të ekonomisë qarkulluese dhe sigurimin e modeleve dhe mjeteve të

			qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit filloi në periudhën 2014–2020 nga komuniteti tematik i projekteve të Rritjes së Gjellbër. Pritet të konsolidohet dhe të vazhdojë me aktivitete në kuadër të këtij objekti specifik. Etiketimi UfM i këtij komuniteti tematik hap perspektivën për përfshirje të palëve të interesuara nga bregu i Mesdheut jugor dhe për punë të përbashkët në adresimin e sfidave përbashkëta mjedisore dhe krijimin e praktikave të qëndrueshme. Sukses është shënuar në sektorin e manufakturës e gjelbër me sinergjinë e grupit të punës të nismës <i>Vanguard</i> dhe janë promovuar mjetet për aplikimin e modeleve të ekonomisë qarkulluese. Duke zgjedhur këtë SO, Programi do t'u përgjigjet nevojave të mëposhtme: - ndikim të madh mjedisor i sistemit aktual të prodhimit linear; - mungesa e burimeve natyrore dhe mbishfrytëzimi aktual; - nevoja për të reduktuar prodhimin e mbetjeve dhe eliminimin e tyre, duke i kthyer mbetjet në burim; - nevoja për të inkurajuar një model ekonomik më të qëndrueshëm të bazuar në bioekonominë rrethore qarkulluese ndërkohë që nxitet turizmi i qëndrueshëm; - mundësi të reja ekonomike që ofron modeli i ekonomisë qarkulluese; - kultivimi i filozofisë së <i>ripërdorimit</i> në zonat e banimit. Forma e mbështetjes: grante pasi projektet nuk gjenerojnë të ardhura.
2. Tranzicion më të gjelbër dhe me karbon të ulët drejt një ekonomike me karbon neto zero dhe Evropë rezistente, duke promovuar tranzicionin e pastër dhe të drejtë të energjisë, investimet e gjelbra dhe blu, ekonominë qarkullues, zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe lëvizshmëri urbane të qëndrueshme	RSO 2.7. Forcimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes.	MED më i gjelbër	Menaxhimi i burimeve natyrore kërkon zbatimin efektiv dhe efikas të masave të vendosura të ruajtjes, duke përfshirë planet e menaxhimit dhe një kuptueshmëri më të mirë të rolit që ato luajnë në jetën tonë të përditshme, tashmë të njohura si “shërbime të ekosistemit”. Shkenca, zgjidhjet me pjesëmarrje dhe përfshirja e autoriteteve vendore, drejtuesve të zonave të mbrojtura dhe OJF-ve, janë çështje thelbësore për të kuptuar këto ekosisteme. Bashkëpunimi publik-privat dhe lidhja ndërmjet aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë në nivele dhe sektorë të ndryshëm përbën një tjetër gur themeli për menaxhimin e biodiversitetit. Disa aspekte të politikave dhe zgjidhje janë trajtuar nën komunitetin tematik të Mbrojtjes së Biodiversitetit në periudhën 2014–2020, duke trajtuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, qasjen e bazuara në ekosisteme dhe mekanizmat e qeverisjes. Paralelisht, rritja e infrastrukturave të gjelbra dhe masat për reduktimin e ndotjes, veçanërisht në zonat urbane/të banuara është me rëndësi parësore për të minimizuar ndikimin e hapësirave të banuara mbi sistemin klimatik mesdhetar dhe atë global. Këto masa mund të mbështesin restaurimin,

			të përforcojnë lidhjen midis zonave të fragmentuara me vlerë të lartë për biodiversitetin dhe gradualisht të përmirësojnë disponueshmërinë e shërbimeve të ekosistemit. Me zgjedhjen e këtij OS-je, Programi do t'u përgjigjet nevojave të mëposhtme: - konsolidimi i lidhjes së ekosistemeve natyrore në nivel transnacional; - sigurimi i korridoreve ekologjike për të nxitur dhe ruajtur biodiversitetin; - përforcimi i menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas dhe mbrojtjes së fortë të zonave të mbrojtura; - masa/punë përtej zonave të mbrojtura që trajtojnë ndotjen, mbipeshkimin dhe ndryshimet klimatike; - përmirësimi i restaurimit të ekosistemeve të degraduara në tokë dhe det; - promovimi i ruajtjes adekuate të biodiversitetit bregdetar dhe detar; - mbështetje për vizionin e ruajtjes së biodiversitetit si një vlerë ekonomike dhe sociale; - inkurajimi i turizmit të qëndrueshëm. Forma e mbështetjes: grante, sepse projektet nuk gjenerojnë të ardhura.
6. Interreg: Qeverisje më e mirë e Bashkëpunimit	SOL.6. Masa të tjera për të mbështetur qeverisjen më të mirë të bashkëpunimit (të gjitha drejtimit)	Qeverisja e MED-it	Nocioni i qeverisjes nxjerr në pah kompleksitetin në rritje në mjedisin ekonomik, social dhe politik, fuqizimin e aktorëve të rinj dhe ndërveprimin e niveleve vendore dhe kombëtare me atë transnacional për të adresuar sfidat e reja, për të koordinuar veprimet kolektive dhe për të arritur një konsensus mbi qëllimet e përbashkëta strategjike. Në këtë kuadër, autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore së bashku me rrjetet ndërkombëtare që ndërhyjnë në zonën e Mesdheut janë zbatues përkatës për politikën evropiane dhe kombëtare. Bashkëpunimi i zgjeruar i palëve të interesit mbart rëndësi të veçantë për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030. Arsyeja pse u zgjodh OSI1 është evidentimi, sintetizimi, transferimi dhe zbatimi i rezultateve më të mira nga territoret drejt strategjive/nismave dhe qytetarëve përmes një procesi vendimmarrjeje të rrjedhshëm dhe të mirëkoordinuar. Gjatë periudhës 2014–2020, Programi mbështeti dialogun e përmirësuar dhe më të fortë ndërmjet proceseve kombëtare dhe të decentralizuara nëpërmjet aksit të qeverisës, duke bashkëfinancuar një projekt platformë [pilot] dhe projekte strategjike në prioritetet kryesore. Bazuar në këtë përvojë pilot të mbështetjes së qeverisjes shumë-nivelëshe, programi synon të vazhdojë përpjekjet e tij për të përmirësuar koordinimin dhe qeverisjen në zonë. ISO1, i integruar në arkitekturën e përgjithshme Interreg Euro-MED 2021–2027, duhet të forcojë proceset tematike të komuniteteve të kapitalizimit,

			integritetit dhe ndërlidhjes duke synuar aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve që përmirësojnë qeverisjen që lidhen me: - Koordinimin me strategjitë përkatëse dhe programet e BE-së; - Pjesëmarrjen e shoqërisë civile; - Ndërgjegjësimin e njëjtë territorial mesdhetar për zgjidhjet e përbashkëta ndaj problematikave transnacionale. Rrjedhimisht, ngritja e një sistemi më të mirë për qeverisjen e bashkëpunimit nuk mund të jetë objekti i vetëm një Programi, por një Program i vetëm mund të promovojë nisma në këtë fushë: kjo është arsyeja përse SOI1 është integruar plotësisht në strategjinë Interreg MED dhe përbën shtyllën e tij për të ardhmen. Forma e mbështetjes: grante, sepse projektet nuk gjenerojnë të ardhura.
--	--	--	--

2. Prioritetet

Referenca: gerrat (d) dhe (e) të nenit 17(3)

2.1. Prioriteti: 1 – MED më inteligjent

Referenca: germa (d) e nenit 17(3)

2.1.1 Objektivi specifik: RSO1.1. Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe novacionit dhe i përvetësimit të teknologjive të avancuara

Referenca: germa (e) e nenit 17(3)

Nën këtë OS, ekosistemi konkurrues i novacionit do të konsolidohet në Mesdhe, duke kontribuar kështu edhe në objektivat e klimës për vitin 2030, në neutralitetin ndaj klimës për vitin 2050 (legjislacioni evropian për klimën), në realizimin e misioneve të Agjendës Territoriale 2030, duke ndërmarrë masat e Strategjisë për Rritjen Blu dhe duke koordinuar proceset e novacionit rajonal.

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

Referenca: germa (e)(i) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

KONSOLIDIMI I EKOSISTEMIT TË NOVACIONIT KONKURRUES ME ANGAZHIMIN E PALËVE TË SPIRALES SË KATËRFISHTË

Kërkimi shkencor dhe novacioni janë fushë e rëndësishme për bashkëpunimin në nivel transnacional, duke pasur një qasje ndërsektoriale dhe shumëpalëshe. Njohja reflektohet edhe në strategjitë rajonale të Specializimit Inteligent që identifikojnë prioritetet për zhvillimin e biznesit dhe mënyrat për të përmirësuar konkurrueshmërinë territoriale dhe arritjen e qëllimeve më të gjera mjedisore dhe sociale.

Ky prioritet do të kontribuojë kryesisht në misionin operacional 1 të programit, për një ekonomi të qëndrueshme novatore dhe konkurruese, si dhe në misionin 4 për turizmin e qëndrueshëm, si dhe lidhet ngushtë me dy të tjerët. Rrjedhimisht, procesi i novacionit duhet të shfrytëzohet këtu si shtytës për kalimin drejt ekonomisë dhe shoqërisë së qëndrueshme, qarkulluese, më të gjelbër dhe rezistente.

Bashkëpunimi i palëve të interesuara të spirales së katërfishtë (organizatat kërkimore, bizneset, institucionet dhe shoqëria civile) është i rëndësishëm për koordinimin dhe zbatimin e prioritetëve rajonale të novacionit. Bashkëpunimi në nivel transnacional për zhvillimin e zinxhirëve të vlerës dhe përf forcimin e aftësive të partnerëve institucionalë është thelbësor për forcimin e Procesit të Zbulimit të Sipërmarrjes dhe plotësimin e kombinimit të politikave.

Është e nevojshme të promovohet dialogu i vazhdueshëm midis palëve të interesuara për të kalibruar më mirë procesin e novacionit, për të zhvilluar dhe rrjedhimisht monitoruar strategjitë e novacionit, për të angazhuar NVM-të dhe profesionistët në ekosistem dhe për të kuptuar nevojat dhe veprimet e tyre që të ndihmojnë në transformimin e ekonomisë në një ekonomi rajonale konkurruese dhe në të njëjtën kohë të bëhet kalimi në një model qarkullues të qëndrueshëm. Veçanërisht në

kontekstin e pandemisë Covid, aktivitetet e NVM-ve duhet të përforcohen me mjete, metoda dhe shërbime të mundshme të përshtatura dhe të koordinuara në mënyrë transnacionale, të cilat do t'i ndihmojnë NVM-të ta përballojnë krizën dhe të qëndrojnë funksionale. Ky është momenti kur duhet të ndodhë tranzicioni i gjelbër.

Nismat e ngritjes së kapaciteteve në Procesin e Zbulimit të Sipërmarrjes për të gjithë aktorët e spirales së katërfishtë janë thelbësore për të nxitur angazhim më të madh të palëve të interesuara në të gjitha fazat e zbatimit të RIS3. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet aftësive të aktorëve institucionalë të administratës publike, pasi roli i tyre është vendimtar për angazhimin e të gjitha palëve të interesuara. Aftësitë dhe kapacitetet e tyre analitike, rrjetëzuese dhe komunikuese do të përforcojnë proceset vendimmarrëse të informuara për zhvillimin e territorit dhe do të sigurojnë qeverisje koherente dhe politika të integruara.

Objektivat

- Shfrytëzim efektiv i potencialit të inovacionit për të mbështetur dhe përshpejtuar tranzicionin drejt ekonomisë dhe shoqërisë qarkulluese dhe të qëndrueshme;
- Mbështetje për shkëmbimin e njohurive dhe përvetësimin e teknologjive të reja në sektorë të ndryshëm që lidhen me Specializimin Inteligjent;
- Rritja e bashkëpunimit transnacional midis palëve të interesuara të spirales së katërfishtë, duke përfshirë angazhimin e shoqërisë civile;
- Përforcimi i rolit të NVM-ve dhe grupimeve në koordinimin dhe zbatimin e Strategjive Rajonale të Specializimit Inteligjent dhe projekteve S3;
- Rritja e kapaciteteve të autoriteteve publike në zbatimin e Strategjive Rajonale të Specializimit Inteligjent dhe projekteve S3.

Rezultatet e pritshme

- Sektorë ekonomikë të qëndrueshëm të përforcuar me mjete dhe praktika të harmonizuara në nivel transnacional;
- Angazhim i përforcuar i shoqërisë dhe kapacitete të rritura të autoriteteve publike dhe palëve të interesuara private për të zbatuar një ekonomi të qëndrueshme dhe më të gjelbër në Mesdhe;
- Agjenda të përbashkëta drejt ekosistemeve konkurruese dhe transformuese të novacionit me koherencë vertikale (p.sh. në nivel BE-je/kombëtar/rajonale) dhe horizontale (p.sh. ndërmjet territoreve).

Llojet indikative të veprimeve

- Zhvillimi dhe bashkëpunimi i zinxhirit të vlerës brenda grupimeve transnacionale dhe promovimi i koalicioneve transnacionale (bashkëpunimet publik-privat), ndërkombëtarizimi dhe ekstrovesioni (hapja) e NVM-ve;
- Zbatimi i praktikave novatore të zhvillimit të qëndrueshëm të biznesit, mjeteve të menaxhimit të ndryshimeve dhe zgjidhjeve për NVM-të;
- Përshpejtimi i transferimit të teknologjisë dhe novacionit (përfshirë ekonominë blu dhe të gjelbër, bujqësinë, prodhimin e ushqimit, peshkimin dhe akuakulturën, ndryshimet klimatike, parandalimin e ndotjes, burimet e rinovueshme, manifakturën inteligjente, transportin, biodiversitetin, industritë kulturore dhe krijuese, shëndetin dhe teknologjitë digjitale të së ardhmes);
- Promovimi i novacioneve miqësore me klimën, proceseve efikase të tranzicionit industrial, modeleve të reja të biznesit të orientuara drejt gjenerimit të vlerës së përbashkët, sipërmarrjes në sektorë të rinj dhe në ato në tranzicion;
- Promovimi i aksesit në financa, kapaciteteve novatore dhe bashkëpunimit ndërsektorial për NVM-të;
- Ndryshimi i praktikave turistike duke promovuar zgjidhjet ekzistuese dhe të reja në një mënyrë të re novatore: turizëm inteligjent, menaxhim i fluksit të turistëve;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve, organizatave kërkimore, bizneseve dhe shoqërisë civile për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e strategjive të specializimit inteligjent për zhvillim të qëndrueshëm (p.sh. ekonomia blu dhe e gjelbër, manifaktura, burimet e rinovueshme, transporti,

turizmi, industritë kulturore dhe krijuese, biodiversiteti, parandalimi i ndotjes), zhvillimi i aftësive për specializim inteligjent (p.sh. shëndeti, teknologjitë e ardhshme digjitale);

- Përforcimi i politikave të novacionit transformues.

Ky prioritet eksploron bashkëpunimin dhe kontributin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të rezultateve të projektit të EUSAIR, veçanërisht në lidhje me shtyllën 1 “Rritja blu” dhe shtyllën 4 “Turizmi i qëndrueshëm dhe nisma WestMed”, kryesisht në objektivin 2 “Ekonomia blu inteligjente dhe rezistente”. Novacioni në sektorët e ekonomisë blu, për të siguruar praktika të qëndrueshme dhe rezistente në teknologjitë blu dhe në peshkim e akuakulturë, janë ndër rezultatet e pritshme të aktiviteteve brenda këtij prioriteti. Puna për diversifikimin e produktit turistik dhe praktikave novatore për qëndrueshmërinë e turizmit pritet të realizohet në kuadër të projekteve të prioriteteve.

Rezultatet mund transferohen drejtpërdrejt dhe të pasurohen nga aktivitetet brenda programeve që kanë të përbashkët prioritetet e shtyllës së Rritjes Blu të EUSAIR dhe objektivit 2 të nismës WestMed, veçanërisht në fazën kur konceptohet projekti dhe objektivat.

Ekosistemet e kërkimit shkencor dhe novacionit janë një tematikë me peshë të njëjtë për EUSALP, AG 1, K&N. Ky kontribut tematik mund të eksplorohej përmes koordinimit me programin Hapësira Alpine, nën prioritetin 3 “Novacioni dhe digitalizimi” OS K&N.

Veprimet në këtë prioritet lidhen me objektivat prioritarë tematikë dhe ndërsektorialë të *BlueMed* siç parashikohet në planin e zbatimit të nismës BlueMed dhe veçanërisht me ato që trajtojnë potencialin e *blubioteknikës*, energjitë e rinovueshme detare, turizmin, novacionin e hapur, aftësitë blu, si dhe forcimin e sinergjive midis shkencës, industrisë, politikëbërësve dhe shoqërisë.

Rritja e potencialit për novacion dhe kapaciteteve të NVM-ve që synon ky prioritet dhe forcimi i potencialit për novacion të rajoneve të përfshira në programin Euro-Med, mund të krijojë sinergji me platformën S3 të JRC-së (Qendra e Përbashkët Kërkimore Evropiane) dhe veprimet e qendrave evropiane të novacionit digjital të programit “Evropa Digjitale”.

Gjatë zbatimit të programit Euro-MED, vëmendje e veçantë do t’i kushtohet kontributit të tij të mundshëm në ERA (Hapësira Kërkimore Evropiane) dhe objektivat e politikave të saj.

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”, pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim mjedisor negativ të konsiderueshëm, për shkak të natyrës së tyre. Lidhur me veprimet pilot në projektet e testimit që përqendrohen te infrastruktura e shkallës së vogël dhe pajisjet, projektet duhet të demonstrojnë në formularin e aplikimit se respektojnë parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”. Kjo do të vlerësohet gjatë procesit të përzgjedhjes dhe do të monitorohet gjatë zbatimit të projektit përmes një mekanizmi monitorues të dedikuar.

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

Referenca: germa (c)(i) e nenit 17(9)

2.1.1.2 Treguesit

Referenca: germa (e)(ii) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Viti bazë (2024)	Objektivi (2029)
1	RSO1.1	RCO116	Zgjidhjet e zhvilluara bashkërisht	zgjidhje	0	27
1	RSO 1.1	RCO87	Organizatat që bashkëpunojnë në nivel ndërkufitar	organizata	0	372

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

Prioriteti	Objekti vi specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Baza	Viti referencë	Objekti vi (2029)	Burimi i të dhënave	Koment e
1	RSO1.1	PSI1	Organizata me kapacitete	organizata	0.00	2021	260.00	Sistemi i monitorimit të	

			institucionale të rritura për shkak të pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar					programit	
1	RSO 1.1	RCR104	Zgjidhjet e përvetësuar ose të përmirësuar nga organizatat	zgjidhje	0.00	2021	24.00	Sistemi i monitorimit të programit	

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

Referenca: germa (e)(iii) e nenit 17(3), germa (c)(iv) e nenit 17(9)

Grupi kryesor i synuar i Interreg Euro-MED 21–27 përbëhet nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave. Së bashku me organet e tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave, ky grup bazë është grupi kryesor i synuar i programit. Lloji i institucionit publik të përfshirë mund të ndryshojë në varësi të fushës së ndërhyrjes dhe strukturës administrative të çdo vendi. Veprimet kryesore synojnë përf forcimin e aftësive të administratorëve publikë për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në funksion të politikave më koherente dhe të integruara.

Përveç grupit të synuar kryesor, synohen edhe organizatat të tjera, për rolin dhe rëndësinë e tyre në mbështetjen e tranzicionit të gjelbër.

Operatorët privatë si NVM-të dhe organizatat mbështetëse të biznesit (p.sh. agjencitë e novacionit, dhomat e tregtisë, grupimeve etj.) janë grupe kryesore të synuara për të ndihmuar transformimin në ekonomi novatore dhe të qëndrueshme.

Në mbështetje të tranzicionit drejt novacionit dhe qëndrueshmërisë mjedisore, edhe universitetet dhe qendrat kërkimore janë grupe të rëndësishme të synuara në të gjitha prioritetet e programit, sepse ofrojnë njohuri dhe ekspertizë dhe janë urë lidhëse midis praktikës dhe politikave.

Mësimi që nxorëm nga periudha e programimit 2014–2020 ishte se pasja si grupe të synuara të rrjeteve dhe organizatave të orientuara drejt tematikave mund të sigurojë ndikim të politikëbërësit e synuar dhe të shumëfishojë efektet në mobilizimin e aktorëve të tjerë kyç.

Qytetarët, komunitetet vendore dhe shoqatat, janë një tjetër objektivi i programit që mund të përvetësojë dhe të përfitojë nga zgjidhjet novatore të realizuara, por edhe nga veprimet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit që janë në gjendje të ndryshojnë sjelljet socioekonomike.

Specifikisht, ndër grupet e synuara për ndërhyrjet në Prioritetin 1 dhe objektivin specifik (i) *Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe novacionit dhe i përvetësimit të teknologjive të avancuara*, janë:

- autoritetet vendore, rajonale dhe kombëtare;
- NVM-të dhe operatorët ekonomikë;
- grupimet;
- organizatat e mbështetjes së biznesit;
- universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore;
- shoqëria civile, komunitetet vendore dhe shoqatat, OJF-të.

Përveç grupeve të synuara, autoritetet dhe organizatat e lartpërmendura mund të përfshihen drejtpërdrejt në operacione si përfitues aktivë (partnerë projekti) ose të lidhur.

Detaje të mëtejshme mbi përfituesit e pranueshëm të projekteve dhe natyrën e përfshirjes së këtyre grupeve të synuara në projekte do të specifikohen në termat e referencave të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

Referenca: germa (e)(iv) e nenit 17(3)

Nuk ka asnjë dallim të veçantë që duhet pasur parasysh në lidhje me territoret që mund të përfitojnë nga ndërhyrjet në kuadrin e prioritetit 1 dhe objektivit specifik (i) *Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve të kërkimit shkencor dhe novacionit dhe i përvetësimit të teknologjive të avancuara*:

- zonat bregdetare/detare;
- ishujt;
- zonat rurale dhe malore;
- zonat urbane.

Kjo vlen për të gjitha zonat dhe, në varësi të llojeve specifike të aktiviteteve, fokusi mund të vendoset te zonat bregdetare dhe detare, ishujt, zonat e brendshme dhe ato malore, urbane dhe rurale.

Zonat bregdetare vazhdojnë të jenë sfidë kryesore për programin, sepse përballen me presione të forta nga aktiviteti njerëzor dhe urbanizimi i dendur. Zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike (rritja e nivelit të detit, erozioni bregdetar etj.) bashkë me qasjen e integruar novatore që merr parasysh modelet e qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit, mund të sigurojnë një të ardhme më të mirë për zonën e Mesdheut. Baraspesha midis aktiviteteve ekonomike dhe mbrojtjes së mjedisit është thelbësore për këto territore.

Edhe ndryshimet klimatike janë një sfidë e zakonshme për zonat rurale, malore dhe/ose me dendësi popullore të ulët. Zonat malore përballen me rritje të rreziqeve natyrore që vënë në rrezik banorët dhe infrastrukturën vendore. Këto lloje territorësh janë të rëndësishme edhe për vlerat e tyre mjedisore, falë pyjeve, burimeve të ujit dhe rolit në ruajtjen e karbonit.

Së fundi, një tjetër territor i rëndësishëm i synuar nga programi është zona urbane që mund të veprojë si përsheptues për novacionin.

Ndërveprimet e qëndrueshme midis zonave bregdetare apo urbane nga njëra anë dhe zonave rurale dhe malore nga ana tjetër, janë çelësi për një zhvillim territorial të baraspeshuar.

Ky objektiv specifik si prioritet ndërsektorial mbulon të gjithë zonën e programit dhe të gjitha llojet e territoreve të përfaqësuara. Në rast të aktiviteteve që fokusohen në llojet e territoreve të synuara, identifikimi i mëtejshëm i territoreve mund të specifikohet në termat e referencës të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Referenca: germa (e)(v) e nenit 17(3)

Nuk zbatohet për programin Euro-MED

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Referenca: germa (e)(vi) e nenit 17(3), germa (c)(v) e nenit 17(9)

Tabela 4. Dimensio 1 – fusha e ndërhyrjes

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
1	RSO1.1.	Fondet Interreg	026. Mbështetje për grupimet e novacionit, përfshirë midis bizneseve, organizatave kërkimore dhe autoriteteve publike dhe rrjeteve të biznesit ky përfitues janë kryesisht NVM-të	24,394,599.00
1	RSO1.1.	Fondet Interreg	029. Proceset e kërkimit shkencor dhe novacionit, transferimi i teknologjisë dhe bashkëpunimi midis sipërmarrjeve, qendrave kërkimore dhe universiteteve, duke u fokusuar në ekonominë me karbon të ulët, rezistencën dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	24,394,599.00

Tabela 5. Dimensio 2 – forma e financimit

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
1	RSO1.1.	Fondet Interreg	01. Grant	48,789,198.00

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
1	RSO1.1.	Fondet Interreg	33. Qasje të tjera – pa territor të synuar	48,789,198.00

2.1 Prioriteti: 2 – MED-i më i gjelbër

Referenca: germa (d) e nenit 17(3)

2.1.1 Objektivi specifik: RSO2.4. Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore dhe rezistencës, duke marrë parasysh qasjet e bazuara në ekosistem

Referenca: germa (e) e nenit 17(3)

Nën këtë SO, rritja e kapaciteteve në parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, planifikimi efektiv për tranzicionin e energjisë, si dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe rezistenca do të arrihen në një mënyrë gjithëpërfshirëse siç rekomandohet në Strategjinë e Përshtatjes të BE-së, për të siguruar cilësi të mjedisit dhe jetesës në Mesdhe, duke kontribuar në Paktin e Gjelbër të BE-së.

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ata objektiva specifikë dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

Referenca: germa (e)(i) e nenit 17(3), germa (c)(ii) e nenit 17(9)

Duke pasur parasysh cenueshmërinë e lartë të zonës së Mesdheut ndaj ndryshimeve klimatike, ekziston nevoja për të rritur kapacitetet për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor, si dhe për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin e palëve të interesit matanë kufijve për t'i trajtuar ato. Nevojitet miratimi i një qasjeje parandaluese për menaxhim më të mirë të rreziqeve në të ardhmen dhe për të siguruar një shëndet të mirë dhe cilësi të jetës.

Në të njëjtën kohë, në harmoni me ndërgjegjësimin në rritje për urgjencën klimatike, duhet të inkurajojmë një vizion të integruar të përshtatjes së territoreve ndaj ndryshimeve klimatike dhe të mbështesim tranzicionin drejt një mjedisi më të gjelbër.

Zhvillimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm urban janë përcaktues për cilësinë e jetës. Me rritjen e numrit të popullsisë që jeton në qytete, ekziston nevoja për të vepruar ndaj ndikimeve negative të aktiviteteve urbane që janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin – në aspektin e emetimeve (shkarkimeve), konsumit të energjisë, lëvizshmërisë, (ç)ndërlidhjes etj. dhe për të bërë planifikime dhe financime efektive për përshtatjen dhe rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike. Për zonat periferike rurale dhe malore, nevojitet vënia në zbatim e koncepteve të infrastrukturës dhe shërbimeve të qëndrueshme.

Në veçanti, tranzicioni drejt energjisë së pastër duhet të trajtohet duke marrë parasysh ndikimin në mjedis dhe ekonominë e territoreve, si dhe sfidat që kanë të bëjnë me specifikat territoriale si ishujt emblemikë të Mesdheut.

Duke qenë se trashëgimia natyrore dhe kulturore dhe turizmi ndikohen nga pasojat e ndryshimeve klimatike dhe aktivitetet e paqëndrueshme, ekziston nevoja që turizmi të trajtohet nga të gjithë faktorët që pengojnë qëndrueshmërinë e tij.

Kështu, ndryshimet klimatike do të trajtohen nga tri fokuse të integruara: parandalimi dhe zbutja e rreziqeve natyrore dhe njerëzore, efienca e energjisë dhe tranzicioni drejt hapësirave të banimit më të gjelbra, duke kontribuar në misionet operationale 2, 3 dhe 4. Kjo qasje e integruar ndjek rekomandimin e Strategjinë e Përshtatjes të BE-së.

Objektivat

- Përmirësimi i parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve natyrore dhe atyre që lidhen me aktivitetin njerëzor;

- Mbështetja për autoritetet publike në përpjekjet e tyre për të arritur objektivat e energjisë për vitet 2030 dhe 2050 dhe neutralitetin e karbonit, duke arritur planifikim dhe financim efektiv për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe tranzicionin e energjisë;

- Forcimi i përshtatjes dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike për hapësira jetese më të qëndrueshme të jetesës duke rritur angazhimin e qytetarëve.

Rezultatet e pritshme

- Kapacitete të rritura në parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve natyrore me mjete dhe praktika të harmonizuara në nivel transnacional;
- Koordinim dhe bashkëpunim i rritur mes palëve të interesit për menaxhimin dhe parandalimin e përbashkët të rreziqeve nga fatkeqësitë (natyrore dhe njerëzore);
- Zhvillim dhe zbatim i lehtësuar i planeve dhe strategjive për tranzicionin e energjisë dhe përshtatjen e rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike, për të siguruar dhe për të përmirësuar cilësinë e mjedisit dhe të jetesës;
- Kapacitete të rritura të autoriteteve publike në planifikimin dhe financimin efektiv për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe tranzicionin e energjisë;
- Angazhim i përforcuar i qytetarëve për hapësira jetese më të qëndrueshme.

Llojet indikative të veprimeve

- Parandalimi dhe zbutja e rreziqeve natyrore dhe mjedisore:
- trajtimi i erozionit bregdetar dhe ngritjes së nivelit të detit duke nxitur integrimin më të mirë të menaxhimit të zonës bregdetare me qasjen e tjera të menaxhimit të burimeve natyrore: zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë, Planifikimi Hapësinor Detar (PHD), Menaxhimi i Integruar i Zonave Bregdetare (MIZB);
- mbrojtja e pyjeve për të zvogëluar incidencën dhe shtrirjen e zjarreve në pyje dhe për të rritur thithjen e CO₂, si dhe për të rritur aftësinë e pyjeve për të rivendosur shërbimet e ekosistemit dhe për të menaxhuar më mirë ndikimet e pritshme të ndryshimeve klimatike;
- zhvillimi dhe zbatimi pilot i planeve të menaxhimit të thatësirës, zhvillimit të observatorit, sistemeve të paralajmërimit të hershëm për thatësira/përmirësimi i njohurive: të dhënat, shkëmbimi i informacionit;
- hartimi i planeve të menaxhimit dhe zbatimit pilot në lidhje me rreziqe të tjera, duke përfshirë ngritjen e nivelit të detit, erozionin bregdetar, përmbytjet, motin ekstrem, zjarret në pyje, shkretëtimin, degradimin e biotopeve (në tokë dhe det), tërmetet, humbjen e burimeve bujqësore, efektet në shëndet (përfshirë valët e tërështit, sëmundjet respiratore dhe sëmundje të tjera).
- Parandalim dhe zbutja e rreziqeve që lidhen me aktivitetin njerëzor:
- Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe qeverisjes: shkëmbimi i informacionit, shkëmbimi dhe aksesimi në të dhënat më të mira të disponueshme (përfshirë të dhënat madhore), njohuritë, vlerësimet dhe instrumentet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Inkurajimi i platformave që shfrytëzojnë teknologjitë e reja për monitorimin dhe parashikimin e rreziqeve;
- Mbështetja e përdorimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj klimës të ujit në të gjithë sektorët dhe kufijtë. Të ndihmohet në reduktimin e përdorimit të ujit, duke nxitur efikasitetin, ripërdorimin dhe kursimin, si dhe duke promovuar përdorimin më të gjerë të planeve të menaxhimit të thatësirave, si dhe menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës;
- Zhvillimi dhe miratimi i strategjive dhe praktikave për të reduktuar ndikimin e turizmit, si dhe zbatimi i një modeli të qëndrueshëm të turizmit, me një përdorim më të respektueshëm të mjedisit, duke përfshirë burimet natyrore dhe kulturore;
- Integrimi i përshtatjes dhe rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike në planet vendore për mbrojtjen dhe menaxhimin e zonave me interes të veçantë (trashëgimia e kombinuar natyrore dhe kulturore);
- Mbështetja e skemave të planifikimit dhe financimit të integruar për përshtatjen dhe rezistencën ndaj ndryshimeve klimatike, tranzicionin e energjisë dhe konceptet për tranzicion të drejtë;
- Mbështetja dhe shfrytëzimi i fondeve për zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë në zonat urbane;
- Mbështetja e vendosjes së energjive të rinovueshme jo të djegshme, veçanërisht në zonat e largëta/ishullore/rurale që dallohen për potencial vendor të pashfrytëzuar mjaftueshëm;

- Promovimi i përmirësimit/eficiencës së energjisë në ndërtesa, duke mbështetur integrimin e konsideratave të rezistencës klimatike në kriteret e zbatueshme për rinovimin e ndërtesave, duke përfshirë ndërtesat e ruajtura;

- Mbështetja dhe promovimi i lëvizshmërisë me karbon të ulët për të reduktuar bllokimin e trafikut dhe ndotjen e ajrit, për të përmbushur objektivat e energjisë dhe neutralitetin e karbonit;

- Përmirësimi i lidhjeve dhe shërbimeve për zonat urbane dhe të brendshme/të largëta, përfshirë ishujt, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sektorit të turizmit.

· Ndërgjegjësimi dhe promovimi i kulturës mjedisore:

- forcimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe ndërgjegjësimi duke marrë parasysh vlerën e shtuar të kulturës për të adresuar problematikat mjedisore në drejtim të ndryshimit të sjelljes në përdorimin e burimeve, duke përfshirë praktikën turistike;

- nxitja e krijimit të kulturës së kursimit të ujit nga popullata (përfshirë mbrojtjen e furnizimit me ujë të pijshëm).

Këto veprime mund të kontribuojnë në strategjinë makrorajonale EUSAIR, veçanërisht në shtyllat 2 “Lidhja e rajonit”, 3 “Cilësia e mjedisit” dhe 4 “Turizmi i qëndrueshëm”. Projektet që adresojnë menaxhimin e riskut dhe tranzicionin drejt hapësirave të banimit të gjelbra mund të jenë komplementare për qeverisjen dhe shërbimet detare, transportin detar, lidhjet ndërmodale drejt brendësisë, rrjetet e energjisë, habitatet tokësore dhe biodiversitetet transnacionale, menaxhimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të turizmit.

Komplementariteti dhe sinergjitë mund të eksplorojnë me strategjinë makrorajonale EUSALP-së në fushën tematike 3 “Mjedisi dhe energjia” nëpërmjet koordinimit me programin e Hapësirës Alpine, prioriteti 2 “Rajon rezistent ndaj klimës dhe i gjelbër”.

Sinergji të mëtijshme mund të krijohen me misionin e *Horizon Europe* mbi “Përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë transformimin shoqëror”.

Projektet e fokusuar në parandalimin dhe zbutjen e risqeve *përmes sigurisë detare dhe reagimit kundër ndotjes detare* mund të kontribuojnë gjithashtu në nismën WESTMED, veçanërisht *përmes objektivit të saj të parë “Hapësirë detare më e sigurt”*.

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin e DNSH-së pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm negativ mjedisor për shkak të natyrës së tyre. Lidhur me veprimet pilot në projektet e testimit, duke përfshirë infrastrukturën ose pajisjet në shkallë të vogël, projektet duhet të demonstrojnë përputhjen e tyre me parimin DNSH në formularin e aplikimit. Kjo do të vlerësohet gjatë procesit të përzgjedhjes dhe do të monitorohet gjatë zbatimit të projektit përmes një mekanizmi të dedikuar monitorues.

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”, pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim mjedisor negativ të konsiderueshëm, për shkak të natyrës së tyre. Lidhur me veprimet pilot në projektet e Testimit që përqendrohen tek infrastruktura e shkallës së vogël dhe pajisjet, projektet duhet të demonstrojnë në formularin e aplikimit se respektojnë parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”. Kjo do të vlerësohet gjatë procesit të përzgjedhjes dhe do të monitorohet gjatë zbatimit të projektit përmes një mekanizmi monitorues të dedikuar.

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

Referenca: germa (c)(i) e nenit 17(9)

2.1.1.2. Treguesit

Referenca: germa (e)(ii) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia Matëse	Objektivi i ndërmjetëm (2024)	Objektivi (2029)
2	RSO2.4	RCO83	Strategjitë dhe planet e veprimtë hartuara	strategji/plan veprimi	0	40

			bashkërisht			
2	RSO2.4	RCO116	Zgjidhjet e zhvilluara bashkërisht	zgjidhje	0	24
2	RSO2.4	RCO87	Organizatat që bashkëpunojnë në nivel ndërkufitar	organizata	0	466

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

Prioritet i	Objektiv i specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Baza	Viti referencë	Objektiv i (2029)	Burimi i të dhënave	Koment e
2	RSO2.4	RCR79	Strategjitë dhe planet e veprimit të përbashkëta që realizohen nga organizatat	strategji/plani veprimi i/e përbashkët	0.00	2021	32.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.4	RCR104	Zgjidhjet e përvetësuara ose të përmirësuara nga organizatat	zgjidhje	0.00	2021	22.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.4	PSI1	Organizatat me kapacitete institucionale të rritura për shkak të pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar	organizata	0.00	2021	326.00	Sistemi i monitorimit të programit	

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

Referenca: germa (e)(iii) e nenit 17(3), germa (c)(iv) e nenit 17(9)

Grupi kryesor i synuar i Interreg Euro-MED 21–27 përbëhet nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave. Së bashku me organet e tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave, ky grup bazë është grupi kryesor i synuar i programit. Lloji i institucionit publik të përfshirë mund të ndryshojë në varësi të fushës së ndërhyrjes dhe strukturës administrative të çdo vendi. Veprimet kryesore synojnë përforcimin e aftësive të administratorëve publikë për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në funksion të politikave më koherente dhe të integruara.

Përveç grupit të synuar kryesor, synohen edhe organizata të tjera, për rolin dhe rëndësinë e tyre në mbështetjen e tranzicionit të gjelbër.

Përfshirja e strukturave që punojnë në nivel territorial si agjencitë e mjedisit, agjencitë e energjisë, shoqatat e mbrojtjes së mjedisit, organet që merren me menaxhimin e burimeve natyrore, departamentet e turizmit të autoriteteve vendore, rajonale dhe kombëtare, agjencitë turistike dhe organizatat e turizmit, Grupet e Veprimit Vendor LEADER, është thelbësore për arritjen e rezultateve të pritshme në kuadrin e këtij objekti specifik.

Operatorët privatë si NVM-të dhe organizatat mbështetëse të biznesit (p.sh. agjencitë e novacionit, dhomat e tregtisë, grupimet etj.) janë grupe kryesore të synuara për të ndihmuar transformimin në ekonomi novatore dhe të qëndrueshme.

Në mbështetje të tranzicionit drejt novacionit dhe qëndrueshmërisë mjedisore, edhe universitetet dhe qendrat kërkimore janë grupe të rëndësishme të synuara në të gjitha prioritetet e programit, sepse ofrojnë njohuri dhe ekspertizë dhe janë urë lidhëse midis praktikës dhe politikave.

Mësimi që nxorëm nga periudha e programimit 2014–2020 ishte se pasja si grupe të synuara të rrjeteve dhe organizatave të orientuara drejt tematikave mund të sigurojë ndikim të politikëbërësit e synuar dhe të shumëfishojë efektet në mobilizimin e aktorëve të tjerë kyç.

Qytetarët, komunitetet vendore dhe shoqatat, janë një tjetër objektivi i programit që mund të përvetësojë dhe të përfitojë nga zgjidhjet novatore të realizuara, por edhe nga veprimet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit që janë në gjendje të ndryshojnë sjelljet socio-ekonomike.

Përveç kësaj panorame globale të aktorëve/organeve kryesore që synon programi, secili objektivi specifik dhe lloj projektesh mund të fokusohet në një grup më të kufizuar të këtyre grupeve të synuara.

Ndër grupet e synuara për ndërhyrje në prioritetin 2 dhe në objektivin specifik “Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore dhe rezistencës, duke pasur parasysh qasjet e bazuara në ekosistem”, janë:

- Autoritetet vendore, rajonale dhe kombëtare (departamenti i mjedisit, departamenti i energjisë, departamentet e zhvillimit ekonomik, departamenti i planifikimit dhe parashikimeve, departamenti i transportit etj.);

- organizata/agjencitë e menaxhimit të mjedisit, agjencitë e menaxhimit të turizmit;
- organizatat/organet e menaxhimit të energjisë;
- universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore;
- NVM-të dhe operatorët ekonomikë (peshkatarët, hotelet etj.);
- qytetarët/OJF-të/ komunitetet dhe shoqatat vendore;
- grupet vendore të veprimit LEADER (GVV).

Përveç grupeve të synuara, autoritetet dhe organizatat e lartpërmendura mund të përfshihen drejtpërdrejt në operacione si përfitues aktivë (partnerë projekti) ose të lidhur.

Detaje të mëtejshme mbi përfituesit e pranueshëm të projekteve dhe natyrën e përfshirjes së këtyre grupeve të synuara në projekte do të specifikohen në termat e referencave të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.4 Territorët specifike të synuara, duke përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

Referenca: germa (e)(iv) e nenit 17(3)

Territorët specifike që synon programi janë në përputhje me gjeografinë e Euro-MED 21–27 dhe, madje hollësisht, me shtrirjen e programit në një grup rajonesh të reja që nuk kanë domosdoshmërisht dalje në det. Konteksti i ri territorial nënkupton marrjen parasysh jo vetëm të zonave bregdetare, por edhe të zonave tokësore/të brendshme. Vëmendja që i kushtohet si detit ashtu dhe tokës, si dhe ndjekjes së një qasjeje të integruar dhe të bazuar në ekosistem mund të luajë rol të rëndësishëm në arritjen e tranzicionit të gjelbër në zonën mesdhetare, aq më tepër duke vepruar në lloje të ndryshme territoresh, duke marrë parasysh lidhjet ekzistuese midis këtyre habitateve.

Në aspektin e përgjithshëm, zonat bregdetare dhe detare janë fokusi kryesor i fushave të ndërhyrjes.

Zonat bregdetare vazhdojnë të jenë sfidë kryesore për programin, sepse përballen me presione të forta nga aktiviteti njerëzor dhe urbanizimi i dendur. Zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike (rritja e nivelit të detit, erozioni bregdetar etj.) bashkë me zhvillimin e qëndrueshëm përbëjnë objektivat kryesorë për këtë zonë. Baraspesha midis aktiviteteve ekonomike dhe mbrojtjes së mjedisit është thelbësore për këto territore. Edhe ndryshimet klimatike janë një sfidë e zakonshme për zonat rurale, malore dhe/ose me dendësi popullore të ulët. Zonat malore përballen me rritje të rreziqeve natyrore, që vënë në rrezik banorët dhe infrastrukturën vendore. Këto lloj territoresh janë të rëndësishme edhe për vlerat e tyre mjedisore, falë pyjeve, burimeve të ujit dhe rolit në ruajtjen e karbonit.

Programi synon të përforcojë veprimet që adresojnë ishujt, zonat e cenueshme që preken më shumë nga fatkeqësitë natyrore dhe janë më të ndjeshme ndaj problematikave të furnizimit me energji dhe menaxhimit të ujit dhe mbetjeve.

Së fundi, një tjetër territor i rëndësishëm i synuar nga programi është zona urbane, që është qendra e ardhshme për zbatimin e politikave të gjelbra transnacionale, përveç ndërlidhjes me zonat periferike dhe rurale.

Territoret e synuara mund të ndryshojnë, nisur nga lloji i projektit dhe objektivi specifik. Për objektivat specifike me qasje tematike ndërsektoriale, përfshihen shumica e territoreve.

Specifikisht, ndër grupet e synuara për ndërhyrjet në prioritetin 2 dhe objektivin specifik “Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore dhe rezistencës, duke pasur parasysh qasjen e bazuara në ekosistem”, territoret e synuara janë:

- zonat bregdetare/detare;
- ishujt;
- zonat rurale dhe malore;
- zonat urbane.

Ky objektiv specifik mbulon të gjithë zonën e programit dhe të gjitha llojet e territoreve. Në rastin e aktiviteteve që fokusohen në lloje të synuara territoresh, mund të specifikohen kriteret më të hollësishme për territoret e pranueshme në termat e referencës të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Referenca: germa (e)(v) e nenit 17(3)

Nuk zbatohet për programin Euro-MED

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Referenca: germa (e)(vi) e nenit 17(3), germa (c)(v) e nenit 17(9)

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.4.	Fondet Interreg	061. Parandalimi dhe menaxhimit i riskut për rreziqet që nuk lidhen me klimën (p.sh. tërmetet) dhe rreziqet e aktivitetit njerëzor (p.sh. aksidentet teknologjike), përfshirë ndërgjegjësimin, mbrojtjen civile dhe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive dhe infrastrukturave si dhe qasjet e bazuara në ekosistem	29,403,014.00
2	RSO2.4.	Fondet Interreg	060. Masa për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimin e menaxhimit të rreziqeve që lidhen me klimën: të tjera, p.sh. stuhitë dhe thatësira (përfshirë ndërgjegjësimin, mbrojtjen civile dhe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive dhe infrastrukturave si dhe qasjet e bazuara në ekosistem).	29,403,014.00

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.4	Fondet Interreg	01. Grant	58,806,028.00

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.4.	Fondet Interreg	33. Qasje të tjera – pa territor të synuar	58,806,028.00

2.1.1 Objektivi specifik: RSO 2.6. Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me efikasitet të burimeve

Referenca: germa (e) e nenit 17(3)

Kontribut aktiv drejt zbatimit të Planit të Veprimit të BE-së për Ekonominë Qarkulluese dhe promovimit të modeleve dhe mjeteve të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm është realizuar nga

komunitet tematik i Rritjes së Gjellbër gjatë 2014–2020. Në këtë OS të dedikuar, puna do të konsolidohet për të mbështetur territoret që të bëjnë kalim efektiv dhe të qëndrueshëm në ekonominë qarkulluese.

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

Referenca: germa (e)(i) e nenit 17(3), germa (c)(ii) e nenit 17(9)

MBËSHTETJA E KALIMIT NË EKONOMINË QARKULLUESE

Sistemi aktual i prodhimit ndjek modelin linear “merrni-bëni-përdorni-hidhni”, ku pjesa më e lartë e ndikimit të produkteve në mjedis përcaktohet që në fazën e dizenjimit. Ky model, jo vetëm që rrit konsumin e burimeve natyrore duke rezultuar në mbishfrytëzimin dhe efekte negative nga nxjerrja dhe përpunimi i tyre, por shkakton rritje të vazhdueshme të mbetjeve, duke sjellë ndikim madhor në planetin tonë.

Për të ndryshuar këtë prirje dhe për të përmbushur ambiciet klimatike të BE-së, është e nevojshme të përshpejtohet kalimi drejt sistemeve të prodhimit qarkulluese. Ekonomia qarkulluese është një model i rritjes rigjeneruese që rikoncepton përdorimin e burimeve, me synimin që të eliminojë gjenerimin e mbetjeve dhe të mbajë në përdorim produktet, pajisjet dhe infrastrukturën për një kohë më të gjatë. Kjo krijon mundësi të reja për zhvillimin e biznesit dhe prodhimin e mallrave e shërbimeve, si dhe gjen zgjidhje novatore për të rikonceptuar mënyrën sesi funksionon ekonomia jonë.

Menaxhimi i mbetjeve luan rol vendimtar në modelin e ekonomisë qarkulluese, pasi ndërlikohet rreptësisht me modelet e prodhimit dhe konsumit dhe duhet të bëhet pjesë integrale e modelit. Dy sfida kryesore për të ardhmen, që përmenden nga Njësia e Parashikimit Shkencor të Parlamentit të BE-së, janë: i) reduktimi i niveleve të gjenerimit të mbetjeve; dhe ii) përafrimi i objektivave të menaxhimit të mbetjeve me ato të ekonomisë qarkulluese. Për të arritur këta objektiva, sektori i menaxhimit të mbetjeve duhet të bëhet partner kyç në zhvillimin e modeleve novatore të biznesit me objektiva si për parandalimin e mbetjeve, ashtu edhe për kthimin e mbetjeve në burim.

Koncepti i ekonomisë qarkulluese lidh shumë faktorë të ndryshëm që janë të ndërlidhur me menaxhimin e mbetjeve, të tilla si nënproduktet (jo domosdoshmërisht mbetje), përdorimi dhe transformimi i mbetjeve në cikle prodhuese (p.sh. si materiale), ripërdorimi i ujit, simbioza industriale, bashkëgjenerimi etj., aspekte këto që ia vlen të konsiderohen, me qëllim që të harmonizohen zgjidhjet e ekonomisë qarkulluese.

Ndërgjegjësimi, informimi dhe angazhimi i qytetarëve dhe autoriteteve vendore janë thelbësore për të nxitur riciklimin e mbetjeve dhe futjen e alternativave të qëndrueshme dhe qarkullueshme në ciklet e produkteve dhe shërbimeve. Për të garantuar kalim të suksesshëm, praktikën dhe politikat për ekonominë qarkulluese duhet të lidhen dhe të punojnë në sinergji, ndërsa palët e interesuara duhet të forcojnë bashkëpunimin e tyre përgjatë të gjithë zinxhirit të vlerës, në mënyrë që të sigurojnë këtë qarkullim të produkteve dhe shërbimeve. Kjo qasje do të përfitonte ndjeshëm nga kontributi i industrive kulturore dhe krijuese dhe do t'i përshtatet sektorit të turizmit.

Kjo mund të përmirësohet veçanërisht përmes kontributit të projekteve në EUSAIR, sepse kjo temë mund të lidhet me shtyllën 1 “Rritja Blu” dhe me shtyllën 4 “Turizmi i qëndrueshëm”. Praktikën e futura nëpërmjet zbatimit të modeleve të ekonomisë qarkulluese mund të mbështesin novacionin për një menaxhim më të qëndrueshëm të turizmit ose një sektor më dinamik të prodhimit detar. Gjithashtu, ky objektiv mund të kontribuojë në nismën WestMed, specifikisht dhe në mënyrë më specifike me prioritetin referuar Prodhimit dhe Konsumit të Qëndrueshëm (përfshirë transportin detar, portet, turizmin detar dhe bregdetar dhe akuakulturën detare).

Veprimet në këtë prioritet lidhen me objektivat prioritarë tematikë dhe ndërsektorialë të BlueMed, siç parashikohet në planin e zbatimit të nismës BlueMed dhe veçanërisht me ato që mbështesin zgjidhjet për prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm të ushqimit nga deti dhe që ndihmojnë në kalimin nga ekonomia tradicionale detare në aktivitetet e rritjes blu.

Meqenëse ekonomia qarkulluese është çështje ndërsektoriale që lidhet ngushtë me realizimin e Paktit të Gjellbër të BE-së dhe nismave në Mesdhe, pritët të përfshihet fuqishëm brenda prioritetëve

të strategjive dhe programeve të ardhshme, në të cilat rezultatet e projekteve MED 2021–2027 do të kontribuojnë efektivisht. Ky është rasti për shembull me EUSALP AG 2, përmes Hapësirës Alpine, prioriteti 2, OS “Promovimi i kalimit drejt ekonomisë qarkulluese”

Ky kontribut tashmë ka filluar të realizohet në periudhën e programimit 2014–2020, nëpërmjet pjesëmarrjes në Grupin e Punës për Mjedisin të Unionit për Mesdheun, si dhe në grupin bazë të platformës “Ekonomia qarkulluese e BE-së”, duke i hapur rrugë integritetit konkret në strategjitë dhe planet e veprimit të së ardhmes.

Kalimi drejt ekonomisë qarkulluese në Mesdhe do të rezultojë në më pak efekte negative të aktiviteteve ekonomike në mjedisin tonë dhe në sisteme prodhimi më të qëndrueshme, me vëmendje të dedikuar në sektorin agroushqimor dhe të peshkimit që mbizotërojnë në territor. Objektivi përfundimtar është ndërtimi i rezistencës afatgjatë dhe krijimi i mundësive të reja ekonomike, nga të cilat përfiton shoqëri në përgjithësi, për sa u përket si mundësive për biznesin, ashtu edhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve.

Ky objektivi do të kontribuojë veçanërisht në misionet operationale 1 dhe 4 të programit.

Objektivat

- Reduktimi i ndikimit në mjedis të sistemit aktual linear të prodhimit në sektorë kyç si bujqësia, ushqimi dhe peshkimi, si dhe në sektorin e turizmit.

- Promovimi i parandalimit, reduktimit dhe rikuperimit ekonomik të mbetjeve, përfshirë rritjen ndërgjegjësimit dhe angazhimit të konsumatorëve.

- Rritja e bashkëpunimit dhe kapaciteteve të palëve të interesuara për mbylljen e boshllëqeve dhe mbështetjen e kalimit drejt modelit qarkullues.

në një model rrethor.

Rezultatet e pritshme

- Qëndrueshmëri e përmirësuar e produkteve dhe rezistencë e rritur e sektorëve ekonomikë;

- Praktikë qarkulluese dhe të qëndrueshme vihen në zbatim për të mundësuar parandalim efektiv, reduktim dhe rikuperim ekonomik të mbetjeve.

- Bashkëpunim i rritur ndërmjet palëve të interesuara në të gjithë zinxhirin e vlerës së menaxhimit të mbetjeve, përfshirë angazhimit të qytetarëve /konsumatorëve.

- Strategjitë e ekonomisë qarkulluese hartohen dhe miratohen, përfshirë integrimin e qarkullimit në politikat ekzistuese.

Llojet indikative të veprimeve

- Mbështetja dhe promovimi i qarkullueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së produkteve dhe sistemeve të prodhimit, përfshirë modelet ekonovatore të biznesit për mbylljen e boshllëqeve, në sektorë si bujqësia, ushqimi dhe peshkimi, shëndetësia dhe manifaktura;

- Mbështetja e praktikave të qëndrueshme për reduktimin dhe parandalimin e mbetjeve, duke adresuar gjenerimin e mbetjeve dhe paketimin e tepërt – me fokus te plastika;

- Nxitja e rikuperimit të vlerës ekonomike të mbetjeve dhe shndërrimi i tyre në burim;

- Mbështetja dhe promovimi i praktikave qarkulluese dhe të qëndrueshme në sektorët e turizmit dhe industrive kulturore dhe krijuese;

- Promovimi i angazhimit të konsumatorëve dhe ndërgjegjësimit – përfshirë në sektorin e turizmit;

- Mbështetja e nismave që kanë të bëjnë me lidhjen ujë-energji-ushqim;

- Mbështetja e autoriteteve publike në hartimin dhe miratimin e strategjive për kalimin në ekonomi qarkulluese;

- Promovimi i zinxhirëve të vlerave vendore, veçanërisht në ishuj dhe territore të largëta, për të reduktuar varësinë nga transporti i mallrave (me përfitimin edhe të uljes së ndotjes) dhe për të ofruar mundësi tregu të lidhura edhe me turizmin.

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”, pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim mjedisor negativ të konsiderueshëm, për shkak të natyrës së tyre. Lidhur me veprimet pilot në projektet e testimit që përqendrohen tek infrastruktura e shkallës së vogël dhe pajisjet, projektet duhet të demonstrojnë në formularin e aplikimit se respektojnë parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”. Kjo do të vlerësohet gjatë

procesit të përzgjedhjes dhe do të monitorohet gjatë zbatimit të projektit përmes një mekanizmi monitorues të dedikuar.

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

Referenca: germa (c)(i) e nenit 17(9)

2.1.1.2 Treguesit

Referenca: germa (e)(ii) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Objektivi i ndërmjetëm (2024)	Objektivi (2029)
2	RSO2.6	RCO87	Organizatat që bashkëpunojnë në nivel ndërkufitar	organizata	0	359
2	RSO2.6	RCO83	Strategjitë dhe planet e veprimit të hartuara bashkërisht	strategji/plan veprimi	0	29
2	RSO2.6	RCO116	Zgjidhjet e zhvilluara bashkërisht	zgjidhje	0	18

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

Prioriteti	Objektivi i specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Baza	Viti referencë	Objektivi i (2029)	Burimi i të dhënave	Komentet
2	RSO2.6	RCR79	Strategjitë dhe planet e veprimit të përbashkëta që realizohen nga organizatat	strategjitë / plane veprimi të përbashkëta	0.00	2021	23.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.6	RCR104	Zgjidhjet e realizuara apo të përmirësuara nga organizatat	zgjidhje	0.00	2021	16.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.6	PSI1	Organizata me kapacitete institucionale të rritura për shkak të pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar	organizata	0.00	2021	251.00	Sistemi i monitorimit të programit	

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

Referenca: germa (e)(iii) e nenit 17(3), germa (c)(iv) e nenit 17(9)

Grupi kryesor i synuar i Interreg Euro-MED 21–27 përbëhet nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave. Së bashku me organet e tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave, ky grup bazë është grupi kryesor i synuar i programit. Lloji i institucionit publik të përfshirë mund të ndryshojë në varësi të fushës së ndërhyrjes dhe strukturës administrative të çdo vendi. Veprimet kryesore synojnë përforcimin e aftësive të administratorëve publikë për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në funksion të politikave më koherente dhe të integruara.

Në kontekstin e ekonomisë qarkulluese, autoritetet publike do të kenë një rol vendimtar për të luajtur në konceptimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit – si organe përgjegjëse për

zbatimin e strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm në nivelin e tyre (vendor/rajonar/kombëtar), do të kenë qëllim kryesor integrimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese në politikat e tyre. Autoritetet publike do të inkurajohen ta bëjnë këtë nëpërmjet planeve të veprimit të hartuara nga projektet në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës të ekonomisë qarkulluese, duke mbështetur tranzicionin e gjelbër në përgjithësi.

Kryesisht, organet e sektorit privat dhe në veçanti SME-të dhe organizatat mbështetëse të biznesit (p.sh. agjencitë e inovacionit/sektoriale, dhomat e tregtisë, grupet...) janë grupet kryesore të synuara – operatorët ekonomikë do të kenë një rol vendimtar për të luajtur në kontributin në këto zgjidhje, veçanërisht në sektorët p.sh. turizmi dhe agroushqimore (duke përfshirë peshkimin dhe akuakulturën), për të mbështetur transformimin drejt ekonomisë novatore dhe të qëndrueshme.

Në radhë të parë, sektori privat dhe veçanërisht NVM-të dhe organizatat mbështetëse të biznesit (p.sh. agjencitë e novacionit, dhomat e tregtisë, grupimet etj.) janë grupe kryesore të synuara; operatorët ekonomikë do të kenë rol thelbësor për të luajtur me kontributin e tyre në këto zgjidhje, kryesisht në sektorë si turizmi dhe ai agroushqimor (përfshirë peshkimin dhe akuakulturën), për të mbështetur transformimin drejt ekonomisë novatore dhe të qëndrueshme.

Në mbështetje të tranzicionit drejt novacionit dhe qëndrueshmërisë mjedisore, edhe universitetet dhe qendrat kërkimore janë grupe të rëndësishme të synuara në të gjitha prioritetet e programit, sepse ofrojnë njohuri dhe ekspertizë dhe janë urë lidhëse midis praktikës dhe politikave.

Mësimi që nxorëm nga periudha e programimit 2014–2020 ishte se pasja si grupe të synuara të rrjeteve dhe organizatave të orientuara drejt tematikave mund të sigurojë ndikim të politikëbërësit e synuar dhe të shumëfishojë efektet në mobilizimin e aktorëve të tjerë kyç.

Qytetarët, komunitetet vendore dhe shoqatat, janë një tjetër objektivi i programit që mund të përfitojë dhe të përfitojë nga zgjidhjet novatore të realizuara, por edhe nga veprimet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit që janë në gjendje të ndryshojnë sjelljet socio-ekonomike dhe vënies në zbatim të modeleve të ekonomisë qarkulluese në shoqërinë tonë.

Specifikisht, ndër grupet e synuara për ndërhyrjet në Prioritetin 2.6 *Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me efikasitet të burimeve*, janë:

- Autoritetet vendore, rajonale dhe kombëtare, veçanërisht agjencitë sektoriale të tyre;
- NVM-të dhe operatorët ekonomikë;
- Organizatat e mbështetjes së biznesit;
- Universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore;
- Shoqëria civile/OJF-të/komunitetet vendore dhe shoqatat.

Përveç grupeve të synuara, autoritetet dhe organizatat e lartpërmendura mund të përfshihen drejtpërdrejt në operacione si përfitues aktivë (partnerë projekti) ose të lidhur.

Detaje të mëtejshme mbi përfituesit e pranueshëm të projekteve dhe natyrën e përfshirjes së këtyre grupeve të synuara në projekte do të specifikohen në termat e referencave të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.4. Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

Referenca: germa (e)(iv) e nenit 17(3)

Nuk ka asnjë dallim të veçantë që duhet pasur parasysh në lidhje me territoret që mund të përfitojnë nga ndërhyrjet në kuadrin e prioritetit 2 dhe objektivit specifik (vi) *Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me efikasitet të burimeve*, dhe përfshihen të gjitha territoret:

- zonat bregdetare/detare;
- ishujt;
- zonat rurale dhe malore;
- zonat urbane.

Ky objektivi specifik si prioritet ndërsektorial mbulon të gjithë zonën e programit dhe të gjitha llojet e territoreve të përfaqësuara. Vërtet që çdo territor mund të përfitojë shumë nga koncepti i ekonomisë qarkulluese, sepse favorizon zhvillimin vendor dhe rezistencën territoriale.

Ishujt janë një shembull i spikatur sesi modelet e ekonomisë qarkulluese mund të jenë të suksesshme në arritjen e tranzicionit të gjelbër, duke iu përgjigjur sfidave të tyre specifike territoriale. Menaxhimi i burimeve natyrore, ekosistemet ekonomike e sociale dhe kufizimet e mundësitë vendore të lidhura me dimensionin e izoluar të ishujve, i bëjnë ato parësore për zbatimin dhe zbatimin e qasjeve të reja qarkulluese. Si rrjedhojë, ato janë natyrshëm një nga territoret e synuara më të rëndësishme të mjeteve dhe praktikave të zhvilluara nga projektet.

Rast i ngjashëm janë edhe territoret e konsideruara si “të largëta”, të cilat përballen me sfida të krahueshme territoriale për shkak të varësisë ndaj qendrave kryesore ekonomike - si të tilla, zonat rurale dhe malore mund të kenë potencial të fortë tërheqës që mund të mbështetet në zbatimin e qasjeve të ekonomisë qarkulluese që optimizojnë burimet vendore dhe natyrore.

Nga ana tjetër, në zonat urbane, autoritetet publike në veçanti do të kenë rol vendimtar për të luajtur në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese, pasi qytetet varen shumë nga burimet e jashtme për të përmbushur kërkesat e qytetarëve të tyre, si dhe njëkohësisht gjenerojnë sasinë më të madhe të mbetjeve. Si rrjedhojë, ndikimi i ekonomisë qarkulluese ka potencial të madh në mbështetjen e tranzicionit drejt një ekonomie më të gjelbër, në adresimin e këtyre faktorëve me një qasje më të qëndrueshme dhe rezistente.

Në territoret bregdetare në veçanti, qasja e ekonomisë qarkulluese do të ndihmojë në përmirësimin e ekuilibrit midis dinamizmit ekonomik dhe valorizimit të burimeve në sektorë kyç si turizmi dhe ekonomia blu, ku kërkohet angazhimi i bizneseve vendore (përfshirë NVM-të).

Në rast të aktiviteteve që fokusohen në lloje terriroresh, identifikimi i mëtejshëm i terrirove mund të specifikohet në termat e referencës të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Referenca: germa (e)(v) e nenit 17(3)

Nuk zbatohet për programin Euro-MED

2.1.1.6 Zbërthimi i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Referenca: germa (e)(vi) e nenit 17(3), germa (c)(v) e nenit 17(9)

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.6.	Fondet Interreg	075. Mbështetje për procese prodhimi miqësore me mjedisin dhe efikasitet të burimeve në NVM-të	24,050,000.00
2	RSO2.6.	Fondet Interreg	071. Promovimi i përdorimit të materialeve të riciklueshme si lëndë e parë	24,050,000.00

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.6.	Fondet Interreg	01. Grant	48,100,000.00

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.6.	Fondet Interreg	33. Qasje të tjera – pa territor të synuar	48,100,000.00

2.1.1 Objektivi specifik: RSO2.7. Forcimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë në zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes

Referenca: germa (e) e nenit 17(3)

Nën këtë OS, mbrojtja dhe restaurimi i ekosistemeve natyrore do të konsolidohet në Mesdhe, duke kontribuar kështu edhe në Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin 2020 dhe në Planin e Veprimit për Zero Ndotje, duke ndërmarrë veprime të promovuara nga komuniteti tematik “Mbrojtja e Biodiversitetit” në periudhën 2014–2020.

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit

Referenca: germa (e)(i) e nenit 17(3), germa (c)(ii) e nenit 17(9)

PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NATYRORE: FORCIMI I REZISTENCËS SË HABITATEVE NATYRORE

Disa aspekte politikash dhe zgjidhje janë adresuar në ombrellën e komunitetit tematik “Mbrotja e Diversitetit” gjatë periudhës 2014–2020, që mbulon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, qasjen e bazuara në ekosistem, si dhe mekanizmat e qeverisjes. Rekomandimet se si të reduktohet gjurma e aktiviteteve ekonomike të njeriut në mjedisin detar (si peshkimi, trafiku detar dhe portet...) kanë treguar rëndësinë e qasjeve të integruara për menaxhimin e habitateve natyrore.

Mjetet efektive monitoruese, menaxhuese dhe gjeohapësinore janë identifikuar dhe testuar në tema të ndryshme. Janë zhvilluar modele të përbashkëta qeverisjeje për të menaxhuar plazhet që kanë akumulime të *Posidonia oceanica*, për të reduktuar presionet mbi ekosistemet e brishta si ligatinat (kontrata e ligatinave), për të zbutur ndikimin e mbeturinave detare në kafshët e egra detare dhe në brigjet e Mesdheut. Janë promovuar veprime të përbashkëta për të angazhuar komunitetet vendore, peshkatarët ‘e vegjël’ dhe qytetarët shkencëtarë në monitorimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe presioneve njerëzore në zonat detare të mbrojtura.

Konsolidimi i mëtejshëm i këtij lloji aktiviteteve sigurohet brenda këtij objekti specifiku duke përmirësuar “rezistencën” e habitateve natyrore nëpërmjet përmirësimit të mbrojtjes, ruajtjes dhe restaurimit. Vëmendje i kushtohet konsolidimit të lidhjes midis ekosistemeve natyrore dhe forcimit të menaxhimit të tyre.

Lidhja transnacionale e ekosistemeve natyrore lejon harmonizimin në qasjen e monitorimit dhe menaxhimit, si dhe mbështetje të korridoreve ekologjike, të cilat janë thelbësore për të nxitur biodiversitetin dhe për të arritur objektivat globale dhe rajonale deri në vitin 2030 (Strategjia e BE-së për Biodiversitetin). Ndërveprimi midis zonave detare dhe tokësore është thelbësor për të ruajtur biodiversitetin dhe për të siguruar vazhdimësinë ekologjike.

Përveç forcimit të rrjetëzimit, zbatimi i zgjidhjeve ekzistuese bazuar në shkencë dhe në natyrë, si dhe restaurimi i habitateve natyrore të ndotura dhe të degraduara përbën një tjetër aset të këtij prioriteti.

Për më tepër, krijimi i modeleve të qeverisjes dhe vendosja e marrëdhënieve afatgjata me palët përkatëse të interesit mundëson mbështetjen e miratimit të strategjive mjedisore si një shtytës kyç për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Aspekti kulturor shihet i lidhur ngushtë me ruajtjen e burimeve natyrore. Qëllimi është të lehtësohet lidhja midis trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe mënyrës për të përmirësuar një menaxhim të integruar të këtyre dy aseteve, në fusha konkrete dhe abstrakte (në vijim të dy programeve të mëparshme Interreg MED të zbatuara që nga viti 2007).

Ky objektivi specifik do të kontribuojë në veçanti në misionin operacional 2 të programit.

Objektivat

- Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Konsolidimi i lidhjes së ekosistemeve natyrore në nivel transnacional, duke siguruar korridore ekologjike për të rritur dhe ruajtur biodiversitetin;
- Rritja e qëndrueshmërisë dhe rezistencës së habitateve natyrore, duke siguruar rivendosjen e funksioneve natyrore;
- Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit të politikave/legjislacioneve mjedisore, duke siguruar lidhjet ndërmjet mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe shëndetit të qytetarëve.

Rezultatet e pritshme

- Rritje e zgjidhjeve të bazuara në natyrë dhe qasjeve të bashkëmenaxhimit për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- Lidhje të përmirësuara dhe zgjerim i zonave të mbrojtura në tokë dhe det;
- Rritje e zgjidhjeve për të rikthyer ekosistemet e degraduara në tokë dhe det, duke garantuar mjedis të shëndetshëm;

- Integrim të shërbimeve të biodiversitetit dhe ekosistemit në strategjitë territoriale, duke mbështetur ndërtimin e kapaciteteve dhe koordinimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm (publik/privat)

Llojet indikative të veprimeve

- Konsolidimi i lidhjes së ekosistemeve funksional:
- forcimi i lidhjeve transnacionale për të mbrojtur dhe restauruar më efektivisht zonat e mbuluara nga rrjeti *Natura 2000* dhe zonat detare të mbrojtura;
- zgjerimi i “infrastrukturave blu dhe jeshile” si rrjet zonash natyrore dhe gjysmë-natyrore me karakteristika të ndryshme mjedisore, të projektuara dhe të menaxhuara për të ofruar një gamë të gjerë shërbimesh ekosistemi;
- rritja e infrastrukturës së gjelbër dhe veprime për reduktimin e ndotjes, veçanërisht në zonat urbane/të banuara;
- forcimi i ndërveprimit tokë-det, duke mbështetur korridoret ekologjike në lloje të ndryshme peizazhesh.
- Përmirësimi i menaxhimit të ekosistemeve natyrore:
- lehtësimi i qasjeve të bazuara në ekosisteme dhe bashkëmenaxhim të burimeve natyrore (p.sh. peshkim i shkallës së vogël, ligatinat...);
- ndërtimi i qeverisjes shumëpalëshe me palët e interesit për të siguruar përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore (modelet e qeverisjes vendore);
- forcimi i monitorimit dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura ekzistuese dhe mbështetja e procesit të përcaktimit të zonave të reja dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare (në tokë dhe në det);
- mbështetja e autoriteteve publike në zbatimin e strategjive mjedisore në lidhje me aktorë të tjerë kyç të përfshirë;
- eksplorimi dhe promovimi i lidhjes/artikulimit midis trashëgimisë kulturore dhe natyrore, veçanërisht në fushat e ruajtjes së natyrës nën rrjetin evropian *Natura 2000*, duke promovuar kështu turizmin e qëndrueshëm
- Restaurimi/rikthimi i ekosistemeve të degraduara:
- rivendosja e funksioneve natyrore të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore: rivendosja e ekosistemeve të ujërave të ëmbla dhe funksioneve natyrore të lumenjve (liqenet, lumenjtë, ligatinat, digat) duke mbrojtur dhe rikthyer burimet e ndotura të ujit (përfshirë mjedisin e ndotur nga plastika).

Ky prioritet ka potencialin që të kontribuojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi me rezultatet e projekteve në EUSAIR, veçanërisht në lidhje me shtyllën 3 “Cilësia e Mjedisit”.

Ky Objektiv specifik në përputhje me objektivin 3 të nismës WESTMED, “administrim më i mirë e detit” dhe më specifikisht përmes prioritetit të tij për ruajtjen dhe restaurimin e habitateve detare dhe biodiversitetit.

Koordinimi me programin LIFE dhe në veçanti me nënprogramin mjedisor mund të konsolidohet, duke mbështetur Rrjetin Trans-Evropian të Natyrës, siç pritet nga Strategjia e BE-së për Biodiversitetin për vitin 2030.

Përdorimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj, si dhe zgjidhjet në infrastrukturën e gjelbër për një menaxhim të integruar të habitateve janë temë e përbashkët që adresohet edhe nga EUSALP. Ky kontribut tematik mund të eksplorohet përmes koordinimit me programin e Hapësirës Alpine, prioriteti 1 “Rajon rezistent ndaj klimës dhe i gjelbër”.

I njëjti koordinim parashikohet me Strategjinë e Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti me shtyllën 3 “*biodiversiteti, me qëllim mbrojtjen dhe rikthimin e pasurive natyrore të rajonit*” të Agjendës së Gjelbër të Ballkanit Perëndimor.

Sinergji mund të krijohen edhe me misionin e “Horizon Europe”, “Oqeani, detet dhe ujërat”, duke kontribuar në një nga fenerët e mundshëm të bazuar në zonë që fokusohet te mikroplastika në Mesdhe.

Programi pritet të kontribuojë në avancimin e nismave kyçe, duke siguruar vazhdimësi të bashkëpunimeve ekzistuese të ngritura gjatë periudhës 2014–2020. Me këtë qëllim, koordinimi me Unionin për Mesdheun dhe Agjenda 2030 për një Mesdhe më të Gjelbër konsiderohet i rëndësishëm

për të identifikuar sfidat e përbashkëta dhe sinergjitë e mundshme në mbrojtjen e mjedisit bashkë me bregun jugor të Mesdheut.

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”, pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim mjedisor negativ të konsiderueshëm, për shkak të natyrës së tyre. Lidhur me veprimet pilot në projektet e Testimit që përqendrohen te infrastruktura e shkallës së vogël dhe pajisjet, projektet duhet të demonstrojnë në formularin e aplikimit se respektojnë parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”. Kjo do të vlerësohet gjatë procesit të përzgjedhjes dhe do të monitorohet gjatë zbatimit të projektit përmes një mekanizmi monitorues të dedikuar.

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit

Referenca: germa (c)(i) e nenit 17(9)

2.1.1.2 Treguesit

Referenca: germa (e)(ii) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Tabela 2 – Treguesit e produkteve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia Matëse	Objektivi i ndërmjetëm (2024)	Objektivi (2029)
2	RSO2.7	RCO83	Strategjitë dhe planet e veprimit të hartuara bashkërisht	strategji/plan veprimi	0	29
2	RSO2.7	RCO116	Zgjidhjet e zhvilluara bashkërisht	zgjidhje	0	18
2	RSO2.7	RCO87	Organizatat që bashkëpunojnë në nivel ndërkufitar	organizata	0	359

Tabela 3 – Treguesit e rezultateve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia Matëse	Baza	Viti referencë	Objektivi i (2029)	Burimi i të dhënave	Komentet
2	RSO2.7	RCR79	Strategjitë dhe planet e veprimit të përbashkëta që realizohen nga organizatat	strategjitë / plane veprimi të përbashkëta	0.00	2021	23.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.7	PSI1	Organizatata me kapacitete institucionale të rritura për shkak të pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar	zgjidhje	0.00	2021	251.00	Sistemi i monitorimit të programit	
2	RSO2.7	RCR104	Zgjidhjet e realizuara apo të përmirësuara nga organizatat	organizata	0.00	2021	16.00	Sistemi i monitorimit të programit	

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

Referenca: germa (e)(iii) e nenit 17(3), germa (c)(iv) e nenit 17(9)

Grupi kryesor i synuar i Interreg Euro-MED 21–27 përbëhet nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave. Së bashku me organet e tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave, ky grup bazë është grupi kryesor i synuar i programit. Lloji i institucionit publik të përfshirë mund të ndryshojë në varësi të fushës së ndërhyrjes dhe strukturës administrative të çdo vendi. Veprimet kryesore synojnë përforcimin e aftësive të administratorëve publikë për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në funksion të politikave më koherente dhe të integruara.

Përveç grupit të synuar kryesor, synohen edhe organizata të tjera, për rolin dhe rëndësinë e tyre në mbështetjen e tranzicionit të gjelbër.

Përfshirja e strukturave që punojnë në nivel territorial si agjencitë e mjedisit, agjencitë e energjisë, shoqatat e mbrojtjes së mjedisit, organet që merren me menaxhimin e burimeve natyrore, departamentet e turizmit të autoriteteve vendore, rajonale dhe kombëtare, agjencitë turistike dhe organizatat e turizmit, grupet e veprimit vendor LEADER, është thelbësore për arritjen e rezultateve të pritshme në kuadrin e këtij objekti specifik.

Operatorët privatë si NVM-të dhe organizatat mbështetëse të biznesit (p.sh. agjencitë e novacionit, dhomat e tregtisë, grupimet etj.) janë grupe kryesore të synuara për të ndihmuar transformimin në ekonomi novatore dhe të qëndrueshme.

Në mbështetje të tranzicionit drejt novacionit dhe qëndrueshmërisë mjedisore, edhe universitetet dhe qendrat kërkimore janë grupe të rëndësishme të synuara në të gjitha prioritetet e programit, sepse ofrojnë njohuri dhe ekspertizë dhe janë urë lidhëse midis praktikës dhe politikave.

Mësimi që nxorëm nga periudha e programimit 2014–2020 ishte se pasja si grupe të synuara të rrjeteve dhe organizatave të orientuara drejt tematikave mund të sigurojë ndikim të politikëbërësit e synuar dhe të shumëfishojë efektet në mobilizimin e aktorëve të tjerë kyç.

Qytetarët, komunitetet vendore dhe shoqatat, janë një tjetër objektivi i programit që mund të përvetësojë dhe të përfitojë nga zgjidhjet novatore të realizuara, por edhe nga veprimet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit që janë në gjendje të ndryshojnë sjelljet socio-ekonomike.

Përveç kësaj panorame globale të aktorëve/organeve kryesore që synon programi, secili objektivi specifik dhe lloj projektsh mund të fokusohet në një grup më të kufizuar të këtyre grupeve të synuara.

Ndër grupet e synuara për ndërhyrje në Prioritetin 2 dhe në Objektivin Specifik (vii) “Forcimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes”, janë:

- autoritetet vendore, rajonale dhe kombëtare (departamentet e mjedisit, departamentet e zhvillimit ekonomik...);
- organizata/agjencitë e menaxhimit të mjedisit;
- organizatat/organet e menaxhimit të zonave të mbrojtura;
- universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore;
- NVM-të dhe operatorët ekonomikë (peshkatarët, agjencitë turistike etj.);
- qytetarët/OJF-të/ komunitetet dhe shoqatat vendore;
- autoritetet, drejtuesit e zonave të mbrojtura ose ekspertët nga bregu jugor i Mesdheut, rrjetet e drejtuesve të zonave të mbrojtura;
- grupet vendore të veprimit LEADER (GVV).

Detaje të mëtejshme mbi përfituesit e pranueshëm të projekteve dhe natyrën e përfshirjes së këtyre grupeve të synuara në projekte do të specifikohen në termat e referencave të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

Referenca: germa (e)(iv) e nenit 17(3)

Territoret specifike që synon programi janë në përputhje me gjeografinë e Euro-MED 21–27 dhe, madje hollësisht, me shtrirjen e programit në një grup rajonesh të reja që nuk kanë domosdoshmërisht dalje në det. Konteksti i ri territorial nënkupton marrjen parasysh jo vetëm të zonave bregdetare, por edhe të zonave tokësore/të brendshme. Vëmendja që i kushtohet si detit ashtu dhe tokës, si dhe

ndjekjes së një qasje të integruar dhe të bazuar në ekosistem mund të luajë rol të rëndësishëm në arritjen e tranzicionit të gjelbër në zonën mesdhetare, aq më tepër duke vepruar në lloje të ndryshme territoresh, duke marrë parasysh lidhjet ekzistuese midis këtyre habitateve.

Në aspektin e përgjithshëm, zonat bregdetare dhe detare janë fokusi kryesor i fushave të ndërhyrjes. Zonat bregdetare vazhdojnë të jenë sfidë kryesore për programin, sepse përballen me presione të forta nga aktiviteti njerëzor dhe urbanizimi i dendur. Zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike (rritja e nivelit të detit, erozioni bregdetar etj.) bashkë me qasjen e integruar novatore që merr parasysh modelet e qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit, mund të sigurojnë një të ardhme më të mirë për zonën e Mesdheut. Baraspesha midis aktiviteteve ekonomike dhe mbrojtjes së mjedisit është thelbësore për këto territore. Ndryshimet klimatike janë një sfidë e zakonshme për zonat rurale, malore dhe/ose me dendësi popullore të ulët. Zonat malore përballen me rritje të rreziqeve natyrore, që vënë në rrezik banorët dhe infrastrukturën vendore. Këto lloje territoresh janë të rëndësishme edhe për vlerat e tyre mjedisore, falë pyjeve, burimeve të ujit dhe rolit në ruajtjen e karbonit.

Programi synon të përfshijë veprimet që adresojnë ishujt, zonat e cënueshme që preken më shumë nga fatkeqësitë natyrore dhe janë më të ndjeshme ndaj problematikave të furnizimit me energji dhe menaxhimit të ujit dhe mbetjeve.

Së fundi, një tjetër territor i rëndësishëm i synuar nga programi është zona urbane, që është qendra e ardhshme për zbatimin e politikave të gjelbra transnacionale, përveç ndërlidhjes me zonat periferike dhe rurale.

Territoret e synuara mund të ndryshojnë, nisur nga lloji i projektit dhe objektivi specifik. Për objektivat specifike me qasje tematike ndërsektoriale, përfshihen shumica e territoreve.

Për objektivin specifik (vii) *“Forcimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes”*, territoret e synuara janë:

- zonat bregdetare dhe detare (zonat detare të mbrojtura, ligatinat...);
- ishujt;
- zonat rurale dhe malore;
- zonat e brendshme (ligatinat në zona të brendshme, ujëra të ëmbël, lumenj, liqene, diga...).

Në rastin e aktiviteteve që fokusohen në lloje të synuara territoresh, mund të specifikohen kritere më të hollësishme për territoret e pranueshme në termat e referencës të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Referenca: germa (e)(v) e nenit 17(3)

Nuk zbatohet për programin Euro-MED

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes

Referenca: germa (e)(vi) e nenit 17(3), germa (c)(v) e nenit 17(9)

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.7.	Fondet Interreg	079. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit, trashëgimia natyrore dhe burimet, infrastruktura blu dhe e gjelbër	48,100,000.00

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.7.	Fondet Interreg	01. Grant	48,100,000.00

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
2	RSO2.6.	Fondet Interreg	33. Qasje të tjera – pa territor të synuar	48,100,000.00

2.1 Prioriteti: 3 – Qeverisja e MED

Referenca: germa (d) e nenit 17(3)

2.1.1 Objektivi specifik: ISO6.6. Veprime të tjera për të mbështetur më mirë qeverisjen e bashkëpunimit (të gjitha drejtimet)

Nën këtë OS, çështjet tematike me nivele të ndryshme politikash do të koordinohen më mirë dhe do të forcohen kapacitetet institucionale të autoriteteve mesdhetare në politikat publike transformuese, qeverisje dhe bashkëpunim. Do të forcohet koordinimi ndërmjet organeve shumë-nivelëshe, programeve, strategjive dhe nismave

2.1.1.1 Llojet e veprimeve dhe kontributi i tyre i pritshëm në ato objektiva specifike dhe në strategjitë makrorajonale dhe strategjitë e baseneve detare, sipas rastit.

Referenca: germa (e)(i) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Përshkrimi

Ky objektivi specifik synon të mbështesë kapitalizimin e rezultateve tematike duke krijuar kushte për sinergji dhe koordinim ndërmjet projekteve tematike në prioritetet 1 dhe 2 dhe duke zbatuar strategjitë e integritetit në politikat vendore, rajonale, kombëtare dhe evropiane. Gjithashtu, ky SO synon të mbështesë koordinimin transnacional midis autoriteteve/rrejtëve rajonale, kombëtare dhe evropiane dhe ndërmjet autoriteteve menaxhuese të bashkëpunimit territorial evropian, nismave dhe strategjive për të përmirësuar politikat specifike të zonës së Mesdheut. Për të përmbushur këtë objektivi, projektet nën këtë prioritet do të maksimizojnë valorizimin e rezultateve të projekteve dhe ndikimin e tyre plotësues në zonën e Mesdheut brenda secilit mision. Ky prioritet do të nxisë aktivitetet ndërlidhëse, do të forcojë punën/përpjekjet e koordinuara në nivel transnacional dhe do të zbatojë proceset integruese. Përfundimisht, do të krijojë kushte të favorshme për ndryshime në politika që të përmirësohet kohezioni territorial mesdhetar.

Objektivat

- Lehtësimi i shfrytëzimit dhe ripërdorimit të njohurive, përvojave dhe rezultateve të projektit ndaj palëve të tjera të interesuara për të kontribuar nëpërmjet sinergjive në të njëjtin mision;
- Lehtësimi i transferimit të rezultateve të tjera palë të interesuara, programe dhe territore si dhe integrimin e tyre në politikat vendore, rajonale, kombëtare dhe evropiane
- Rritja e koordinimit ndërmjet palëve të interesuara që mbulojnë Mesdheun (shumë-nivelësh, transnacional) bazuar në njohuritë, përvojat dhe rezultatet e përbashkëta.

Rezultatet e pritshme

- Qasje më e koordinuar për çështjet tematike me politikat vendore, rajonale, kombëtare dhe evropiane për shkak të rezultateve fuqizuese kolektive të projekteve Interreg Euro-MED;
- Kapacitete të rritura të institucionale të autoriteteve publike mesdhetare në politikat publike transformuese, qeverisje dhe bashkëpunim transnacional;
- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve/organeve dhe programeve rajonale, kombëtare dhe transnacionale që veprojnë në zonë, si dhe strategjitë dhe iniciativat.

Llojet indikative të veprimeve

Konceptimi, miratimi dhe zbatimi i mekanizmave për të lehtësuar shfrytëzimin dhe ripërdorimin e njohurive, përvojave dhe rezultateve të projektit ndaj palëve të tjera të interesuara për të kontribuar nëpërmjet sinergjive në të njëjtin mision:

- organizimi dhe shpërndarja e informacionit ndërmjet komuniteteve për të lehtësuar ripërdorimin e rezultateve ekzistuese të gjeneruara nga projektet Interreg (Euro-)MED;
- ngritja e proceseve të rishikimit mes kolegësh për të konsoliduar njohuritë e krijuara nga projektet;
- realizimi i analizave dhe nxitja e lidhjeve ndërmjet projekteve për të identifikuar njohuritë përkatëse të krijuara prej tyre që mund të shfrytëzohen dhe/ose të integrohen dhe të frymëzojnë sinergji ndërmjet projekteve;
- gjallërimi i komuniteteve të synuara rreth misionëve të programit që të krijohen kushte të favorshme për të zhvilluar sinergjitë ndërmjet projekteve dhe për të lehtësuar prodhimin dhe përditësimin e njohurive përkatëse;
- kombinimi i rezultateve për të rritur dukshmërinë e tyre dhe për të mundësuar shpërndarje dhe valorizim më të fortë të **përbashkët**.

Konceptimi, miratimi dhe zbatimi i proceseve për të lehtësuar transferimin e rezultateve të tjera palë të interesuara, programe dhe territore si dhe integrimin e tyre në politikat vendore, rajonale, kombëtare dhe evropiane:

- Realizimi i analizave për të identifikuar njohuritë dhe rezultatet e riprodhueshme dhe të përshatshme për qëllime transferimi dhe integrimi;
- Identifikimi i palëve të interesuara vendore, rajonale, kombëtare dhe evropiane për transferimin dhe integrimin e rezultateve në politika dhe gjallërimi i rrjeteve për të rritur shtrirjen e rezultateve;
- Organizimi i trajnimeve dhe shkëmbimi i përvojave për të rritur kapacitetin e partnerëve për të valorizuar, transferuar dhe integruar rezultatet;
- Zbatimi i kushteve për transferimin dhe reflektimin e rezultateve në politika ndërmjet palëve të interesuara dhe institucioneve dhënëse dhe marrëse;
- Krijimi dhe gjallërimi i rrjeteve të institucioneve marrëse dhe rritja e kapacitetit të tyre për të integruar rezultatet në politika.

Konceptimi, miratimi dhe zbatimi i protokolleve për të rritur koordinimin ndërmjet palëve të interesuara që mbulojnë Mesdheun (shumënivelësh, transnacional), bazuar në shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe **rezultateve**:

- Angazhimi aktiv i palëve të interesuara në rrjete specifike për të stimuluar koordinimin ndërmjet aktorëve vendorë dhe rajonalë nga shumë sektorë dhe nga shumë nivele brenda Euro-MED;
- Ngritja e mekanizmave për identifikimin dhe analizimin e mundësive të koordinimit brenda politikave kombëtare Euro-MED dhe jo Euro-MED (përfshirë partnerët jopartnerë të BE-së të Lindjes dhe Jugut);
- Promovimi i një vizioni të MED-it;
- Hartimi dhe zbatimi i planeve të përbashkëta të veprimit transnacional

Llojet e veprimeve janë vlerësuar si të përputhshme me parimin “mos bëni dëm të konsiderueshëm”, pasi nuk pritet të kenë ndonjë ndikim mjedisor negativ të konsiderueshëm, për shkak të natyrës së tyre.

2.1.1.1.b Përcaktimi i një përfituesi ose e një liste të kufizuar përfituesish dhe procedura e dhënies së grantit.

Referenca: germa (c)(i) e nenit 17(9)

2.1.1.2 Treguesit

Referenca: germa (e)(ii) e nenit 17(3), germa (c)(iii) e nenit 17(9)

Tabela 2. Treguesit e produkteve

Prioriteti	Objektivi specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Objektivi i ndërmjetëm (2024)	Objektivi (2029)
3	ISO6.6	RCO87	Organizatat që bashkëpunojë në nivel ndërkufitar	Organizata	0	91
3	ISO6.6	RCO116	Zgjidhjet e zhvilluara bashkërisht	zgjidhje	0	53

Tabela 3. Treguesit e rezultateve

Prioriteti	Objekti vi specifik	ID	Treguesi	Njësia matëse	Baza	Viti referencë	Objekti vi (2029)	Burimi i të dhënave	Koment
3	ISO6.6	RCR79	Zgjidhjet e realizuara apo të përmirësuara nga organizatat	zgjidhje	0.00	2021	27.00	Sistemi i monitorimit të programit	
3	ISO6.6	PSI1	Organizatave me kapacitete	organizata	0.00	2021	64.00	Sistemi i monitorimit të	

			institucionale të rritura për shkak të pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e bashkëpunimit ndërkufitar					programit	
--	--	--	--	--	--	--	--	-----------	--

2.1.1.3 Grupet kryesore të synuara

Referenca: germa (e)(iii) e nenit 17(3), germa (c)(iv) e nenit 17(9)

Grupi kryesor i synuar i Interreg Euro-MED 21–27 përbëhet nga autoritetet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave. Së bashku me organet e tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave, ky grup bazë është grupi kryesor i synuar i programit. Lloji i institucionit publik të përfshirë mund të ndryshojë në varësi të fushës së ndërhyrjes dhe strukturës administrative të çdo vendi. Veprimet kryesore synojnë përforcimin e aftësive të administratorëve publikë për përmirësimin e proceseve vendimmarrëse në funksion të politikave më koherente dhe të integruara në nivelet kombëtare dhe transnacionale.

Përveç grupit të synuar kryesor, synohen edhe organizata të tjera, për rolin dhe rëndësinë e tyre në koordinimin e veprimeve ndërmjet aktorëve të fushave dhe niveleve të ndryshme.

Nisur nga roli i projekteve në analizën e rezultateve tematike, qendrat kërkimore dhe universitetet kanë rol për të luajtur. E njëjta vlen për rrjetet e aktorëve që mund të jenë thelbësorë në integrimin e rezultateve në politika. Këto rrjete aktorësh mund të përbëhen nga aktorë politikë apo të shoqërisë civile të cilët shërbejnë si këshilltarë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi autoritetet rajonale dhe kombëtare.

Mësimi që nxorëm nga periudha e programimit 2014–2020 ishte se pasja si grupe të synuara të rrjeteve dhe organizatave të orientuara drejt tematikave mund të sigurojë ndikim të politikëbërësit e synuar dhe të shumëfishojë efektet në mobilizimin e aktorëve të tjerë kyç.

Specifikisht, grupet e synuara për *prioritetin “Qeverisja”*, janë:

- autoritetet rajonale dhe kombëtare (departamentet tematike);
- rrjetet e vendimmarrësve;
- agjencitë mjedisore, strukturat përgjegjëse për zonat e mbrojtura, agjencitë e energjisë, organizatat e mbështetjes së biznesit dhe rrjetet e tyre;
- universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore;
- OJF-të/komunitetet dhe shoqatat vendore.

Detaje të mëtejshme mbi përfituesit e pranueshëm të projekteve dhe natyrën e përfshirjes së këtyre grupeve të synuara në projekte do të specifikohen në termat e referencave të thirrjeve për projektpropozime të programit.

2.1.1.4 Territoret specifike të synuara, përfshirë përdorimin e planifikuar të ITI, CLLD ose instrumenteve të tjera territoriale

Referenca: germa (e)(iv) e nenit 17(3)

Nuk ka asnjë dallim të veçantë që duhet pasur parasysh në lidhje me territoret që mund të përfitojnë nga ndërhyrjet në kuadrin e prioritetit 2 dhe objektivit specifik (vi) *Promovimi i kalimit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me efikasitet të burimeve*, dhe përfshihen të gjitha territoret:

- zonat bregdetare/detare;
- ishujt;
- zonat rurale dhe malore;
- zonat urbane.

Ky objektiv specifik si prioritet ndërsektorial mbulon të gjithë zonën e programit dhe të gjitha llojet e territoreve të përfaqësuara.

2.1.1.5 Përdorimi i planifikuar i instrumenteve financiare

Referenca: germa (e)(v) e nenit 17(3)

Nuk zbatohet për programin Euro-MED

2.1.1.6 Zbërthimi indikativ i burimeve të programit të BE-së sipas llojit të ndërhyrjes
Referenca: germa (e)(vi) e nenit 17(3), germa (c)(v) e nenit 17(9)

Tabela 4. Dimensioni 1 – fusha e ndërhyrjes

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
3	ISO6.6.	Fondet Interreg	173. Forcimi i kapaciteteve institucionale të autoriteteve publike dhe palëve të interesuara që të zbatojnë nisma dhe projekte të bashkëpunimit territorial në një kontekst ndërkufitar, transnacional, detar dhe ndërrajonal	31,104,000.00

Tabela 5. Dimensioni 2 – forma e financimit

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
3	ISO6.6	Fondet Interreg	01. Grant	31,104,000.00

Tabela 6. Dimensioni 3 – mekanizmi i zbatimit territorial dhe fokusi territorial

Prioriteti	Objektivi specifik	Fondi	Kodi	Shuma (EURO)
3	ISO6.6	Fondet Interreg	33. Qasje të tjera – pa territor të synuar	31,104,000.000

3. Plani financiar

Referenca: germa (f) e nenit 17(3)

3.1 Alokimet financiare vjetore

Referenca: germa (g)(i) e nenit 17(3), germat (a) deri (d) të nenit 17(4)

Tabela 7

Fondet	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	Totali
Fonde Interreg	0.00	40,072,427.00	40,750,001.00	41,398,256.00	42,080,608.00	34,949,420.00	35,648,514.00	234,899,226.00
Totali	0.00	40,072,427.00	40,750,001.00	41,398,256.00	42,080,608.00	34,949,420.00	35,648,514.00	234,899,226.00

3.2 Totali i alokimeve financiare sipas fondeve dhe bashkëfinancimit kombëtar

Referenca: germa (f)(ii) e nenit 17(3), germat (a) deri (d) të nenit 17(4)

Tabela 8

Objektivi i politikës	Prioriteti	Fondet	Baza për llogaritjen e mbështetjes së BE-së (shpenzimet totale të pranueshme ose kontributi publik)	Kontributi i BE-së (a)=(a1)+(a2)	Zbërthimi indikativ i kontributit të BE-së		Kontributi kombëtar (b)=(c)+(d)	Zbërthimi indikativ i kontributit kombëtar		Totali (e)=(a)+(b)	Norma e bashkëfinancimit	Kontribute t nga vendet e treta
					pa AT sipas nenit 27(1)(a2)	për AT sipas nenit 27(1)(a2)		Kombëtar publik (c)	Kombëtar privat (d)			
1	1	Fonde Interreg	Totali	48,789,198.00	45,175,184.00	3,614,014.00	12,197,300.00	10,245,732.00	1,951,568.00	60,986,498.00	79.9999993441 %	0.00
2	2	Fonde Interreg	Totali	155,006,028.00	143,524,100.00	11,481,928.00	38,751,507.00	35,230,595.00	3,520,912.00	193,757,535.00	80.0000000000 %	0.00
6	3	Fonde Interreg	Totali	31,104,000.00	28,800,000.00	2,304,000.00	7,776,000.00	7,376,000.00	400,000.00	38,880,000.00	80.0000000000 %	0.00
	Totali	Fonde Interreg		234,899,226.00	217,499,284.00	17,399,942.00	58,724,807.00	52,852,327.00	5,872,480.00	293,624,033.00	79.9999998638 %	0.00
	Totali i përgjithshëm			234,899,226.00	217,499,284.00	17,399,942.00	58,724,807.00	52,852,327.00	5,872,480.00	293,624,033.00	79.9999998638 %	0.00

4. Veprimet e ndërmarra për të përfshirë partnerët e programit në përgatitjen e programit Interreg dhe roli i këtyre partnerëve programi në zbatim, monitorim dhe vlerësim

Referenca: germa (g) e nenit 17(3)

Çfarë veprimesh ka ndërmarrë Programi për të mundësuar pjesëmarrjen dhe kontributin e organizatave partnere të palëve të treta në hartimin e tij, në mënyrë që të përmbushen kërkesat

rregullatore të përcaktuara në nenin 6 të CPR-së? Për më tepër, cilat do të jenë veprimet e ardhshme për të lehtësuar kontributin e tyre në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e programit?

Së pari, është e rëndësishme të kujtojmë se Programi Mesdhetar Interreg, që nga krijimi i tij në vitin 2007, gjithmonë ka favorizuar pjesëmarrjen e të gjitha kategorive të organizatave partnere (publike ose private) që vijnë nga përfituesit potencialë.

Të gjitha veprimet informuese dhe komunikuese të kryera nga Programi që në periudhën e parë të programimit në lidhje me objektivat dhe rezultatet e tij, i janë drejtuar gjithmonë publikut sa më të gjerë.

Kështu, qindra përfitues të Interreg MED përfshijnë të gjitha llojet e organizatave si autoritetet kombëtare dhe vendore, universitetet, qendrat kërkimore, shoqatat, organizatat joqeveritare, organizmat ndërkombëtarë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, rrjetet e rrjeteve dhe çdo organ tjetër që përfaqëson shoqërinë civile.

Gjatë thirrjeve për projektpropozime dhe ndërtimit dhe përcaktimit të partneriteteve dhe sfidave të reja, opinionet e të gjitha këtyre strukturave mbi zbatimin dhe përmbajtjen e programit gjithmonë janë mbledhur dhe analizuar nëpërmjet anketave *ad hoc*, sondazheve të opinionit publik, vlerësimeve dhe takimeve me palët e interesuara.

Në dy periudha programimi, Interreg MED nuk ka reshtur asnjëherë së zhvilluari dhe përshtatur me kërkesat e brendshme dhe të jashtme, *duke dëgjuar* vazhdimisht zërin e përfituesve të vet.

Arkitektura, përmbajtja dhe objektivat e programit janë edhe rezultat i dialogut të vazhdueshëm midis autoriteteve të programit dhe aktorëve në terren, me një pjesëmarrje masive të Shteteve, Autoriteteve Menaxhuese dhe Sekretariateve të Përbashkëta në komitetet drejtuese, si dhe i takimeve institucionale të projekteve me partnerët e tyre.

Kjo përpjekje e konsiderueshme për shkëmbime brenda Programit lehtëson ndërgjegjësimin e vazhdueshëm mbi pritshmëritë dhe kritikën e partnerëve të palëve të treta, duke bërë të mundur që të paraprihen eksperimentet nga një periudhë në tjetrën.

Megjithatë, për përgatitjen e periudhës së programimit 2021–2027, janë realizuar disa aktivitete më specifike në këtë kontekst.

Gjatë pranverës 2020, një anketë e publikuar për dy muaj në faqen e internetit të programit mbledhi rreth 400 përgjigje. Rezultatet janë në faqen e internetit të programit. Anketa i dha zë çdo qytetari të interesuar për çështje të politikave të përgjithshme, si edhe ekspertëve të bashkëpunimit territorial, në veçanti të Interreg Euro-MED, përmes pyetjeve të hapura dhe/ose specifike në lidhje me temat dhe objektivat e përcaktuar në rregullore.

Kjo anketë mundësoi konfirmimin e propozimeve të para të AM/SP (qershor 2020) që u sollën në vëmendje të Task-Forcës (TF), veçanërisht në lidhje me objektivat strategjike që do të promovoheshin: novacioni (PO1), ndryshimet klimatike (PO2) dhe qeverisja (ISO1).

Versioni i parë i propozimit të plotë tematik u qarkullua ndër shtetet partnere të programit në verë 2020 (gusht-shtator), si një dokument konsultimi informal: partneritetet kombëtare, të konsultuara sipas modaliteteve të secilit vend, dërguan vërejtjet për t'u integruar në tekstin përfundimtar që iu nënshtrua procedurës së vlerësimit me shkrim nga TF në tetor 2020.

Njëkohësisht, i njëjti dokument informal ishte objekt konsultimi – edhe në verën e vitit 2020 – me përfaqësuesit e komuniteteve tematike të programit 2014–2020 dhe të aksit “Qeverisja”, duke bërë bashkë, në kuadër të programit, përfituesit e drejtpërdrejtë të projekteve si dhe partnerët e tyre të lidhur.

Ky konsultim i dyfishtë i kryer në verën e vitit 2020, pas anketës së *publikut të gjerë* në pranverë, i dha fjalën një numri të madh aktorësh që përfaqësojnë të gjitha llojet e organizatave nga Mesdheu, përpara finalizimit të versionit të parë mbi “arkitekturën dhe prioritetet” e programit.

Për më tepër, kjo punë përgatitore u pasurua me kontributet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të shkëmbimeve që Programi arriti të mbante me rrjete dhe organizata si Unioni për Mesdheun (UfM), Konferenca e Rajoneve Periferike dhe Detare (CPMR), *MedCities* apo me përfaqësues të Nismës së Basenit Detar *WestMed* dhe Komisionit Evropian.

Në fund, u organizuan uebinarë të hapur për partnerët e palëve të treta me rastin e evenimentit vjetor “E kaluara, e tashmja, e ardhmja” të programit Interreg MED 2014–2020 e cila u zhvillua në nëntor 2020, por edhe me përpikëri në shkurt–mars 2021.

Evenimenti synonte mbledhjen e opinioneve të reja, jo më në mënyrë globale, por bazuar në modelin e programit 2021–2027, i cili në ato ishte në proces hartimi.

Përfaqësuesit e organizatave publike dhe private nga të gjitha vendet që i përkasin Interreg Euro-MED 2021–2027 (përfshirë Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut pas zgjerimit të zonës së bashkëpunimit) u shprehën për prioritetet që do të zbatohen nga Programi pak para miratimit përfundimtar nga shtetet partnere në qershor 2021.

Dokumenti përfundimtar përmban edhe një sërë rekomandimesh që rezultuan si nga analiza specifike e të gjitha raporteve përfundimtare të projekteve gjatë 2014–2020 të dorëzuara në program para fundit të vitit 2020 (rreth 50), ashtu edhe nga raportet operacionale (raporti përfundimtar në mars 2020) dhe vlerësimet e ndikimit (raporti i ndërmjetëm në tetor 2020).

Në lidhje me rolin e parashikuar për partnerët e palëve të treta, janë parashikuar disa detyra apo misione në kuadër të aktiviteteve të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të programit.

Megjithatë, është e rëndësishme të kujtojmë natyrën transnacionale të programit dhe shtrirjen e tij nëpër vendet e bregut verior të Mesdheut dhe Ballkanit, duke përfaqësuar gjithsej 14 shtete: është e pamundur t’i garantohet zëri – në organet vendimmarrëse – çdo organi rajonal, vendor, urban, ekonomik apo social, qofshin publike apo private.

Për këtë arsye, parashikohen organet të ndërmjetme konsultimi dhe kohë/periudha konsultimi në nivel kombëtar dhe transnacional.

Në vazhdimësi të punës dhe metodologjive konsultuese të eksperimentuara që nga programimi 2007–2013 deri më sot, një vend themelor i kushtohet partneriteteve kombëtare. Këto organizohen nën përgjegjësinë e shteteve pjesëmarrëse në program, sipas modaliteteve të ndryshme nga një vend në tjetrin, sipas kriterëve që kanë të bëjnë me strukturën administrative (centralizimi, decentralizimi, rajonalizimi i kompetencave) dhe me numrin e aktorëve të pranishëm në territorin e interesuar për BTE.

Këto lloj partneritetesh janë burimi kryesor i transmetimit të kërkesave nga territoret tek autoritetet e programit.

Kanalet kryesore të informacionit përfaqësohen nga Koordinatorët Kombëtarë si ndërmjetës thelbësorë midis përfituesve të mundshëm dhe/ose vendimmarrësve kombëtarë, vendorë, publikë dhe privatë social-ekonomikë nga njëra anë, si dhe kryesisht Komiteti Monitorues dhe Autoriteti Menaxhues nga ana tjetër.

Tryezat e rrumbullakëta, anketat, takimet dhe shkëmbimet dypalëshe janë mjetet më të zakonshme për parashtrimin e informacionit dhe marrjen e opinioneve/vërejtjeve. Përbërja dhe menaxhimi i këtyre partneriteteve janë kompetencë dhe përgjegjësi ekskluzive e Shteteve.

Së fundi, përfaqësuesit e Koordinatorëve Kombëtarë janë zëdhënësit e partnerëve të palëve të treta para Komitetit Monitorues dhe Autoritetit Menaxhues.

Në nivelin transnacional të programit, do të zbatohen disa veprime që gjithmonë përfitojnë nga përvoja e programimit të mëparshëm. Megjithatë, nisma të reja do të gjejnë vendin e tyre me synimin për të forcuar lidhjen ndërmjet Programit dhe përfituesve të mundshëm.

Kështu, për periudhën e programimit 2021–2027 propozohen skema ekzistuese ose konceptime të reja si më poshtë:

1. Integrimi i një analize specifike mbi zbatimin e nenit 6 të *CPR*-së në kuadër të vlerësimeve operacionale dhe të ndikimit;
2. Promovimi i dialogut tematik territorial përmes rrjeteve të organizatave partnere të lidhura me projektet e bashkëfinancuara sipas ISO1 (aktivitetet e informimit, mobilizimi, kapitalizimi i aktorëve të jashtëm);
3. Konstituimi i një Grupi të Përhershëm të Kontaktit ISO1 (aktivitete koordinuese brenda projektit që synojnë agregimin e rezultateve dhe krijimin e sinergjive për audiencat e jashtme të synuara);

4. Zhvillimi i një bashkëpunimi ndërprogramor, apo edhe i një mekanizmi koordinues (aktivitetet e shkëmbimit, studimi, transferimi, komunikimi dhe valorizimi i rezultateve) edhe me aktorët kryesorë transnacionalë në Mesdhe, me qëllimin që të nxitet integrimi dhe ndërlidhja në basenin e Mesdheut.

Objektivi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i të gjitha këtyre masave do të jetë përmirësimi dhe konsolidimi i përfshirjes së partnerëve të palëve të treta në zbatimin e programit, nëpërmjet organeve të pranishme në projekte dhe autoriteteve të Interreg Euro-MED.

Në fund, për ta bërë konkrete, propozohet të organizohen *ditët e konsultimeve* transnacionale një ose dy herë në vit nga AM/SP, duke përfshirur kështu vendimmarrjen e Komitetit Monitorues të programit nëpërmjet ofrimit të informacione të jashtme *ad hoc* dhe rekomandimeve të mbledhura nga përfaqësues të shoqërisë civile të cilët kanë përvojë/kompetenca/aftësi për tema specifike tematike (për shembull, në përgatitjen e thirrjeve për projektpropozime, proceset e transferimit...).

Ditët e konsultimeve mund të organizohen në formën e uebinareve dhe të synojnë audiencat dhe organizatat të ndryshme, sipas temave që janë në agjendën(at) e Komitetit Monitorues.

Shumëllojshmëria e veprimeve të përshkruara mundëson mobilizimin shumënivëlësh të partneriteteve të programit në çdo fazë kyçe të ciklit të tij (përgatitja, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi), qoftë në nivel transnacional apo në nivelin e shteteve pjesëmarrëse.

5. Qasja e komunikimit dhe vizibilitetit për programin Interreg (objektivat, audiencat e synuara, kanalet e komunikimit, përfshirë mediat sociale sipas rastit, buxheti i planifikuar dhe treguesit përkatës për monitorimin dhe vlerësimin)

Referenca: germa (h) e nenit 17(3)

Programi Interreg Euro-MED 2021–2027 është i përkushtuar në ndërtimin e një strategjie komunikimi që mbështet Qeverisjen Mesdhetare dhe ndryshimin e politikave.

Duke marrë parasysh periudhat e kaluara të programimit, strategjia aktuale paraqet një udhërrëfyes për 7 vjet.

Kapitulli i komunikimit përmbledh një dokument të hollësishëm që do të miratohet nga Autoritetet e programit njëkohësisht si Program Bashkëpunimi. Strategjia e komunikimit do të plotësohet me plane vjetore komunikimi.

Qasja jonë e komunikimit bazohet në 6 shtysa:

- *e shënjestruar*, në kuptimin tematik dhe territorial;
- *e gjelbër*, sepse rrënjës praktikë të gjelbra në të gjithë programin dhe strategjitë e komunikimit të projekteve;
- *ndërvepruese*, e fokusuar në një komunikim plotësisht ndërveprues ndërmjet Programit dhe audiencave të synuara;
- *bazuar në komunitet*: mundëson sinergji midis projekteve dhe angazhim të fortë të partnerëve.
- *e integruar dhe e koordinuar*: fluks efikas komunikimi ndërmjet të gjitha niveleve të arkitekturës së programit dhe përtej, duke përfshirë edhe programe, strategji apo nisma të tjera, sipas rastit.
- *e orientuar drejt ndryshimit*: Strategjia e programit mbron simbiozën e fortë midis masave të komunikimit dhe kapitalizimit që synojnë ndryshime në politika.

OBJEKTIVAT

Objektivat operacionalë të programit zbërthehen në 3 objektiva strategjikë komunikimi, dhe këta ndahen në 12 objektiva specifike (një shembull i vetëm më poshtë), të konvertuar në objektiva vjetorë SMART.

1. Rritja e ndërgjegjësimit për programin në shtetet dhe rajonet partnere;

1.1 Rritja e ndërgjegjësimit të përfutuesve të mundshëm për programin dhe mundësitë për financime që ofron në të gjitha rajonet e pranueshme

2. Nxitja e komunikimit dhe kapitalizimit të projekteve me cilësi të lartë

3. Kontributi për të promovuar ndryshime të politikave në zonën e programit.

KANALET

Në i konsiderojmë “kanalet” si autostradat e programit dhe projekteve për të përcjellë efektivisht përmbajtjen të audiencat e synuara.

Nga ky këndvështrim, ne zgjedhim 3 kategori kanalesh: aktivitete, avokim, ueb dhe media sociale, shtypi i shkruar dhe pothuajse zero materiale të shtypura.

Për sa u përket mediave sociale dhe shtypit, synojmë të promovojmë përmbajtje organike dhe me pagesë.

Ne përdorim Facebook, Twitter, LinkedIn dhe YouTube, kryesisht për të promovuar aktivitetet dhe rezultatet e programit dhe projektit, thirrjet e programit dhe nismat përkatëse të Bashkimit Evropian/Komisionit apo institucioneve të tjera. Facebook na lejon të vazhdojmë të rrisim komunitetin tonë duke u lidhur me përfituesit aktualë dhe të mundshëm, por edhe me publikun e gjerë falë përmbajtjes së thjeshtë dhe ndërvepruese. Twitter është një tjetër mjet për të shpërndarë informacionin në mënyrë të shpejtë, të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë. Edhe LinkedIn shërben për shpërndarjen e informacionit dhe na mundëson të arrijmë te një audiencë më e gjerë dhe më profesionale.

STRATEGJIA E PËRMBAJTJES

Strategjia e përmbajtjes bazohet në 3 shtysa kryesore për zhvillim: fokusi te historitë e suksesit në kapitalizim, veçanërisht ato me ndikime efektive në politika, të orientuara drejt përdoruesit fundor dhe fushatave.

AUDIENCAT E SYNUARA

Audienca e synuara ndahen në 5 kategori, të cilat zbërthen më tej në strategjinë e komunikimit, specifikisht: aplikantët e mundshëm dhe partnerët e projektit brenda zonës së pranueshme të programit; shumëfishuesit dhe/ose aktorët strategjikë, si: OJF-të, shoqatat, NVM-të, organizatat ndërqeveritare që punojnë ose kanë interes në temat e programit; përdoruesit politikë fundorë /politikëbërës që punojnë ose kanë interes në temat e programit; përdoruesit teknikë fundorë; publiku i gjerë.

BUXHETI

Autoritetet e programit janë të përkushtuara për të mbajtur buxhetin e mëparshëm të komunikimit prej 900,000 euro, i cili, në varësi të shumës totale, mund të rezultojë në pak më shumë se 0,3% të buxhetit total të programit.

Nisur nga zërat kryesorë të shpenzimeve të programit të mëparshëm dhe strategjisë aktuale, me synimin që të rrisim shtrirjen e mediave sociale dhe mbështetjen për masat e gjelbra, buxheti shpërndahet si më poshtë: 40% për aktivitete, 28% për mjetet TI, 12% për brandim, 10% për strategjinë e përmbajtjes (fushatat në media sociale, podkaste, video), 5% për marrëdhëniet me shtypin, si dhe 5% për trajnimet e projektit.

Shpërndarja indikative vjetore në varësi të shpalljes së thirrjes së parë për projektpropozime

VITET 2021 2022 2023 2024 2025 2026 2027 2028 2029% 02620161210853

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Treguesit konsistojnë në numrin e pjesëmarrësve, aplikimet e dorëzuara dhe përdoruesit e forumit për gjetje partnerësh, normat e kënaqësisë, normat e projektpropozimeve të miratuara, shtrirja e medias sociale, trafiku në internet, numri i trajnimeve dhe projektet që përdorin mjetet/instrumentet e prezantuara, numri i nxënësve të sensibilizuar për bashkëpunimin evropian etj.

Shembull i skenarit bazë:

Aktiviteti prezantues: të paktën 400 pjesëmarrës fizikisht dhe *online*

Norma e thirrjes së parë: miratohen të paktën 29% e projektpropozimeve

6. Mbështetja për projekte të vogla, përfshirë projektet e vogla brenda fondeve për projekte të vogla

Referenca: germa (i) e nenit 17(3), neni 24

Programi Interreg Euro-MED nuk ofron mundësinë e bashkëfinancimit të projekteve të vogla.

Kjo bëhet kryesisht për arsye të mëposhtme:

a) dimensionin transnacional të programit. Vërtet që ky mekanizëm nuk duket i përshtatur me objektivat dhe logjikën e një programi kaq të gjerë sa Interreg Euro-MED: ndryshe nga qasja e programit i cili përpiqet të jetë sa më i hapur ndaj përvojave dhe kompetencave në fushën e

bashkëpunimit, projektet e vogla duhet të fokusohen në një dimension territorial dhe partneriteti jashtëzakonisht të reduktuar;

b) arkitektura e programit (që duhet të plotësojë kërkesat e koordinimit, bashkëpunimit dhe përqendrimit tematik) është e konceptuar që të favorizojë kapitalizimin e rezultateve në zonë në mënyrë homogjene: futja e projekteve të vogla shkakton përçarje në këtë arkitekturë, e cila bazohet në procesin e përshkallëzimit të arritjeve të transferueshme, për shkak të ndikimit të kufizuar dhe të mbivendosur;

c) tipologjia e projekteve të programit tashmë të integruara në arkitekturën e cili – nëpërmjet projekteve të thjeshta modulare “territoriale” (studime, testime ose transferime) ose projekteve strategjike (tri module të përbashkëta për një lloj territori prioritar) dhe projekteve “qeverisëse” të komuniteteve tematike (grupime dhe transferim) ose projekteve institucionale (ndërlidhja dhe integrimi) – mund të bashkëfinancojë të gjithë aktorët që mund të jenë të interesuar për prioritetet dhe objektivat specifike të programit;

d) zgjedhja e programit që të miratojë dhe të strukturojë prioritetin ISO1 për t’iu përgjigjur nevojës për një qeverisje më të mirë në hapësirën e bashkëpunimit nëpërmjet komunikimit sa më efektiv dhe më të gjerë të mundshëm, transferueshmërisë dhe ndikimit të rezultateve, objektiva në të cilët projektet e vogla nuk do të kishin ndonjë vlerë të shtuar reale, por do të ishin kundërvënëse;

e) projektet e vogla janë financiarisht modeste, maksimumi 100,000 € për të aplikuar SCO-të [metoda e thjeshtimit të kostove] në frymën e thjeshtimit dhe minimizimit të rreziqeve të menaxhimit indirekt (përfituesi i jashtëm që menaxhon fondet për projekte të vogla) dhe që ndjeshëm zvogëlon ndikimin e po këtyre projekteve në shkallë mesdhetare;

f) Së fundi, mungesa e aktorëve globalë në zonën e programit të përshtatur me frymën e germës së neneve 24 dhe 25 të rregullores Interreg (organ juridik ndërkufitar, Grup Evropian i Bashkëpunimit Territorial [EGTC] ose organ me personalitet juridik që përfshin përfaqësues nga të paktën dy vende pjesëmarrëse nga të cilët të paktën njëri është Shtet Anëtar i BE-së etj.) në gjendje të menaxhojë dhe të garantojë që përfituesit fundorë do të respektojnë gjurmën e auditimit të programit në kuadrin transnacional.

7. Dispozitat zbatuese

7.1 Autoritetet e programit

Referenca: germa (a) e nenit 17(6)

Tabela 9

Autoritetet e programit	Emri i institucionit	Emri i kontaktit	Pozicioni	E-mail
Autoriteti menaxhues	Région Provence-Alpes-Côte-d’Azur	Tarja RICHARD	Kryetar i Autoritetit Menaxhues	trichard@maregionsud.fr
Autoriteti auditues	Commission Interministérielle de Coordination des Contrôles et Actions cofinancées par les Fonds Européens (CICC)	Martine MARIGEAUD	Kryetar	martine.marigeaud@finances.gouv.fr
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Shqipëri: Kryeministria - Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës	Ilir Beqaj	Drejtor i Përgjithshëm / Koordinator Kombëtar IPA	Info@saspac.gov.al
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Bosnja-Hercegovina: Drejtoria për Integrimin Evropian	Nada Bojanić	Zv. Drejtor, Divizioni për Programet e Bashkëpunimit Territorial	nada.bojanic@dei.gov.ba
Autoriteti kombëtar	Bullgaria:	Desislava	Drejtor, Kryetar i	D.G.Georgieva@mrrb.government.bg

(për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Punëve Publike – Drejtoria e Menaxhimit të Bashkëpunimit Territorial	Georgieva	Autoritetet Kombëtar	
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Kroacia: Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe fondeve të BE-së, Drejtoria për Bashkëpunimin Territorial Evropian	Mislav Kovač	Përgjegjës i Sektorit për Koordinimin e programeve të Bashkëpunimit Territorial Evropian dhe Strategjive Makrorajonale	Mislav.kovac@mrrfeu.hr
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Zyra e Integritetit Evropian e Malit të Zi	Zorka Kordić	Kryenegociator /Koordinator Kombëtar IPA	zorka.kordic@gsv.gov.me
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Francë: Rajoni Provence-Alpes-Côte d’Azur, Drejtoria e Bashkëpunimit Mesdhetar	Guillaume Huet	Drejtor	ghuet@maregionsud.fr
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Qeveria e Qipros – Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rritjes	Marilena Ayiomamitou	Specialiste e Planifikimit	mayiomamitou@mof.gov.cy
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Greqia: Ministria e Zhvillimit dhe Investimeve	Angeliki Bouziani	Kryetar i AM të programeve BTE	abouziani@mou.gr
Autoriteti Kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Italia: Agjencia për Kohezionin Territorial – Fusha e Projekteve dhe Instrumenteve - Ufficio 6	Paolo Galletta	Përgjegjës Sektori (Ufficio 6)	paolo.galletta@agenziacoazione.gov.it
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Malta: Kryeministria	Audrey Anne Callus Randich	Drejtor i fondeve të BE-së	audrey-anne.callus-randich@gov.mt
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Portugalia: Agjencia për Kohezionin dhe Zhvillimin	Raquel Rocha Territorial	Koordinatorë e Njësive të Bashkëpunimit	raquel.rocha@adcoesao.pt
Autoriteti Kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Republika e Maqedonisë së Veriut: Sekretariati për Çështjet Evropiane	Bojan Marichikj	Zv.Kryeministër përgjegjës për Çështjet Evropiane dhe Koordinator Kombëtar IPA	Bojan.Marichikj@sep.gov.mk
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Sllovenia: Zyra e Qeverisë për Zhvillimin dhe Politikën e Kohezionit të BE-së	Nadja Kobe	Anëtare e Komitetit Monitorues	nadja.kobe@gov.si
Autoriteti kombëtar (për programet me pjesëmarrjen e vendeve të treta ose partnere)	Spanja: Ministria e Financave dhe Administrimit	Maria del Carmen Hernández	Zv. Drejtor i Përgjithshëm për Bashkëpunimin	sgcte@sepg.hacienda.gob.es

të treta ose partnere)	Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Fondeve Evropiane, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin Territorial Evropian	Martín	Territorial Evropian	
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Shqipëria: Agjencia e Auditimit për Programet e Akredituara të Asistencës së BE- së	Alba Qirjazi	Drejtor i Përgjithshëm	Alba.Qirjazi@aapaa.gov.al
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Autoriteti Auditues i Malit të Zi	Nataša Simonović	Zv. Auditues i Përgjithshëm	natasa.simonovic@revizorskotijelo.me
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Bosnja- Hercegovina: Ministria e Financave dhe Thesarit	Dana Šarčević	Ekspert/Këshilltar për kontrollin financiar, Departamenti i Fondit Kombëtar	dsarcevic@mft.gov.ba
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Bullgaria: Ministria e Financave, Agjencia Ekzekutive e Auditit për Fondet e BE-së	Lyudmila Rangelova	Drejtor Ekzekutiv	aeuf@minfin.bg
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Kroacia: Agjencia për Auditimin e sistemit të zbatimit të programeve të BE-së	Neven Šprlje	Drejtor i Agjencisë	neven.sprlje@arpa.hr
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Qipro: Shërbimi i Auditit të Brendshëm	Anna Zavou Christoforou	Komisioner i Auditit të Brendshëm	achristoforou@internalaudit.gov.cy
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Francë: Rajoni Provence-Alpes- Côte d’Azur	Jean- Christophe MASSE	Përgjegjës i Njesisë	jc.masse@maregionsud.fr
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Greqia: Ministria e Financave, Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit – Komiteti i Auditit Financiar (E.D.E.L.)	Athinais Tourkolia	Drejtor i Përgjithshëm	a.tourkolia@edel.gr
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Italia: Inspektorati i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Financiare me BE- në (IGRUE)	Maristella Comisso		maristella.comisso@mef.gov.it
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Malta: Kryeministria	Stefano Manicolo	Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti i Auditit të Brendshëm dhe Hetimeve	stefano.manicolo.1@gov.mt
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Ministria e Financave – Zyra e Mbikëqyrjes së Buxhetit e Republikës së	Mirjam Novaković	Drejtes e Departamentit	mirjam.novakovic@gov.si

Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Sllovenisë Maqedonia e Veriut: Autoriteti për Auditimin e IPA-s	Adem Curi	Auditues i Përgjithshëm për Auditimin IPA	adem.curi@aaipa.gov.mk
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Portugali: IGF-Autoritet Auditues	Ricardo Jorge Reis	Drejtor	ricardoreis@igf.gov.pt
Përfaqësuesit e grupit të audituesve	Spanjë: Ministria e Financave dhe Administratës Publike, Bordi i Përgjithshëm i Ndërhyrjes i Administratës Shtetërore	Rafael Cortés Sánchez	Auditues Kombëtar. Drejtues Divizioni III – Kontrolli Financiar i Fondeve të BE-së	DivisionFondos1@igae.hacienda.gob.es
Organit të cilit Komisioni duhet t'ia bëjë pagesat	Ministria e Ekonomisë dhe Çështjeve Digitale, Sekretariati i Përgjithshëm i Thesarit, DP e Thesarit dhe Politikave Financiare	Rocío Chico Hualde	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	Relacionesuc@economia.gob.es
Organ tjetër nga autoritet menaxhues të cilit i besohet funksioni i kontabilitet	Ministria e Financave dhe Administratës Publike, DP e Fondeve Evropiane, Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Certifikimit dhe Pagesave	Jeronimo Rios Boeta	Zv.Drejtor i Përgjithshëm i Certifikimit dhe Pagesave	JRiosB@sepg.hacienda.gob.es

7.2 Procedura për ngritjen e Sekretariatit të Përbashkët

Referenca: germa (b) e nenit 17(6)

Sekretariati i Përbashkët ndihmon Autoritetin Menaxhues dhe Komitetin Monitorues në kryerjen e funksioneve të tyre. Gjithashtu, Sekretariati i Përbashkët u jep informacion përfituesve potencialë për mundësitë e financimit në kuadër të programit dhe ndihmon përfituesit dhe partnerët në zbatimin e operacioneve.

Sekretariati i Përbashkët ngrihet në vazhdimësi me periudhat e programimit 2007–2013 dhe 2014–2020. Selinë e ka në rajonin Provence-Alpes-Côte d'Azur.

Autoriteti Menaxhues konsultohet me Shtetet pjesëmarrëse për ngritjen e Sekretariatit të Përbashkët dhe për rekrutimin e çdo punonjësi shtesë. Shtetet përfshihen në procesin e rekrutimit.

Personeli mban parasysh partneritetin e programit duke respektuar parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe mundësive të barabarta në procedurat e rekrutimit. Anëtarët e Sekretariatit të Përbashkët janë të integruar administrativisht në personelin e rajonit Provence-Alpes-Côte d'Azur.

Sekretariati i Përbashkët përbëhet nga njësi të ndryshme përgjegjëse për monitorimin e projektit, monitorimin financiar, komunikimin, aktivitetet e kapitalizimit dhe çështjet administrative. Secila njësi ka një person referues dhe i gjithë ekipi udhëhiqet nga një koordinator.

7.3. Ndarrja e përgjegjësisë ndërmjet Shteteve Anëtare pjesëmarrëse dhe, sipas rastit, ndër vendet partnere dhe VTPD-të, në rast korrigjimesh financiare që vendos autoriteti menaxhues ose Komisioni

Referenca: germa (c) e nenit 17(6)

Rikuperimi i pagesave nga përfituesit

Rekomandimet dhe masat korrigjuese mund të rezultojnë nga çdo lloj kontrolli nga Autoriteti Menaxhues, nga shtetet pjesëmarrëse, nga organi përgjegjës për funksionin e kontabilitetit, auditimet e sistemit dhe operacioneve, auditimet nga Komisioni Evropian dhe nga Gjykata Evropiane të Audituesve).

Sipas nenit 52 të rregullores Interreg, Autoriteti Menaxhues garanton që çdo shumë e paguar si rezultat i një parregullsie të rikuperohet nga projekti.

Nëse Autoriteti Menaxhues nuk arrin të rimbursohet nga përfituesi, Shteti pjesëmarrës në territorin e të cilit përfituesi në fjalë është i vendosur ose, në rastin e një *EGTC*, është i regjistruar, ia rimbursion Autoritetit Menaxhues shumën e paguar gabimisht atij përfituesi.

Detajet mbi procedurën e rikuperimit përfshihen në përshkrimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit që do të ngrihet në përputhje me nenin 69 të *CPR*-së.

Paralelisht me/pas rimbursimit të shumës së parikuperueshme nga shteti pjesëmarrës tek Autoriteti Menaxhues, shteti pjesëmarrës ka të drejtë të rimbursohet nga përfituesi që ndodhet në territorin e tij, edhe gjyqësisht nëse është e nevojshme. Për këtë qëllim, Autoriteti Menaxhues dhe partneri kryesor ia kalojnë Shtetit pjesëmarrës të drejtat e tyre që rrjedhin nga kontrata e subvencionit dhe marrëveshja e partneritetit.

Autoriteti Menaxhues është përgjegjës për rimbursimin e shumave në fjalë në buxhetin e përgjithshëm të BE-së, në përputhje me ndarjen e përgjegjëse ndërmjet shteteve pjesëmarrëse, siç përcaktohet në programin e bashkëpunimit dhe në nenin 52 të rregullores Interreg.

Në rastin e parregullsive të zbuluara nga Autoriteti Menaxhues ose nga Komisioni Evropian, si rezultat i të cilave disa shpenzime konsiderohen të papranueshme dhe KE-ja bën një korrigjim financiar që është objekt i një vendimi bazua në nenet 103 ose 104 të *CPR*-së, pasojat financiare për shtetet pjesëmarrëse përcaktohen në seksionin “Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet shteteve pjesëmarrëse” më poshtë.

Në çdo korrespondencë ndërmjet KE-së dhe Shteteve Anëtare dhe Partnere, vihet për dijeni Autoriteti Menaxhues/Sekretariati i Përbashkët. Ky i fundit informon organin përgjegjës për funksionin e kontabilitetit, Autoritetin Auditues dhe Grupin e Audituesve.

Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet shtetet pjesëmarrëse:

Shteti pjesëmarrës mban përgjegjësi në lidhje me përdorimin e fondeve Interreg si vijon:

- për shpenzimet që lidhen me partnerët e projektit të vendosur në territorin e tij, secili shtet pjesëmarrës e mban përgjegjësinë individualisht;

- në rast të një parregullsie sistematike ose korrigjim financiar, shtetet pjesëmarrëse mbajnë pasojat financiare në përpjesëtim me parregullsitë përkatëse të zbuluara në territorin përkatës të secilit Shtet pjesëmarrës. Kur është e pamundur që parregullsia sistematike ose korrigjimi financiar t’i atribuohet territorit të një shteti pjesëmarrës, shtetet pjesëmarrëse mbajnë përgjegjësi në përpjesëtim me kontributin Interreg (ose ERDF/IPA) që iu është paguar partnerëve kombëtarë të projektit;

Për shpenzimet që lidhen me asistencën teknike (të llogaritura si një normë fikse në përputhje me nenin 26 të rregullores Interreg), parimet e mësipërme të përgjegjësisë që zbatohen për shpenzimet e lidhura me projektin dhe parregullsitë sistematike/korrigjimet financiare mund të zbatohen edhe për korrigjimet e Asistencës Teknike, ku këto të fundit janë pasoja të drejtpërdrejta të korrigjimeve që lidhen me shpenzimet e projektit.

8. Kostot për njësi, shumat totale, normat fikse dhe financimet që nuk lidhen me kostot

Referenca: nenet 94 dhe 95 të rregullores (BE) 2021/1060 (CPR)

Tabela 10. Kostot për njësi, shumat totale normat fikse dhe financimet që nuk lidhen me kostot

Përdorimi i synuar i neneve 94 dhe 95 të CPR-së		Po	Jo
Nga miratimi, programi shfrytëzon rimbursimin e kontributit të BE-së bazuar në kostot për njësi, shumat totale dhe normat fikse në kuadrin e prioritetit sipas nenit 94 të CPR-së		-	X
Nga miratimi, programi shfrytëzon rimbursimin e kontributit të BE-së bazuar në financimet që lidhen me kostot, sipas nenit 95 të CPR-së		-	X

Shtojca 1

A. Përmbajtja e elementeve kryesore

Prioritet i	Fond i	Objektiv i specifik	Pjesa e llogaritur e alokimit financiar total brenda	Llojet e operacioneve të mbuluara		Treguesi që aktivizon rimbursimin		Njësia matëse e treguesit që aktivizon rimbursimin	Lloji i metodës së kostove të thjeshtuar (shkalla)	Shuma (në EUR) ose përqindja (në rast normash fikse)
				Kodi(1)	Përshkrim	Kodi(2)	Përshkrim			

			prioritetit ku zbatohet metoda e kostove të thjeshtuara në %	)	i	)	i		standarde e kostove për njësi, shumave totale apo normave fikse	metodës së kostove të thjeshtuara
--	--	--	--	---	---	---	---	--	---	-----------------------------------

(1) I referohet kodit për dimensionin e fushës së ndërhyrjes në tabelën 1 të shtojcës 1 të CPR-së.

(2) I referohet kodit të një treguesi të përbashkët, nëse ka.

Shtojca 1

B. Detajet sipas llojit të operacionit

--

C. Llogaritja e shkallës standarde të kostove për njësi, shumave totale dhe normave fikse

1. Burimi i të dhënave të përdorura për të llogaritur shkallën standarde të kostove për njësi, shumave totale dhe normave fikse

(kush i prodhoi, mbledhi dhe regjistroi të dhënat, datat e fundit, ku ruhen të dhënat, vlerësimi etj.):

--

2. Lutemi, sqaroni përse metoda e propozuar dhe llogaritja bazuar në nenin 94(2) është relevant për llojin e operacionit:

--

3. Lutemi, sqaroni si janë bërë përlllogaritjet, veçanërisht për ndonjë supozim për cilësinë apo sasi. Sipas rastit, duhet të përdoren evidencat statistikore dhe parametra dhe, nëse kërkohet, të përgatiten në format të përdorshëm për Komisionin:

--

4. Lutemi, shpjegoni si keni garantuar përfshirjen vetëm të shpenzimeve të pranueshme në llogaritjen e shkallës standarde të kostove për njësi, shumave totale apo normës fikse:

--

5. Vlerësimi i autoritetit(eve) auditues për metodologjinë e përlllogaritjes dhe shumat dhe për modalitetet për të garantuar verifikimin, cilësinë, mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave:

--

Shtojca 2

A. Përmbajtja e elementeve kryesore

Prioriteti	Fondi	Objektivi i specifik	Shuma që mbulohe t me financim që nuk lidhet me kostot	Llojet e operacioneve të mbuluara		Kushtet që duhen përmbushur /rezultatet që aktivizojnë rimbursimin nga Komisioni	Treguesi		Njësia e matjes për kushtet që duhen përmbushur /rezultatet që aktivizojnë rimbursimin nga Komisioni	Metoda e parashikuar e rimbursimit të përfutjesit apo përfutjesve
				Kodi(1)	Përshkrimi		Kodi(2)	Përshkrimi		

(1) I referohet kodit për dimensionin e fushës së ndërhyrjes në tabelën 1 të shtojcës 1 të CPR-së dhe shtojcës IV të rregullores EMFAF.

(2) I referohet kodit të një treguesi të përbashkët, nëse ka.

B. Detajet sipas llojit të operacionit

Shtojca 3: Lista e operacioneve të planifikuara me rëndësi strategjike me një kalendar – neni 22(3) i CPR-së

Operacionet në kuadër të prioritetit të qeverisjes (ISO1) do të konsiderohen me rëndësi strategjike duke përfshirë 2 lloje projektsh: projektet e Komunitetit Tematik (PKT) dhe projektet e Dialogut

Institucional (PDI) që do të kontribuojnë në mënyrë të koordinuar në zbatimin e programit “Rezultatet: Strategjia e Amplifikimit të Rezultateve”.

Për secilin nga 4 misionet e përcaktuara, Programi do të zgjedhë një projekt të secilit lloj për të përmirësuar qeverisjen e territoreve në mënyrë të koordinuar. Kjo do të thotë se 4 projekte të Komunitetit Tematik dhe 4 projekte të Dialogut Institucional do të punojnë përkatësisht në dyshe në secilin mision për të përmirësuar rezultatet e projekteve tematike (nën PO 1 dhe 2) dhe për të zgjeruar objektin e tyre në mënyrë që të mbështesin koordinimin më të mirë të veprimeve të aktorëve përgjegjës për procesin e vendimmarrjes dhe qeverisjen e territoreve.

Projektet e Komunitetit Tematik kanë këto synime:

1. krijimi i kushteve për ripërdorimin e rezultateve, zhvillimin e sinergjive dhe rritjen e koordinimit mes projekteve tematike që punojnë për të njëjtin mision duke artikuluar një komunitet partnerësh të projekteve Interreg Euro-MED;

2. zbatimi i strategjive të transferimit dhe integritetit të projekteve tematike Euro-MED rezultojnë në praktika të aktorëve publikë dhe privatë në nivel vendor, rajonal e kombëtar duke ofruar mbështetje teknike për institucionet përkatëse.

Projektet e Dialogut Institucional kanë këto synime:

1. kontribut në zbatimin e strategjive të transferimit dhe integritetit duke u angazhuar me autoritetet vendore, rajonale dhe kombëtare në mbështetje të aktiviteteve dhe arritjeve të projekteve të Komunitetit Tematik;

2. kontribut në zbatimin e strategjive të transferimit dhe integritetit duke u angazhuar me autoritetet / rrjetet evropiane dhe me autoritetet menaxhuese të BTE-së, nismat dhe strategjitë në Mesdhe;

3. krijimi i kushteve afatgjata për një dialog të përhershëm institucional dhe social për të plotësuar dimensionin transnacional me zgjidhje vendore, me qëllim që të kontribuojë në kohezionin territorial në nivelin transnacional mesdhetar në lidhje me çdo mision tematik. Kalendari i përkohshëm: Thirrja e hapur nga shkurti ose marsi 2022; Zbatimi i projekteve nga nëntori 2022 deri në qershor 2029.

DOKUMENTET

Titulli i dokumentit	Lloji i dokumentit	Data e dokumentit	Referenca vendore	Referenca e Komisionit	Dosjet	Data e dërgimit	Dërguar nga
Harta e zonës së programit	Harta e zonës së programit	21 prill 2022		Ares(2022)3202658	Harta e zonës së programit	25 prill 2022	n002rha7
Konspekti i programit 2021TC16FFTN01 1.1	Konspekti i të dhënave para dërgimit	25 prill 2022		Ares(2022)3202658	Programme_snapshot_2021TC16FFTN001_1.1_fr.pdf Programme_snapshot_2021TC16FFTN001_1.1_en.pdf	25 prill 2022	n002rha7